



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTËR I SHTETIT PËR  
RININË DHE FËMIJËT

**Raport Monitorimi**  
për zbatueshmërinë e  
**Strategjisë Kombëtare të Rinisë**  
**2022 - 2029**

**Viti 2023**

## Tabela e përmbajtjes

<b>1. INFORMACIONI PËRMBLEDHËS .....</b>	<b>3</b>
1.1 REFORMA TË IMPLEMENTUARA ME SUKSES NË VITIN PËRKATËS.....	5
1.2 IMPAKTI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT NË RAJON/OSE MË GJERË .....	15
1.3 IMPAKTI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË NË PËRPUTHJE ME AGJENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN .....	17
1.4 KOMPONENTËT QË KANË NEVOJË PËR ADRESIM ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E IMPLEMENTIMIT	18
1.5 EKZEKUTIMI I PËRGJITHSHËM I MASAVE TË STRATEGJISË .....	19
<b>2. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE MASAT .....</b>	<b>21</b>
QËLLIMI POLITIK I .....	21
QËLLIMI POLITIK II .....	59
QËLLIMI POLITIK III.....	98
<b>3. VLERËSIMI I ARRITJEVE KRYESORE DUKE PËRDORUR TREGUESIT .....</b>	<b>124</b>
<b>4. VLERËSIMI I SFIDAVE, BOSHLLËQEVE, RISQEVE DHE HAPAT PËR TË ADRESUAR .....</b>	<b>132</b>
<b>5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>133</b>
<b>6. HAPAT E RADHËS .....</b>	<b>135</b>

## 1. Informacioni përmbledhës

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar mbi VKM nr. 524 dt 22.09.2021 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët” harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirë edukimin e fëmijëve.

Strategjia Kombëtare për Rininë shërben si dokumenti kryesor për politikën në lidhje me aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. E miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 692, datë 26.10.2022., Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022 – 2029, gjatë hartimit të saj është bazuar, fillimisht në Kushtetutë, ku në Nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet mbrojtje të veçantë për të rinjtë: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti”. Të drejtat e të rinjve garantohen në kuadrin e të drejtave dhe lirive të njeriut që parashikon ky dokument themeltar i shtetit shqiptar, por gjithashtu edhe në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, i cili siguron bazën ligjore për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF). Gjithashtu SKR 2022-2029, në bashkëpunim me anëtarët e grupit të punës ndërministror është bazuar edhe në dokumentet të cilat kanë në vëmendje edhe rininë, si: Programi i Qeverisë 2021-2025; Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit; Strategjia për Rininë në BE 2019-2027; Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, etj.

SKR 2022-2029 ka kaluar në një proces koordinimi dhe konsultimi me ministrinë e linjës përgjegjëse, institucionet e tyre të varësisë, institucionet e pavarura përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e rinisë, punonjësit rinorë të vendosur pranë çdo bashkie, anëtarët e KVR-ve dhe KKR-së, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Gjithashtu, kjo Strategji ka kaluar në një proces konsultimi të gjerë me të rinjtë në të gjithë vendin, të cilët nga gushti i vitit 2021 deri më shkurt të vitit 2022, ku kanë pasur mundësi të ngrenë shqetësimet e tyre, duke diskutuar sfidat e tyre. Ata shprehën idetë dhe mendimet që mund t’ju japin zgjidhje kërkesave të tyre, të cilat janë integruar si pjesë thelbësore e SKR 2022-2029.

Bazuar në rregullat e hartimit të dokumenteve politikë, ky dokument është vendosur në regjistrin e konsultimit publik si dhe është prezantuar në Këshillin Konsultativ Qeveri Qendrore-Vetëqeverisje Vendore, përpara miratimit me VKM.

SKR 2022 – 2029 synon realizimin e tre qëllimeve politike, si vijon:

**Qëllimi politik I:** *Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t’u shprehur me zërin e tyre. Politikën ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.*

**Qëllimi politik II:** *Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.*

**Qëllimi politik III:** *Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.*

Siç paraqitet edhe në mënyrë më të zgjeruar në këtë raport monitorimi, gjatë kësaj periudhe janë shënuar një sërë zhvillimesh dhe arritjesh të rëndësishme në fushën e rinisë, në kuadër të përmbushjes së tre qëllimeve politike që qëndrojnë në bazë të SKR-së.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 përcaktohet në pjesën e saj të katërt “Zbatimi, Llogaridhënia dhe Koordinimi”. MSHRF do të përdorë metodologjinë e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS që do të përcaktojnë se si do të kryhet procesi i monitorimit dhe vlerësimit me qëllim krijimin e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit të të dhënave të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e sistemit IPSIS. Kështu parashikohet se, zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i SKR 2022-2029 do të arrihet përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit. Sipas SKR-së, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit objektiv dhe masë, mbi buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi.

Në këtë raport përfshihet: raporti i monitorimit 6 mujor për periudhën korrik-dhjetor 2023 me qëllim monitorimin e zbatueshmërisë së masave të SKR gjatë kësaj periudhe, por për realizueshmërinë financiare, është marrë në konsideratë i gjithë viti 2023 që përfshin edhe raportin e mëparshëm për 6 mujorin e parë të vitit 2023.

Ndërkohë nga monitorimi i detajuar i zbatimit të masave të parashikuara në SKR 2022-2029, për vitin 2023 rezultojnë se:

Për periudhën raportuese është parashikuar fillimi i zbatimit të tre Qëllimeve Politike, nëntë Objektivave Specifikë dhe 39 masa, nga të cilat 16 masa për QPI, 10 për QPII dhe 13 për QPIII.

Ashtu siç bëhet analiza e realizimit për treguesit, për strategjinë është analizuar edhe realizimi financiar ose ndryshe monitorimi financiar. Kjo analizë është bërë në nivel masash, objektivash dhe qëllimesh. Për secilën masë, objektiv ose qëllim janë krahasuar vlerat e raportuara financiare me vlerat e planifikuara në momentin e miratimit të strategjisë për secilin nga zërat e buxhetit që janë (i) paga dhe sigurime shoqërore (ii) materiale, shërbime dhe kontigjenca dhe (iii) shpenzime kapitale.

Norma e realizimit të shpenzimeve kapitale është 96%, ndërkohë që norma e realizimit të pagave dhe sig shoqërore është 49% dhe pak a shumë në të njëjtat nivele është edhe norma e realizimit të materiale, shërbime dhe kontigjenca, në vlerën 50%. Nga të dhënat vihet re që ka pasur vështirësi në realizimin e fondeve të parashikuara për paga dhe shpenzime korente, kryesisht të lidhura me planifikimin në SKR për shtesë me 10 punonjës të strukturës së AKR. Arsyet e detajuara jepen më poshtë për secilin qëllim apo objektiv apo masë të strategjisë.

Norma e realizimit të fondeve totale të strategjisë është 56%. Nëse bëhet krahasimi i realizimit të shpenzimeve për tre qëllimet e strategjisë vihet re se norma e realizimit luhet nga njëri qëllim në tjetrin, ku realizueshmëria sipas 3 Qëllimeve është përkatësisht:

- për Qëllimin e I-rë politik 72%,
- për Qëllimin e II-të politik 47%,
- për Qëllimin e III-të politik 78%,

ku vlen të theksohet se realizueshmëria më e ulët për qëllimin e dytë politik i referohet kryesisht shtyrjes së thirrjes për grante për start-ups, sepse pesha specifike që zënë këto fonde në buxhet është relativisht e lartë.

### **1.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës**

Masat dhe aktivitetet e mëposhtme, reflektojnë reformat, programet dhe projektet specifike të ndërmarra në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe Planit të Veprimit për periudhën referuese 1 Korrik 2023-31 Dhjetor 2023, grupuar sipas qëllimeve politike:

- Q1:Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërat e tyre.

Me miratimin e Ligjit për Rininë u hap rruga e ngritjes së strukturave të posaçme konsultative, Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe Këshillave Vendorë të Rinisë, për të mbështetur pjesëmarrjen domethënëse të të rinjve në hartimin dhe zhvillimin e politikave dhe veprimtarive në fushën e rinisë. Këshilli Kombëtar i Rinisë është konstituar për herë të parë në vitin 2021 dhe ka ushtruar aktivitetin në përputhje me kuadrin e miratuar rregullator deri në mes të vitit 2023. Këshilli i dytë Kombëtar i Rinisë nisi mandatin dyvjeçar në nëntor 2023 pas përfundimit të procesit të votimit të anëtareve përfaqësues nga organizatat rinore dhe për të rinjtë dhe këshillave studentore.

Ndërkohë që ngritja e Këshillave Vendorë Rinor në 61 bashkitë e vendit ka qenë në fokus të punës së MSHRF-së dhe AKR-së. Përmes nxitjes, shkëmbimit të informacionit dhe praktikave të mira apo dhënies së udhëzimeve sipas nevojave dhe kërkesave të bashkive specifike, situata e ngritjes së këtyre strukturave nga bashkitë e vendit në qershor 2023 dëshmon për 59 bashki që e kanë ngritur KVR-në e tyre dhe 2 të tjera në proces ngritjeje, krahasuar me 8 bashki me KVR-ë të ngritura në vitin 2021 kur nisi ky proces. Në fund të vitit 2023, u konstatuan 60 KVR të ngritura, me strukturën e fundit KVR në bashkinë Vau i Dejës në proces konstituimi. Me ngritjen dhe konstituimin e pothuajse të gjithë KVR-ve dhe punësimit të punonjësve rinorë në bashkitë e vendit, fokusi ka kaluar në fuqizimin dhe përmirësimin e punës së këtyre strukturave.

Përgjatë vitit 2023 MSHRF dhe AKR kanë vijuar me zhvillimin e aktiviteteve të reja me fokus ngritjen e kapaciteteve të të rinjve të angazhuar në këto struktura<sup>1</sup>. Megjithatë, mbetet ende punë për të bërë<sup>2</sup> që këto struktura, ende të reja, të kthehen në mekanizma efektive të nxitjes, zhvillimit dhe menaxhimit të politikave rinore në bashki<sup>3</sup>. Përveç nevojës për ngritjen e kapaciteteve të vetë këtyre strukturave, pengesë për funksionimin efektiv të tyre mbetet edhe mungesa e informacionit nga të rinjtë mbi instrumentet ligjore në dispozicion të tyre. Kjo ndikon drejtpërdrejt në mos përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse, sidomos në bashkitë e vogla dhe zonat rurale.

Strategjia Kombëtare të Rinisë, citon se “...Në të gjitha takimet konsultative që janë bërë nga përfaqësuesit e qeverisë me të rinj në kuadër të zhvillimit të kësaj strategjie, mungesa e

---

<sup>1</sup> Kampi veror "Rinia Vlerëson" organizuar në korrik 2023 në Golem, Durrës në bashkëpunim me UNICEF Albania dhe World Vision Albania me 140 anëtarë të 59 KVR-ve. Kampi dy ditor shërbeu për diskutimin dhe shpjegimin e metodologjisë për kryerjen e një vlerësimi të jashtëm të strategjisë nga ekspertë të fushës, dhe mënyrën e angazhimit të të rinjve në vlerësimin e plotësimin dhe zbatueshmërisë së masave të strategjisë. Gjatë kampit dy ditor, të rinjtë kanë ndarë eksperiencat e tyre si anëtarë të KVR-ve, duke shkëmbyer dhe marrë ide të reja për mënyrat e ndikimit në qytetet e tyre; Takim online organizuar më 22 shkurt 2023, me mbi 100 anëtarë nga 54 KVR-të, për diskutimin mbi problematikat që hasin fëmijët dhe të rinjtë në internet, si dhe për anagazhimin e tyre në hartimin dhe konsultimit të manualit për internetin e sigurt; “Shkolla Dimërore” e organizuar në bashkëpunim me World Vision Albania në Dhjetor 2022, me punonjësit rinor të 61 bashkive dhe përfaqësues të 50 Këshillave Vendor Rinor me fokus trajnimin mbi hartimin dhe konsultimit të politikave rinore në nivel lokal dhe shkrimit të projektpropozimeve rinore. Bootcamp me temë : “Media dhe arti si mjete ndergjegjësimi” organizuar në bashkëpunim me UNDP Albania në Qershor 2023 në Vlorë me 55 gazetarë të rinj, aktivistë dhe anëtarë të KVR-ve me qëllim evidentimin e rëndësisë në përfshirjen e të rinjve në nismat për ndryshimet klimaterike; rëndësinë e shëndetit mendor dhe lufës ndaj stigmave dhe paragjykimeve. Gjatë aktivitetit tre ditor të rinjtë u mbështetën për të prodhuar ide kreative dhe propozime konkrete kundra gjuhës së urrejtjes me synimin për të realizuar tema në formate të ndryshme si video, dokumentarë, podcaste, teatër, novela grafike, filma, etj; Konferenca me temë "Fuqizohemi së bashku - Këshillat Vendor Rinor të Ballkanit Perëndimor" organizuar në bashkëpunim me UNDP/ UNFPA më 15-16 Dhjetor 2023 me pjesëmarrjen e 80 të rinjve shqiptarë përfaqësues të KVR-ve dhe 20 të rinjve nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Ky aktivitet shërbeu si një platformë ku të rinjtë nga vendet e Ballkanit Perëndimor të ndanin perspektivat, përvojat, mësimet e nxjerra dhe praktikatat më të mira për zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe për të dhënë rekomandime për rritjen e angazhimit të të rinjve.

<sup>2</sup> Rrjeti POP, dhe Olof Palm në bashkëpunim me MSHRF dhe AKR kanë hartuar “Manualin për ngritjen e këshillave vendor pranë Bashkive”, tetor 2021, fq 22. Trajnimi i vazhdueshëm është thelbësor për rritjen e ndikimit dhe efektivitetit të Këshillave Vendorë të Rinisë. Pjesëmarrja e të rinjve në këtë organ këshillimor kërkon zhvillimin e aftësive jetësore dhe të lidhshme. Të rinjtë kanë nevojë për trajnim, në mënyrë që të kuptojnë problemet dhe të bashkëpunojnë në këtë mënyrë në zgjidhjen e tyre nëpërmjet përfshirjes në procesin e vendimmarrjes.

<sup>3</sup> Kongresi Rinor Shqiptar, “Implementimi i Ligjit 75/2019 “Për Rininë”: Perceptimi i të Rinjve dhe OSHC-ve”, dhjetor 2022, fq 18, Nevojat kryesore të deklaruara nga vetë bashkitë në ngritjen e strukturave rinore përfshijnë: forcimi i bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile, sektorit publik dhe aktivistë të çështjeve rinore; ngritja e kapaciteteve të stafit të bashkive lidhur me hartimin e politikave rinore dhe menaxhimin e strukturave rinore; ngritja e një sistemi informimi të përditësuar dhe të përshtatur me problematikat e të rinjve në nivel lokal mbi mundësitë që ofrojnë të gjithë aktorët që operojnë në sektorin rinor; përmirësimi i infrastrukturës rinore, hartimi i strategjive vendore për rininë si dhe mbështetje financiare nga institucionet qendrore kundrejt bashkive, sidomos ato që janë në zona më rurale.

*informacioneve të përditësuara dhe saktësia e tyre kanë dalë në plan të parë. ...]*”. Edhe studimet e organizatave jo qeveritare e konfirmojnë këtë fakt<sup>4</sup>.

Në këtë kontekst, organizatat e shoqërisë civile nga vetë natyra e veprimtarisë së tyre, duhet të jenë aktorët më të përshtatshëm për të informuar, trajnuar dhe nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse si dhe do të mund të lehtësonin aktivizimin dhe aftësimin e tyre për të ndërmarrë nisma konkrete për të zgjidhur problemet e komunitetit të tyre dhe për të edukuar shembullin e mirë tek bashkëmoshatarët.

Një zhvillim i rëndësishëm i ndodhur gjatë vitit 2023 që të mbështesë pozitivisht pjesëmarrjen dhe fuqizimin e të rinjve në politikë, jetën ekonomike dhe sociale të vendit lidhet me miratimin e marrëveshjes së financimit për programin kombëtar IPA 2022 me BE-në<sup>5</sup>, dhe parashikimit në program të dokumentit të veprimit BE-ja për Rininë, me vlerë 5 milion euro. Projekti përfshin tre fusha mbështetje, ku angazhimi i MSHRF dhe AKR vihet re në fushën e parë:

- Fusha e mbështetjes #1: Pjesëmarrja qytetare e të rinjve, të drejtat e njeriut të të rinjve dhe vullnetarizmi i të rinjve dhe pjesëmarrja në zhvillimin e komunitetit lokal, kulturën dhe sportin;
- Fusha e mbështetjes #2: Arsimi dhe punësimi i të rinjve të grupeve vulnerabël;
- Fusha e mbështetjes #3: Aftësitë e shekullit të 21-të dhe këshillimi në karrierë për nxënësit e shkollave.

Në kuadër të realizimit të fushës së mbështetjes #1, *Pjesëmarrja qytetare e të rinjve, të drejtat e njeriut të të rinjve dhe vullnetarizmi i të rinjve dhe pjesëmarrja në zhvillimin e komunitetit lokal, kulturën dhe sportin*, parashikohen të angazhohen shërbime të asistencës teknike me synim rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e veprimtarisë së KKR-së dhe KVR-ve për angazhimin e të rinjve në vendimmarrje, informimin e të rinjve mbi mekanizmat e Ligjit për angazhimin në vendimmarrje, përmirësimin e kapaciteteve dhe ndërveprimin mes AKR-së, Bashkive, organizatave rinore/për të rinjtë dhe të rinjve në zhvillimin e politikave dhe veprimtarive rinore. Përfshirja e një komponenti grantdhënie për organizatat e rinore/për të rinjtë me fokus nxitjen e aktivizimit rinor dhe vullnetarizmit në komunitetet vendore dhe pjesëmarrjes së të rinjve në kushte të cënueshme, minoritetet dhe me aftësi të kufizuara në veprimtari sportive. Mbështetja e angazhuar nga BE për financimin e këtij komponent është në vlerën 2 milion Euro. Duke qenë se angazhimi i kontratës parashikohet të ndodhë në vitin 2025, ai nuk ndikon në fondet e angazhuara për mbështetjen e rinisë për vitin 2024, *por do duhet të mbahet në konsideratë për vlerësimin e nevojave dhe përparësive për financim për rininë për vitin 2025.*

---

<sup>4</sup> Fq 43, po aty.

<sup>5</sup> Miratuar përmes vendimit Nr. 165, datë 24.3.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2022, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimin (IPA III), <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/166>;

Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 ka përcaktuar në objektivat e veta *mbështetjen e ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi dhe në kohën e lirë*. Ndërtimi i bibliotekave, qendrave rinore, parqeve dhe hapësirave të tjera rekreative të cilat janë miqësore, të hapura, të sigurta dhe të aksesueshme nga të rinjtë shihet si parakusht për të rritur dhe promovuar veprimtarinë rinore dhe siguruar një bazë për nxitjen e ndërveprimit social kulturor, vetë shprehjes dhe promovimit të zhvillimit të punës rinore. Strategjia parasheh qendrat rinore si një platformë thelbësore për fuqizimin e të rinjve dhe nxit shtimin e tyre në të gjithë vendin dhe mundësisht në nivel bashkie, duke krijuar hapësira të përshtatshme për të rinjtë.

Agjencia Kombëtare e Rinisë nëpërmjet thirrjeve 1, 2 dhe 3 për projekt-propozime ka financuar rikonstruksionin, ndërtimin, rindërtimin dhe vënien në funksion nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të qendrave rinore në qytetin e Lezhës, qytetin e Elbasanit, NjA Petrelë të bashkisë Tiranë, të qytetit të Durrësit, të qytetit të Gjirokastrës, të qytetit të Fierit, të qytetit të Librazhdit, të bashkisë Mat, të bashkisë Malësi e Madhe, të qytetit të Sarandës dhe bibliotekave publike në Roskovec, Dibër, Lushnje dhe Kamëz.

Organizatat e shoqërisë civile nga vetë natyra e veprimtarisë së tyre, *do të ishin aktorë të përshtatshëm për kthimin e këtyre strukturave apo strukturave të tjera ekzistuese në nyje sociale për pjesëmarrjen dhe aktivizimin rinor*.

- Q2: Rritje e aftësive për punësimin e të rinjve, mbështetur nga shërbimet e këshillimit të karrierës dhe punësimit që janë të orientuara nga të rinjtë, rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të drejtësisë dhe të shanseve të barabarta;

Programi i Qeverisë 2021-2025 ka përcaktuar përmirësimin e aftësive për punë dhe inovacionin si një nga tri shtyllat për fuqizimin e konkureshmërisë së ekonomisë shqiptare. Në të gjitha takimet konsultuese për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-29, të rehat dhe të rinjtë kanë cilësuar *nevojën për rritjen e mundësive të tyre për punësim, këshillim për karrierë dhe zhvillimin profesional si çështjen me interesin më të lartë për to*. Kjo përforcohet edhe nga studimet e kryera nga organizatat të shoqërisë civile me të rinjtë në nivel vendor<sup>6</sup>.

Siç arsyetohet në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-30, niveli i papunësisë tek të rinjtë është relativisht të lartë, 27.1 % për vitin 2021. Kjo tregon se të rinjtë në një masë të konsiderueshme e kanë të vështirë të gjejnë në treg pune që i përgjigjet pritshmërisë së tyre, duke mbetur të pa përfshirë në aktivitetin ekonomik të vendit dhe të varur ndaj mbështetjes sociale që iu jepet nga familja, shteti, të afërmit e tyre në emigracion apo të punësuar në vend. Po kështu, mbetet

---

<sup>6</sup> KRK “Implementimi i Ligjit 75/2019 “Për Rininë”: Perceptimi i të Rinjve dhe OSHC-ve”, dhjetor 2022, fq 19, “Në 90 % të rasteve të rinjtë kanë identifikuar punësimin si nevoja e tyre më imediate”.



e lartë dhe pjesa e të rinjve jo në punësim dhe as në arsim, e cila përbënte 26.1 % të të rinjve 15-29 vjeç gjatë vitit 2021. Me gjithë përmirësimin gradual të këtij treguesi, nga 34.5 % që ishte në vitin 2014, ai mbetet një tjetër tregues që nxjerr në pah mospërputhjen mes aftësive të të rinjve dhe kërkesave të tregut të punës<sup>7</sup>. Përveç mospërputhjes mes formimit dhe vendeve të punës, janë edhe faktorë të tjerë ekonomikë e socialë ndikojnë në mospjesëmarrjen e të rinjve në tregun e punës, si mungesa e kushteve për punë të denjë, formimi i duhur, mungesa e përvojës, aksesit i vështirë në tregun e punës, kujdesi në familje.<sup>8</sup> Mungesa e punëve të denja lidhet po ashtu me problematikën e emigrimit, ku mesatarja vjetore e të larguarve nga vendi për periudhën 2016-2021 është 36,813 sipas INSTAT<sup>9</sup>. Ky fakt është theksuar edhe në progres raportin e Komisionit Evropian për vitin 2022.

Qeveria Shqiptare ka identifikuar sektorët e turizmit, teknologjisë së informacionit, energjisë dhe bujqësisë si sektorë parësorë për zhvillimin e vendit dhe që ofrojnë mundësitë më të mira për punësim dhe mirëqenie për të rinjtë e vendit. Për shembull, turizmi është një nga tre sektorët të cilët kontribuojnë aktualisht më shumë në Produktin e Brendshëm Bruto. Turizmi bregdetar, turizmi kulturor, turizmi natyror, gastronomia bëjnë që Shqipëria të tërheqë çdo vit gjithnjë e më shumë turistë të huaj. Parashikohet që ndikimi i drejtpërdrejtë e kësaj industrie në PBB të rritet me rreth 5.4% deri në vitin 2026, duke pasur kështu një rritje deri në 8%. Ndërsa sa i përket kontributit total të industrisë ndaj PBB-së për vitin 2015, kjo shifër arriti në 306.2 miliardë lekë (21.1% e PBB-së). Për vitin 2023, parashikohet që ky kontribut të rritet me afërsisht 5.4%, ndërsa deri në 2026-n, me rreth 5.3% për të arritur në 27.2% e PBB-së<sup>10</sup>.

Rrjedhimisht edhe fokusi i politikave shtetërore për rritjen e punësimit dhe përmirësimin e kushteve të punësimit për të rinjtë, orientimi i karrierës së tyre, zhvillimi i sipërmarrjeve dhe nxitjes së inovacionit përmes mbështetjes së ideve të reja dhe start-ups nga të rinjtë, me qëllim parandalimin e rrjedhjes së trurit dhe nxitjes së të rinjve të kthehen nga migrimi, po synon këto sektorë.

- MSHRF dhe AKR, në kuadër të qëllimit të dytë politik të Strategjisë, lançuan në muajin qershor 2023 nismën “Panair edukimi, trajnimi dhe punësimi në çdo qark”, që synon krijimin e kushteve për informimin e të rinjve për mundësitë për punësim në fushat prioritare për të lehtësuar kalimin e të rinjve nga shkolla në tregun e punës, por edhe për zhvillimin e tyre personal, akademik dhe profesional. Paniret për edukim, trajnim dhe punësim janë zhvilluar gjatë vitit 2023 përkatësisht në bashkitë:

---

<sup>7</sup> Në vitin 2021, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të kategorisë NEET përbëjnë 26.1 % të të gjithë popullsisë rinore. Në këtë grup, 37.3 % janë të papunë. Pjesa tjetër është jashtë forcës së punës, ose sepse janë punëtorë të dekurajuar (15.4 %), ose sepse kryejnë detyrimet shtëpiake dhe familjare (17.5 %) ose për arsye të tjera (29.8 %).

<sup>8</sup> Miratuar me VKM, Nr 173, datë 24/03/2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024”

<sup>9</sup> Shiko [http://databaza.instat.gov.al/pxëeb/sq/DST/START\\_\\_MM/EM\\_01/?rxid=547ec986-8e3d-47d1-b25e-9d9b830dd3e5](http://databaza.instat.gov.al/pxëeb/sq/DST/START__MM/EM_01/?rxid=547ec986-8e3d-47d1-b25e-9d9b830dd3e5). Të dhënat e INSTAT janë: Emigrantë 2016-2021 janë 220,878. Mesatare vjetore 2016-2021 janë: 36,813. Emigrantë për vitin 2021 janë: 42,048

<sup>10</sup> Shiko [https://aida.gov.al/images/PDF/Sektor\\_i\\_Turizmit-broshura\\_compressed.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Sektor_i_Turizmit-broshura_compressed.pdf) fq 7

- Kukës më 30 qershor -25 aktorë dhe 150 të rinj pjesëmarrës.
- Sarandë më 22 Shtator -30 aktorë dhe 100 të rinj pjesëmarrës.
- Vlorë më 23 Tetor - 40 aktorë dhe 500 të rinj pjesëmarrës.
- Shkodër më 27 Tetor - 40 aktorë dhe 400 të rinj pjesëmarrës.
- Tiranë më 30 Tetor - 50 aktorë pjesëmarrës dhe 500 të rinj pjesëmarrës
- Korçë më 27 Nëntor - 30 aktorë pjesëmarrës dhe 150 të rinj pjesëmarrës
- Tiranë më 9 Dhjetor - 110 aktorë pjesëmarrës, “Under 30 (<30)”.

Panairet u realizuan në bashkëpunim me bashkinë përkatëse dhe me zyrat vendore të punës dhe aftësisë. Aktorët pjesëmarrës kanë përfshirë ministrinë e linjës, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (energja e rinovueshme, hidrocentralet, aeroportet, aviacioni civil, OSHEE), Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (skemat mbështetëse për fermerët dhe skemat për fermerët e rinj), Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (agjencitë për zonat e mbrojtura), Ministrinë e Mbrojtjes me anë të Forcave të Armatosura Shqiptare, të cilët promovuan skemat për të rinjtë që duan t’i bashkohen forcave të armatosura, shoqatat e bankave dhe bankat të cilat kanë degë në qytetet ku janë zhvilluar panairet, universitetet publike dhe private që kanë prezantuar bursat në dispozicion të studentëve, bizneset lokale në fushat e artizanatit, bujqësisë dhe peshkimit, hoteleri turizëm, dhe industri ushqimore, donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë të cilët kanë programe për të rinjtë, si praktika.al, Swiss Contact, Ambasada Britanike dhe Ambasada Amerikane, sikundër dhe programet shtetërore të dedikuara për të rinjtë si Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, Programi i Kodimit për të Rinjtë, etj.

Gjatë vitit 2023 ka vijuar zbatimi i Ligjit për mbështetjen dhe zhvillimin e startups<sup>11</sup> dhe thirrjeve për skemën e mbështetjes së startups dhe lehtësuesve të tyre përmes grantit shtetëror<sup>12</sup>, si dhe skemës mbështetëse pjesëmarrjen e të rinjve në kurset profesionale në fushat e programimit kompjuterik dhe kodimit.<sup>13</sup> Referuar të dhënave të raportuara nga AKPA dhe Agjencia “Start UP Albania” janë 1,285 të rinj të mbështetur për ndjekjen e kurseve të formimit profesional në kodim dhe programim kompjuterik dhe janë financuar 29 startups dhe 29 lehtësues me grant shtetëror. Këto skema do vijojnë të jenë hapura për të rinjtë edhe gjatë vitit 2024, por duhet theksuar se aktorët e jashtëm të angazhuar në këto nisma rrallë herë kanë pasur status OJF-je.

Një instrument kryesor që po zhvillohet nga qeveria në bashkëpunim dhe me aktorët shoqërore dhe me financimin e Bashkimit Evropian është **Programi Operacional i BE-së për punësimin rinor për Shqipërinë 2024-2027** (i prezantuar si *Garancia Rinore*), që do mbështesë të rinjtë jo në arsim,

<sup>11</sup> <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Ligji-p%C3%ABr-mb%C3%ABshtetjen-dhe-zhvillimin-e-startup-eve.pdf>

<sup>12</sup> <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-315-Dt.11.05.2022.pdf>

<sup>13</sup> <https://riniafemijet.gov.al/rinia/kodimi-per-te-rinjte/>

punësim apo trajnim (NEET) duke u garantuar atyre të drejtën për të vazhduar arsimimin, trajnimin ose sigurimin e një oferte pune, brenda katër muajve nga momenti kur mbeten të papunë ose largohen nga shkolla. Programi përfshin tre fusha mbështetje:

- Fusha 1: Punësimi Rinor
- Fusha 2: Arsimi profesional dhe trajnimi
- Fusha 3: Mbështetje të tjera teknike

Për të lehtësuar zbatimin me sukses i programit, me Vendimin nr. 173, datë 24.3.2023 të Këshillit të Ministrave është miratuar Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024 (YGIP). Faza fillestare pilot e programit ka nisur në vitin 2024. Ndërkohë AKPA ka vijuar punën me përshtatjen e skemave për nxitjen e punësimit duke u fokusuar në kombinimin e elementëve të mentorimit, edukimit të kombinuar mes institucionit të formimit profesional dhe vendit të punës dhe subvencionimin e pagës për individin e regjistruar në program, në përputhje dhe me vlerësimet nga studimet e kësaj çështje<sup>14</sup>, si dhe ka vijuar me digjitalizimin dhe rritjen e aksesueshmërisë të shërbimeve të veta dhe zyrat rajonale të punësimit, për të lehtësuar tranzicionin nga shkolla në tregun e punës për të rinjtë. Megjithatë, studimet e kryera dhe përgjigjet e vetë të rinjve kanë konfirmuar se problematika më e madhe për to nuk është mungesa e mundësive për zhvillimin e aftësive, por mungesa e informacionit për mënyrën e aksesimit në këto mundësi<sup>15</sup>.

Në këtë kuadër, organizatat e shoqërisë civile nga vetë natyra e veprimtarisë së tyre dhe kontakteve me të rinjtë në çdo bashki dhe pjesë të territorit, *do të ishin aktorë të përshtatshëm për ti mundësuar të rinjve aftësitë e buta që do të mbështesnin përvojën e punës, lehtësonin kapërcimin e hendekut të aftësive mes shkollimit dhe tregut të punës, nxitjen e përjasjeve të reja, moderne dhe miqësore për orientimin në karrierë dhe këshillimit për punësim së të rinjve, si dhe nxitjes dhe mbështetjes të sipërmarrjes rinore dhe vetëpunësimit së të rinjve të orientuar drejt sektorëve me potencialin më të lartë të zhvillimit.*

Në kuadër të zbatimit të programi operacional të BE-së për punësimin rinor për Shqipërinë 2024-2027 parashikohet që në kuadër të *fushës së mbështetjes I, Punësimi Rinor, produkti 1.1.1 zbatimi i aktivitetëve promovuese me të rinjtë për mbështetjen e përfshirjes së tyre në tregun e punës, të ketë*

---

<sup>14</sup>B.Bino, G. Hajdari, Udhërrëfyes për Tranzicionin e të Rinjve nga Shkolla në Vendin e Punës (TSP).

<sup>15</sup> Po aty. Fq. 57 Një problem i konsiderueshëm që vihet re si nga pyetësorët edhe nga konsultimet është mungesa e informacionit për aksesin në mundësitë e zhvillimit të aftësive, pra të rinjve shpesh nuk i mungojnë mundësitë, por aksesin në informacion për mundësi të lidhura me zhvillimin e aftësive. 81% e të rinjve që plotësuan pyetësorin nuk kanë informacion mbi iniciativat që lehtësojnë tranzicionin e të rinjve në vendin e punës në qytetin e tyre dhe 82% e tyre nuk janë në dijeni të aktorëve që realizojnë tranzicionin në vendin e punës në qytetet përkatëse të banimit. Të pyetur se çfarë kuptojnë ata me “tranzicion në vendin e punës”, shumica e të rinjve e përcaktojnë atë si faza nga shkollimi në punësim, duke i mëshuar rëndësi zotërimit të aftësive të duhura për punësim si dhe adaptimit të njohurive të përfituara gjatë shkollimit, në vendin e punës. Të pyetur mbi arsytet se përse ata nuk kanë informacion mbi këto iniciativa, të rinjtë listojnë disa prej tyre si: Mungesa e shpërndarjes së informacionit dhe mospërdorimi i mjeteve të duhura të shpërndarjes së informacionit; Prania e nepotizmit, punësimi për interesa politike dhe mungesa e meritokracisë; Mungesa e bashkëpunimit të bizneseve me shkollat; Mungesa ose mosfunksionimi i zyrave të këshillimit të karrierës.

një thirrje të dedikuar për projekt-propozime të organizatave të shoqërisë civile rinore/për të rinjtë me fokus promovimin dhe tërheqjen e të rinjve NEET në skemat mbështetëse të programit.

Duke qenë se lançimi i thirrjes pritet të ndodhë në vitin 2025, ai nuk ndikon në fondet e angazhuara për mbështetjen e rinisë për vitin 2024, *por do duhet të mbahet në konsideratë për vlerësimin e nevojave dhe përparësive për financim për rininë për vitin 2025.*

- Q3: Mirëqenie aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve;

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19 dhe vështirësitë që shoqëruan procesin e kapërcimit të krizës së tërmeteve të vitit 2019, kanë lënë gjurmën e tyre edhe mes grupmoshës së të rinjve. Sipas studimeve të kryera rezulton se dhënia e shërbimeve për të rinjtë (adoleshentët) dhe shërbimet miqësore e të orientuara nga të rinjtë janë ndërprerë që prej vitit 2015 në Shqipëri<sup>16</sup> edhe pse strategjia e shëndetit publik, shëndetit seksual dhe riprodhues dhe paketa bazë e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor synojnë nevojat e të rinjve dhe adoleshentëve.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me mbështetjen e UNFPA-së, hartuan standardet për shërbimet shëndetësore miqësore për të rinjtë, të cilat më tej u integruan në paketën bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor. Aktualisht paketa bazë e shërbimeve përfshin ofrimin e informacionit mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, planifikimin familjar dhe STI-të për të rinjtë.

Standardet ndërkombëtare të ofrimit të shërbimeve për të rinjtë kanë kërkesa specifike për të siguruar privatësinë përmes mjediseve të veçanta dhe hyrjes së veçantë në një strukturë klinike mjekësore për të ofruar shërbime miqësore për të rinjtë. Zbatimi i këtyre standardeve mbetet një shqetësim i veçantë në zonat rurale, ku mundësia për të ruajtur konfidencialitetin është e kufizuar. Nga ana tjetër, figura e mjekut në sytë e të rinjve nuk vlerësohet si shumë “miqësore”. Sidomos në rrethe ku studimet tregojnë se shumica dërrmuese e tyre (75 %) nuk ndihen komod në bisedat me mjekun për shëndetin seksual dhe riprodhues, në ndryshim nga të rinjtë në Tiranë të cilët ishin në masën 28%. Shqetësuese paraqitet edhe fakti se mbi 50% të të rinjve të intervistuar nga e gjithë Shqipëria, nuk shpreheshin të sigurt nëse mjeku do ruante privatësinë e bisedës. Kjo mund të lidhet në mënyrë të drejtpërdrejte me hezitimin që kanë të rinjtë për t’ju drejtuar mjekut, veçanërisht për çështje private e intime si shëndeti seksual. Gjithashtu, problem mbetet niveli i ulët i komunikimit dhe gatishmërisë për komunikim i të rinjve me familjen e tyre lidhur me temën e shëndetit seksual dhe riprodhues apo mbështetja mbi edukimin në shkollë për konceptet dhe termat mjekësore për shëndetin seksual dhe riprodhues, pubertetin si dhe barazinë gjinore<sup>17</sup>.

Shëndeti mendor i të rinjve rrezikohet gjithashtu nga neglizhenca kundrejt problemeve të kësaj natyre por edhe nga lehtësia për të hyrë në rrjetet sociale ku të rinjtë ndeshen me elemente dëmtoese

---

<sup>16</sup> Vlerësimi i shëndetit seksual, riprodhues, prindëror, të fëmijës dhe adoleshentëve, në kontekstin e mbulimit universal shëndetësor në Shqipëri, fq 22. <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/330457/9789289054706-eng.pdf>

<sup>17</sup> Shiko <https://propacientit.al/shendeti-seksual-dhe-riprodhues-informimi-ne-familje-dhe-ne-shkolla-i-pamjaftueshem-te-rinjte-i-drejtohen-internetit/>

për shëndetin e tyre si varësia nga krahasimi me figura të njohura, qasjet materiale që janë të papërshtatshme për të rinjtë, mungesa e kohës për tu kujdesur për vete, ngacmimet kibernetike dhe diskriminimet.

*Organizatat e shoqërisë civile nga vetë natyra e punës dhe ndërlidhjeve të tyre në komunitet, do të ishin aktorë të përshtatshëm për nxitjen e ndërgjegjësimit, këshillimit, aktivizimit dhe punës vullnetare me të rinjtë në kushte rreziku, vulnerabiliteti dhe marginalizimi, për promovimin e jetesës së shëndetshme dhe mirëqenies mendore, sociale, fizike dhe seksuale të tyre dhe për nxitjen dhe lehtësimin e aksesit të tyre në shërbimet shëndetësore.*

Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-29 mbështet objektivat e strategjisë së promovimit shëndetësor duke synuar adoleshentët dhe të rinjtë e vendit, përmes rritjes së ndërgjegjësimit shëndetësor dhe duke krijuar mjedise mbështetëse për mënyra më të shëndetshme jetese, duke trajtuar çështje që përfshijnë ushqimin, veprimtarinë fizike, dhunën, pirjen e duhanit, alkoolin, drogën, shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe planifikimin familjar.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar gjatë vitit 2023 një sërë programesh dhe veprimtarish të realizuara që synojnë nxitjen e fëmijëve dhe të rinjve për të ndjekur stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale, ku përfshiheshin: realizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në terren në 90 shkolla, në 9 qarqe të vendit dhe aktiviteteve online në të gjithë shkollat, konkretisht rreth 1,210 shkolla dhe mbi 200,000 fëmijë; mbi 100 aktivitete me përfshirjen e të rinjve dhe profesionistëve të kujdesit parësor mbi këshillimi për duhanin, alkoolin, drogën, seksin e sigurte; takime ndërgjegjësuese mbi nevojat e shëndetit mendor të të rinjve me përfaqësues të qendrave komunitare si edhe janë përgatitur materiale informative dhe organizuar trajnime me mbi 12 module ku kanë marrë pjesë 60 profesionistë shëndetësorë shkollash; janë hartuar materiale informuese për HPV dhe organizuar aktivitete ndërgjegjësuese me të rinjtë në shkolla; ekspertët të ASCAP dhe ISHP kanë hartuar dhe shpërndarë manualin mbështetës për stafin psikosocial në shkolla, mbi diskutimin për çështje të shëndetit mendor me nxënësit, ku është përfshirë dhe një kapitull mbi imazhin trupor dhe udhëzime mbi zhvillimin e ushtrimeve në klasë për rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi imazhin pozitiv trupor; janë trajnuar mbi 60 mjekë dhe infermierë të shkollave të Tiranës mbi identifikimin e drogave dhe referimin e rasteve për trajtim dhe domosdoshmërinë e zhvillimit të ndërhyrjeve parandaluese në shkolla, nëpërmjet qasjes së adresimit të grupeve vulnerabël etj.

Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), kanë krijuar një faqe të posaçme për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme gjatë shfletimit në internet<sup>18</sup>. Ky shërbim synon të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të raportojnë lidhje të paligjshme/të dëmshme, që hasen gjatë shfletimit në internet. Raportimet trajtohen me konfidencialitet të plotë nga autoritetet përgjegjëse për të ndërmarrë veprimet e duhura, si dhe për të marrë masa të menjëhershme ndaj këtyre përmbajtjeve. Në faqen

---

<sup>18</sup> <https://cesk.gov.al/raporto/>

zyrtare të MAS-it, dhe institucioneve vartëse të saj, që lidhen me portalin online [www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al) të AKCESK-ut, është vënë në funksion shërbimi “Raportoni përmbajtje të paligjshme”, për bllokimin e aksesit në faqet e internetit me përmbajtje të paligjshme.

Bazuar në dokumentin “Kuatridhe evropian për kompetencën dixhitale të mësuesve, DigComEdu1”, në kuadrin e kompetencave të TIK për mësuesit (ICT CFT, versioni 3) ASCAP-i ka hartuar:

- Modulet dhe materialet për trajnimin e mësuesve;
- Qytetaria dixhitale dhe siguria në internet në mjediset dixhitale.

ASCAP ka zhvilluar dokumentin “Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”, i cili pjesërisht synon të kuptojë parimet bazë të sigurisë kibernetike, të edukimit mediatic dhe informacionit. Për funksionimin e shërbimit psiko-social janë miratuar dy dokumente, të cilat trajtojnë edhe situatat e dhunës, bullizmit dhe abuzimit online në shkollë:

- Praktika e punës së shërbimit psiko-social;
- Parimet e përgjithshme etike të shërbimit psiko-social.

Shërbimi psiko-social zhvillon pyetësorë në lidhje me perceptimin e bullizmit dhe dhunës në shkollë nga nxënësit, si dhe organizon sesione informuese për nxënësit për abuzimin dhe bullizmin online në shkollë.

Gjithashtu, gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, janë zhvilluar konkurse dhe projekte me temën “Siguria në Internet”, si dhe Olimpiada e TIK-ut, si mundësi për të zbuluar talente në TIK. Janë krijuar platforma dhe janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut për përdorimin e këtyre platformave, të cilat synojnë përdorimin e përmbajtjes digjitale brenda kurrikulës me kompetenca, për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe për sigurinë kibernetike.

Mësuesit e shkollës janë gjithashtu të trajnuar dhe të përgatitur për të rritur sigurinë e fëmijëve përmes:

- Hartimit të rregullave shkollore për rritjen e sigurisë së fëmijëve në shkollë;
- Krijimit të videove ndërgjegjëse nga nxënësit e shkollave për sigurinë kibernetike.

Marrja e hapave për zbatimin e mëtejshëm të kësaj mase do të shtrihet në gjithë periudhën e parashikuar të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë.

Sporti është një mjet i vlefshëm për nxitjen e jetesës së shëndetshme, edukimin me vlerat e mira dhe largimin nga veset e të rinjve. MSHRF ka mbështetur Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar në përgatitjen e zbatimit të programit të ekipeve sportive në shkollë në disiplinat volejboll dhe basketboll. Gjatë vitit 2023 janë angazhuar në program rreth 10,000 vajza dhe djem në 757 ekipe në çdo bashki e vendit. Megjithatë është nevojë për më shumë programe sportive për të rinjtë, sidomos për grupmoshën mbi 19 vjeç që nuk përfitojnë nga ky program.

Në kuadër të realizimit të fushës së mbështetjes #1 *Pjesëmarrja qytetare e të rinjve, të drejtat e njeriut të të rinjve dhe vullnetarizmi i të rinjve dhe pjesëmarrja në zhvillimin e komunitetit lokal,*

*kulturën dhe sportin, të kontratës BE për Rininë, parashikohet angazhimi i një komponenti grantdhënie për organizatat e rinore/për të rinjtë me fokus nxitjen e veprimtarisë sportive së të rinjve në kushte të cenueshme, minoritetet dhe me aftësi të kufizuara. Duke qenë se angazhimi i kontratës parashikohet të ndodhë në vitin 2025, ai nuk ndikon në fondet e angazhuara për mbështetjen e rinisë për vitin 2024, por do duhet të mbahet në konsideratë për vlerësimin e nevojave dhe përparësive për financim për rininë për vitin 2025.*

Në të njëjtën linjë, nevoja për më shumë veprimtari edukative, argëtimi, artistike, kulturore, muzikore ka qenë një nga kërkesat më të artikuluar nga vetë të rinjtë gjatë vlerësimit të nevojave për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-29. Një nisëm e iniciuar nga MSHRF gjatë vitit 2022 ka qenë hartimi i Programit Jashtë Orarit Mësimor (JOM) si një program jashtë shkollor në 5 disiplina: arte, zeje, agrikulturë dhe mjedis, sport, dhe teknologji për fëmijët dhe të rinjtë. Gjatë vitit 2023 programi ka vijuar zbatimin e programit në 200 shkolla në të gjithë vendin dhe me përfitues rreth 10,000 të rinj. Edhe gjatë vitit 2024 po vijon puna për shtrirjen e programit në shkollat e tjera të vendit dhe për konceptimin e nivelit të dytë të tij që synon formimin e talenteve më të spikatura.

Gjatë vitit 2023, Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor RYCO ka lançuar një program të ri të quajtur Fondi Kulturor i Rinisë së Ballkanit Perëndimor i cili do të zbatohet me mbështetjen financiare nga Qeverisë Gjermane në vlerën prej 300,000 euro çdo vit. Ky fond përveç mbështetjes për organizatat rinore të orientuara drejt fushës së kulturës, mbështet edhe aktivizimin kulturor të të rinjve dhe zgjidhjet kreative për çështje sociale dhe politike në Ballkanin Perëndimor, duke përforcuar bashkëpunimin kulturor brenda rajonit. Fondi Kulturor i Rinisë lançoi thirrjen e parë në tetor 2023 dhe do të ketë 10 thirrje të hapura deri në vitin 2026. Gjithashtu do të mbështeten financiarisht projekt-ide të të rinjve nga 1,000 - 3,000 euro, dhe deri në 6,000 euro për organizatat rinore.

*Përmes punës dhe veprimtarisë së organizatave rinore/për të rinjtë mund të nxitet angazhimi dhe krijimtaria e të rinjve në dimensionet artistike, kulturore, sociale dhe edukative dhe përcimi i vlerave tek bashkëmoshatarët e tyre.*

## **1.2 Impakti i zhvillimit të sektorit në rajon/ose më gjerë**

Forumi Rinor Evropian është platforma më e gjerë e organizatave rinore në Evropë, e cila përfaqëson mbi 100 organizata rinore, duke sjellë më pranë dhjetëra milionë të rinj nga e gjithë Europa. Forumi Rinor Evropian financohet nga Fondacioni Rinor Evropian, Këshilli i Evropës, si dhe Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.

Indeksi i Progresit Rinor, i hartuar nga Forumi Rinor Evropian në bashkëpunim me "Social Progress Imperative", është instrumenti më shterues matës i mirëqenies së të rinjve në botë.

Ky Indeks identifikon dhe analizon të dhënat mbi aspekte thelbësore të mirëqenies së të rinjve, si aksesimi në mirë-ushqyerje, strehim, shërbime shëndetësore, mundësia për të ushtruar të drejtat e tyre vendimmarrëse dhe politike, gjithë përfshirje, mos-diskriminim etj.

Edicioni i tretë i Indeksit të Progresit Rinor, i publikuar në tetor të vitit 2023 përfaqëson vlerë të shtuar, duke mundësuar dhe një platformë interaktive online për paraqitjen e treguesve të analizuar

në Indeks, përtej hartëzimit të progresit rinor në të gjithë botën për 12 vite. Edicioni i tretë i Indeksit të Progresit Rinor (2023) përbën një instrument matës të mirëqenies së të rinjve në 153 shtete për 12 vite. Analiza e të dhënave të paraqitura në këtë raport tregon se, Shqipëria është një ndër vendet që kanë treguar më tepër progres në treguesit e analizuar nga Indeksi në 12 vite.

Në raportin e sipërcituar citohet se 5 shtyllat në të cilat Shqipëria ka bërë progres në vitet e fundit janë: Aksesi në Informacion dhe Komunikim, Aksesi në Edukimin e Avancuar, Strehimi, Liria Personale dhe e Zgjedhjes, si dhe Gjithëpërfshirja<sup>19</sup>.

Referuar tre qëllimeve të politikës të Strategjisë Kombëtare të Rinisë, objektivave specifike dhe masave të parashikuara, si dhe në kuadër të konstatimeve të Indeksit të Progresit Rinor, në të cilat raportohet progresi i vendit tonë, më poshtë pasqyrohen gjetjet kryesore:

- Përmirësimi i dukshëm në aksesin për informacion dhe komunikim

Kjo shtyllë lidhet me përpjekjet për të promovuar aksesin në qeverisje dhe vendimmarrje, ku për Shqipërinë raportohet një rritje konstante, prej +26.08 pikësh nga 2014 në 2022, një rezultat pak më i lartë se mesatarja evropiane.

- Përmirësimi në akses në edukimin e avancuar

Referuar kësaj shtylle raportohet se, në vitin 2022, 55% e vajzave të reja 25-29 vjeç, kanë pasur akses në edukimin e avancuar, krahasuar me 43% të tyre në vitin 2011.

Gjithashtu, në raport citohet se cilësia e universiteteve është rritur në 12 vitet e fundit, me një rezultat 41%, duke e renditur Shqipërinë në të njëjtin rezultat me Slloveninë.

Përveç sa më sipër, në Indeksin e Progresit Rinor vlerësohet edhe renditja e çdo shteti krahasuar me mesataren e 15 shteteve me GDP të përafërt. Rezultatet tregojnë se Shqipëria performon brenda kufirit të parashikuar, referuar zhvillimeve ekonomike të vendit.

Në raport theksohet se, përveç indikatorëve pozitivë, ku Shqipëria tregon rezultat të lartë, janë edhe disa fusha, ku kërkohet vëmendje e menjëhershme dhe përmirësimi është i nevojshëm, të tilla si: punësimi i të rinjve, numri i të rinjve jo në edukim, punësim apo trajnim (kategoria NEET), siguria në komunitet, pranimi i personave të komunitetit LGBTI+.

Këto çështje adresohen gjerësisht në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, në objektivat e mëposhtëm:

---

<sup>19</sup> <https://youthprogressindex.org>



- **Objektivi Specifik 1.1:** Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike
- **Objektivi Specifik 2.1:** Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome, kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive;
- **Objektivi Specifik 2.2:** Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre;
- **Objektivi Specifik 2.3:** Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore;
- **Objektivi Specifik 3.1:** Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale;

Më poshtë pasqyrohet një tabelë, ku pasqyrohen indikatorë të matur, të lidhur me shtyllat e sipërcituara për Shqipërinë, duke ju referuar vitit 2011 dhe 2022:

*Tabela 1*

<b>Indikator</b>	<b>2022</b>	<b>2011</b>	<b>% e përmirësimit</b>
Aksesi në qeverisjen online	84.52	12.86	71.66
Liria për të drejtat e zgjedhjes në jetë	74.03	39.39	34.66
Përdoruesit e internetit	72.24	41.2	31.04
Niveli i kënaqësisë me aksesin në sistemin shëndetësor	51.67	24.81	26.86
Mundësitë për të krijuar shoqëri	71.32	52.21	19.11
Përdorimi i karburantëve dhe i mënyrave të gatimit jo-të dëmshme për ambientin	81.3	53.6	17.7
Niveli i kënaqësisë për cilësinë e ajrit	45.21	31.05	14.16

### 1.3 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e Integritimit Evropian

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 e miratuar përmes vendimit Nr.692, datë 26.10.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022-2029”, është një dokument i cili ishte parashikuar në PPAP 2022 dhe PKIE 2022-2024 si pjesë e Kapitullit 26 “Arsimi dhe Kultura”.

Në tetor 2023, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka drejtuar delegacionin shqiptar në konferencën e 30-të Ndërkombëtare “Popullsia dhe Zhvillimi: Sigurimi i të Drejtave dhe Zgjedhjeve” me kërkesë të UNFPA, me qëllim ndarjen e praktikave të suksesshme në fushën e rinisë me mbi 150 vende pjesëmarrëse në këtë konferencë. Proçesi i hartimit të Strategjisë Kombëtare të

Rinisë dhe metodologjia e monitorimit të kombinuar me vlerësim të jashtëm dhe të brendshëm, ka marrë gjithashtu vlerësimin maksimal nga drejtuesit e OKB në Gjenevë, ku Shqipëria është prezantuar me një dokument të standardeve të larta dhe të linjzuar edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Implementimi me sukses i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe përafrimi i tyre me agjendën e integritit në Bashkimin Evropian, ndihmon në përmbushjen e prioriteteve të integritit dhe përmbushjen e kriterëve thelbësore dhe të nevojshme për funksionimin si një shtet me parime Evropiane.

Në këtë kuadër, në përfundim të proceseve screening në BE, rinia si pjesë e Kap. 26 “Arsimi dhe Kultura”, ka vijuar raportimet periodike pranë strukturave Negociatore dhe Kryenegociatore lidhur me zhvillimet e fundit në këtë sektor. Konkretisht në PKIE 2023-2025, janë parashikuar dy ndryshime ligjore si vijon: Ndryshimi i “Ligjit për rininë ”dhe ndryshimi i “Ligjit për vullnetarizmin”, në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera të linjës.

#### **1.4 Komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit**

Referuar ecurisë së realizimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për secilin Objektiv Specifik konstatohet se, pjesa më e madhe e objektivave specifike ka nivel zbatueshmërie të kënaqshëm, duke marrë në konsideratë edhe faktin që ky raport monitorimi është 6 muaj në nivel masash por 12 muaj në nivel monitorimi zbatueshmërie financiare, në një Strategji Kombëtare ku zbatimi i pjesës më të madhe të masave shtrihet në një periudhë afatgjatë 2022/2023-2029.

Masa të përcaktuara:

Masa 1.1.3 Përmes platformës rinore “Të rinjtë për të Rinjtë” dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje 2023-2029.

**Masa 1.2.1** Fuqizohen rolet zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes fuqizimit të saj me burime financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në këtë strategji.

**Masa 1.2.3** Bazuar në konceptin "Të Rinjtë për Të Rinjtë" zhvillohen dhe aplikohen shërbime të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë informimi dhe shërbimesh për të rinjtë dhe organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që do të mbështesë formimin, punësimin, edukimin, mirëqenien, zhvillimin dhe aktivizimin e tyre.

**Masa 1.3.2** Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare.

**Masa 1.3.3** Në përputhje me Ligjin për Rininë dhe aktin nënligjor të dalë në bazë dhe për zbatim të tij, zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë, duke përfutur edhe nga proceset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

**Masa 2.1.4** Nxitet dhe forcohet novacioni, përmes sipërmarrjeve rinore dhe nga të rinjtë duke e vënë novacionin rinor në fokus të kuadrit ligjor dhe politikave publike të Start Ups, politikave të punësimit dhe mbështetjes së nismave si co-working spaces.

**Masa 2.1.5** Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit e më gjerë.

**Masa 3.1.5** Përmirësohen me qasje specifike rinore, miqësore dhe të pranueshme, programet që trajtojnë migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore me në fokus parandalimin e këtyre fenomeneve dhe kthimin e të rinjve në shkollë, trajnim ose punë.

Performanca e realizimit të objektivave specifike të sipërcituar ka ndikuar në trendin e përgjithshëm të realizimit të qëllimit politik 1, 2 dhe 3 dhe rekomandohet koordinimi i punës ndërmjet institucionit udhëheqës dhe institucioneve kontribuuese për marrjen e hapave të nevojshëm konkretë për zbatimin e masave për secilin objektiv.

### **1.5 Ekzekutimi i përgjithshëm i masave të strategjisë**

Për periudhën raportuese, Korrik 2023 - Dhjetor 2023, ka nisur zbatimin e tre Qëllimeve Politike. Për Qëllimin e Politikës I janë raportuar 16 masa, për Qëllimin e Politikës II janë raportuar 10 masa, dhe për Qëllimin e Politikës III, janë raportuar 13 masa. Në total janë raportuar 39 masa.

### **Realizimi Financiar**

Ashtu siç bëhet analiza e realizimit për treguesit, për strategjinë është analizuar edhe realizimi financiar ose ndryshe monitorimi financiar. Kjo analizë është bërë në nivel masash, objektivash dhe qëllimesh. Për secilën masë, objektiv ose qëllim janë krahasuar vlerat e raportuara financiare me vlerat e planifikuara në momentin e miratimit të strategjisë për secilin nga zërat e buxhetit që janë (i) paga dhe sigurime shoqërore (ii) materiale, shërbime dhe kontigjenca dhe (iii) shpenzime kapitale.

Metodologjia e ndjekur në mënyrë që të vlerësohet dhe mëtej realizimi apo jo i masave, iu referua disa hapave si vijon:

#### **1. Identifikimi i shpenzimeve të planifikuara**

Këto të dhëna janë marrë në Planin e Veprimit të SKR 2022 -2029

#### **2. Identifikimi i shpenzimeve faktike.**

Identifikimi i shpenzimeve faktike është një nga vështirësitë më të mëdha në vlerësim. Kjo për arsye se:

a. aktualisht nuk ka një metodologji standarte të gjithëpranuar të monitorimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Mungesa e metodologjisë bën që institucionet të mos raportojnë fare të dhënat financiare, ose të raportojnë të dhëna të një cilësie të dobët;

b. nuk vlerësohet monitorimi financiar i strategjisë pasi ka ndryshime të mëdha në krahasim me planin;

c. burimet e informacionit për fondet e donatorëve janë të kufizuara.


Për të shmangur këto vështirësi, të dhënat u morën nga raportimi i institucioneve, dokumente zyrtare, monitorimi të buxhetit vjetor, dokumenti i PBA, faqe zyrtare institucioni ku ka të dhëna financiare të raportuara dhe referencuara.

Në rastet kur cilësia e të dhënave ka qenë e dobët është gjykuar për realizimin e masës duke u nisur nga sasia dhe lloji i aktiviteteve që janë raportuar si të realizuara.

3. Identifikimi i shfazimit të shpenzimeve.

Në rastet kur për arsye vendimmarrje, realizimi i masës është shtyrë në kohë ose është sjellë përpara në kohë, është bërë krahasimi duke u nisur nga buxheti i aktiviteteve që janë realizuar në 2023.


Rezultatet në nivel strategjie janë:



Norma e realizimit të shpenzimeve kapitale është 96%, ndërkohë që norma e realizimit të pagave dhe sigurimeve shoqërore është 49%. Pak a shumë në të njëjtat nivele (në vlerën 50%) është edhe norma e realizimit të materialeve, shërbimeve dhe kontigjencave. Nga të dhënat vihet re që ka pasur vështirësi në realizimin e fondeve të parashikuara për paga dhe shpenzime korente, kryesisht të lidhura me planifikimin në SKR për shtesë me 10 punonjës të strukturës së AKR. Arsyet e detajuara jepen më poshtë për secilin qëllim apo objektiv apo masë të strategjisë. Norma e realizimit të fondeve totale të strategjisë është 56%.

Tabela 3

## Realizimi Strategjia dhe tre qëllimet



Nëse bëhet krahasimi i realizimit të shpenzimeve për tre qëllimet e strategjisë vihet re se norma e realizimit luhetet nga njëri qëllim në tjetrin.

Në seksionin e mëposhtëm jepet analiza e detajuar përsa i përket realizimit financiar të strategjisë në 2023.

### 2. Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

#### QËLLIMI POLITIK I

Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore.

Qëllimi Politik I ka në përmbajtje të tij 3 Objektiva Specifikë dhe 16 Masa, të cilat fillojnë zbatimin e tyre gjatë periudhës raportuese. Ky qëllim politik zërthehet në masa që lidhen me rishikimin e legjislacionit në fuqi në fushën e rinisë, pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, nëpërmjet ngritjes dhe fuqizimit të mekanizmave/institucioneve në nivel vendor dhe qendror, si dhe në shkolla/universitete, mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e rinisë, si dhe hartimin e politikave rinore mbi baza shkencore dhe analiza faktike.


#### Përmbledhje për Qëllimin Politik 1

##### Realizimi Financiar

Për këtë qëllim janë analizuar 16 masa. Realizimi i masave në bazë të analizës financiare për të tre objektivat e qëllimit të parë është si më poshtë:

Tabela 4


## Statusi i realizimit të masave të Qëllimit 1



Në bazë të analizës së masave kalohet tek analiza e realizimit të objektivave dhe qëllimit përkatës. Për këtë qëllim politik dhe dy qëllimet e mëtejshme është analizuar edhe realizimi nga ana financiare dhe rezulton se zëra të ndryshëm të shpenzimeve kanë nivel realizimi të ndryshëm.

Tabela 5

## Realizimi Qëllimi I i SKR për vitin 2023




**Kështu realizimi i fondeve totale është 72%.** Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 41%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 73%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 85%. Rreth 85% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 15% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Ashtu si edhe për objektivat dhe masat e këtij qëllimi apo dy qëllimet e tjera me objektivat dhe masat përkatëse, vlen të theksohet se ka masa, realizimi i të cilave është shtyrë në kohë, pra ka filluar në 2023 dhe jo në 2022, ashtu siç edhe ka masa dhe objektiva, realizimi i të cilave është sjellë përpara në kohë si pasojë e vendimmarrjes qeveritare apo edhe e ofrimit të mbështetjes nga donatorë të ndryshëm, që në kohën e hartimit të strategjisë nuk ishte e planifikuar.

Tabela 6

## Realizimi Qëllimi I dhe tre objektivat




Ashtu siç do shpjegohet edhe më poshtë, norma e realizimit për qëllimin dhe tre objektivat varion mes objektivave, por edhe mes zërave të buxhetit.

Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik. Gjithashtu jepet informacioni në lidhje me shkallën e realizimit nga ana financiare për secilin nga objektivat dhe masat përkatëse.

***Objektivi Specifik 1.1: Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike.***

Edhe pse ka masa që kanë mosrealizim, vendimmarrja për realizimin e disa masave të planifikuara më vonë në kohë, sigurimi i mbështetjes nga donatorët për organizimin e aktiviteteve apo edhe për financimin e organizatave rinore në kuadër të thirrjes për projekte bën që hendeku financiar të mbulohet. Normat e realizimit jepen në grafikun e mëposhtëm.

## Realizimi Objektivi 1.1 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale është 89%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 80%. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 80%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 110%. Rreth 85% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 15% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Edhe pse ka masa që kanë mosrealizim, vendimmarrja për realizimin e disa masave të planifikuara më vonë në kohë, sigurimi i mbështetjes nga donatorët për organizimin e aktiviteteve apo edhe për financimin e organizatave rinore në kuadër të thirrjes për projekte bën që hendeku financiar të mbulohet.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 1.1.1. Rishikohet Ligji për Rininë për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimin rinor, punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë.**

Puna për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, nisi që në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, me ndërmarrjen e procesit të vlerësimit të brendshëm nga MSHRF-ja dhe AKR-ja, lidhur me zbatimin dhe ndikimin e tij, duke synuar analizën e situatës, identifikuar problematikën dhe nevojat për ndryshim në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e rinisë.

Në këtë fazë, përqendrimi është te identifikimi i çështjeve dhe nevojave që lidhen me ligjin ekzistues, duke pasur parasysh edhe zhvillimet e reja në këtë fushë. Analiza e kryer synon të identifikojë problematikën e mundshme që mund të kenë ndikim në efektivitetin dhe zbatueshmërinë e ligjit, si dhe të vlerësojë se si mund të adresohen këto çështje përmes ndryshimeve ligjore.

Vazhdimi i procesit të rishikimit të Ligjit për Rininë do të ndjekë të njëjtën qasje të bashkë krijimit të zbatuar në rastin e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe do të synojë angazhimin dhe marrjen e kontributeve të aktorëve të jashtëm. Paketa e amendimeve të Ligjit nr. 75/2019 parashikohet të përgatitet, konsultohet publikisht dhe paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave brenda vitit 2024, në përputhje me parashikimet në Planin e Veprimit të SKR-së, si dhe raportimet



përkatëse në PPAP 2024 dhe Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian PKABE 2030.

Kjo përpjekje për përmirësim dhe rishikimin të ligjit ka një rëndësi të veçantë për të siguruar që politikat dhe masat e qeverisë të jenë të përshtatshme dhe efektive në mbështetjen e zhvillimit dhe mirëqenies së rinisë.

Hapat e ndërmarra në lidhje me procesin e rishikimit të ligjit Rishikimi i Ligjit 75/2019 për Rininë, janë si vijon:

Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2019 duke shënjuar një hap pozitiv në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor që mbështet zhvillimin e të rinjve në aspektin social, ekonomik dhe kulturor dhe u siguron atyre më shumë mundësi aktivizimi, komunikimi institucional dhe financimi publik për plotësimin e nevojave dhe interesave në fusha të ndryshme. Institucionalizimi i ndërveprimit me të rinjtë, rregullimi i formave të angazhimit rinor si edhe promovimi i rolit të të rinjve si aktorë ndryshimi, përfaqësojnë kontributet e rëndësishme që shënoi miratimi i një ligji të veçantë për rininë. Në procesin e hartimit të këtij ligji u bë referencë në praktika të mira si në rastin e Bullgarisë apo Serbisë, tek e cila u përqs modeli i Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore dhe kriteret që ajo duhet të plotësonte në terma të përfaqësimit të organizatave dhe individëve por edhe mbulimit territorial.

Ligji prezanton disa koncepte të rëndësishme si edukimi joformal për të rinjtë që lidhet me veprimtaritë jashtë sistemit arsimor dhe të bazuar në vullnetarizëm e pjesëmarrje aktive; Dialogu i strukturuar mes të rinjve, organizatave të tyre, organizatave që punojnë me ta dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore nga ana tjetër duke theksuar bashkëpunimin e bazuar në ndërveprim aktiv, sistematik, transparent, të vazhdueshëm dhe afatgjatë. Hapësira të sigurta rinore, por vetëm si hapësira fizike të sigurta për të rinjtë, përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara por pa kaluar në elementet digjitale apo të platformave sociale e qytetare të hapësirave të sigurta për të rinjtë.

Ligji parashikon ngritjen e këtyre strukturave organizative:

- ✘ Institucioni përgjegjës për rininë është Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR) e krijuar me vendimin Nr. 681, datë 2.09.2020 të Këshillit të Ministrave dhe zëvendëson Shërbimin Kombëtar Rinor (SHKR). Këshilli Kombëtar i Rinisë, një organ këshillimor që funksionon në kuadër të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe është përgjegjës për rininë. Vendimi Nr. 969, datë 2.12.2020 i Këshillit të Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe organizimin dhe funksionimin e tij.
- ✘ Këshilli Vendor i Rinisë është një organ këshillimor, i cili funksionon në varësi të kryetarit të bashkisë në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore.
- ✘ Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (OKPR), që krijohet si OJF për të përfaqësuar të rinjtë në përputhje me vendimin Nr. 274, datë 12.05.2021 të Këshillit të Ministrave.

Ndërkohë që procesi i zbatimit në praktikë të objektivave dhe parashikimeve të Ligjit është përshpejtuar gjatë tri viteve të fundit, disa aspekte të tij mbeten pjesërisht apo tërësisht të pa

zbatuara. Vetë Strategjia Kombëtare të Rinisë dhe Plani i saj i Veprimit 2022-2029<sup>20</sup> ofrojnë disa tregues bazë në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen në ligj. Në kuadër të qëllimit të politikës që lidhet me fuqizimin e organizimit rinor dhe rritjen e pjesëmarrjes rinore, ky dokument strategjik parashikon në kuadër të planit të veprimit rishikimin e ligjit për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimit rinor, punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë.

Bazuar në Vendimin nr. 790, datë 28.12.2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”, rishikimi i Ligjit Nr. 75/2019 “Për rininë” është parashikuar si propozim i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe duhet të miratohet nga gjatë katër-mujorit të III-të të vitit 2024.

Ky projektligj ka për qëllim të konsolidojë kuadrin rregullator për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve shqiptarë në mënyrë gjithëpërfshirëse duke përmirësuar dhe rregulluar ligjin ekzistues 75/2019 “Për Rininë”.

#### *Kalendari i punës dhe aktivitetet e zbatuara.*

Qëllimi i projekt ligjit synon të konsolidojë kuadrin rregullator për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve shqiptarë në mënyrë gjithëpërfshirëse duke përmirësuar dhe rregulluar ligjin ekzistues 75/2019 “Për Rininë”. Objektivat konkrete që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji përfshijnë:

- Rregullimi i dispozitave të ligjit të cilat janë vlerësuar problematike në zbatim (të pa zbatueshme; ose zbatim pjesor)
- Përmirësimi i ligjit për të rritur efektivitetin e ligjit në raport me objektivat politike të tij (mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që veprojnë në fushën e rinisë).
- Lidhja me planin kombëtar për aderimin në BE-së.
- Harmonizimi i ligjit me parashikimet e Rekomandimit të Këshillit Europian (2020/C 415/01) i 5 Prillit 2022 për Mobilitetin e Vullnetarëve të rinj në BE (2022/C 157/01)
- Harmonizimi i ligjit për Rininë me legjislacionin sektorial (Legjislacioni për nxitjen e punësimit; rininë; AFP; Arsimin; vetëqeverisjen vendore; menaxhimin e financave publike etj.)
- Çështjet që rregullon projekt-akti.

Nëpërmjet projektligjit do të zhvillohen më tej dhe qartësohen parashikimet e ligjit ekzistues sa i takon punës dhe punonjësve rinorë, infrastrukturës rinore, organizatës rinore duke e harmonizuar me legjislacionin në fuqi për organizatat jo fitimprurëse, do të rishikohen kriteret për ngritjen e

---

<sup>20</sup> VKM Nr. 692, datë 26.10.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029”;

organizatës kombëtare përfaqësuese rinore dhe do propozohen mekanizma të reja mbështetëse për fuqizimin e strukturave përfaqësuese rinore në nivel qendror dhe vendor dhe për mbështetjen progresive së të drejtave të të rinjve, etj.

Është miratuar metodologjia për hartimin e Projektligjit ku përfshihet:

1. Ngritja e grupit ndërinstitucional të punës me urdhër të MSHRF-së;
2. Proçesi i vlerësimit për rishikimin ligjor duhet të jetë gjithëpërfshirës duke përfshirë si vlerësimin e 75/2019 dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij;
3. Përgatitja e propozimeve për rishikimin e ligjit dhe RIA duke adresuar problematikat e dala nga vlerësimi dhe rregullimet në ligj bazuar në modelet krahasuese;
4. Konsultimi me aktorët dhe grupet e interesit për diskutimin e projektligjit, Këshillin Kombëtar të Rinisë dhe Konsultimin publik;
5. Bashkërendimi i projektligjit në KM, Këshillin Konsultativ QQ- QV.


Veprimtaria e grupit ndërinstitucional të punës jepet si vijon: përmes Urdhrit nr.13, datë 13.11.2023, të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është ngritur Grupit Ndërinstitucional i Punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë" me anëtarë nga kabineti i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Agjencia Kombëtare e Rinisë. Grupi i punës i zhvillon mbledhjet fizikisht ose online; anëtarët e tij sigurojnë dhe shkëmbejnë informacionin në kohë/të përditësuar lidhur me çështjet që lidhen me veprimtarinë institucionale specifike; përgatit propozimet ligjore, raportet dhe materialet për miratim; mbështetet dhe bashkëvepron me rrjetin e OSHC-ve rinore/për të rinjtë, KKR, dhe ekspertë të fushës.

## Realizimi Financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, për hartimin dhe miratimin e ligjit janë ndërmarrë një sërë veprimesh apo aktivitete, por zbatimi i veprimeve ka filluar në 2023 dhe jo në 2022 (siç parashikohej në dokumentin e SKR 2022 - 2029).

Përsa i përket monitorimit të kostove dhe shpenzimeve të planifikuara për këtë vlen të theksohet që krahasohen fondet e planifikuara në 2022 me fondet e realizuara në 2023. Kjo vendimmarrje u bë pasi siç u përmend më lart, puna për këtë masë ka filluar në 2023. Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 90%.

### Realizimi Masa 1.1.1 i SKR për vitin 2023



Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 79%. Nuk është realizuar fondi i pagave pasi një pjesë e aktiviteteve të kësaj mase janë planifikuar të realizohen në 2024. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca, niveli i realizimit është 167% pasi në 2023 janë realizuar edhe aktivitetet e planifikuara për në 2022 dhe për këtë arsye realizimi është i lartë. Kështu, në 2023 institucioni ka pasur mbështetje nga donatorët për të pasur mbështetjen e një eksperti vendas. Nuk është realizuar plotësisht fondi i ekspertit pasi një pjesë e aktiviteteve të kësaj mase janë planifikuar të realizohen në 2024. Në 2023 janë realizuar aktivitetet e planifikuara në 2022 ndërkohë shpenzimet kapitale nuk janë planifikuar. Rreth 76% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe rreth 24% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Me këtë masë si pasojë e mbështetjes së donatorëve është arritur që të ketë më shumë fonde të shpenzuara sesa ato të planifikuara me një vlerë prej 171,400 lekë.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

### **Masa 1.1.2 Forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rinjve apo të rinjve në vendim-marrje.**

Përsa i përket forcimit të mekanizmave në nivel qendror për të garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje, përforcimi i kapaciteteve dhe aftësive të Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR) për konsultimin dhe përfaqësimin e të rinjve është një hap thelbësor.

Me datë 15 Nëntor 2023, bazuar në nenin 9 të Ligjit 75/2019 “Për Rininë” u mblodh Këshilli Kombëtar i Rinisë ku ishin prezentë të gjithë anëtarët e mandatit të dytë të KKR-së. Në këtë mbledhje u ndërморën hapa konkretë për të zbatuar misionin e KKR-së, ku përmendim zgjedhjen e zëvendës kryetarit dhe caktimi e detyrave për anëtarët për dy vitet e ardhshme për të garantuar që puna e tyre të jetë sa më efektive. Çështje të tjera që u diskutuan në mbledhjen e parë të anëtarëve të KKR kishin të bënin me ndërveprimin mes KKR-së dhe KVR-ve (Këshillave Vendorë Rinorë) si dhe me shpalljen e Thirrjes për infrastrukturë rinore nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Ndërkohë, referuar forcimit të mekanizmave të pjesëmarrjes rinore në nivel lokal, përmes ndërveprimit institucional, aktiviteteve ndërgjegjësuese në terren dhe shkëmbimit të praktikave të mira nga MSHRF-ja dhe AKR-ja, me 61 njësi të vetëqeverisjes vendore të vendit, u përshpejtua procesi i ngritjes së këshillave vendorë rinorë konform parashikimeve të Ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë”. Si rezultat, në dhjetor 2023 u evidentuan 60 KVR të ngritura (nga 61 në total), me përjashtim të Bashkisë së Vaut të Dejës. Megjithatë, kjo e fundit ka hapur tashmë thirrjen publike për krijimin e KVR të saj, dhe procesi pritet të finalizohet në janar 2024.

Paralelisht me procesin e ngritjes së KVR-ve, MSHRF-ja dhe AKR-ja kanë mbështetur rritjen e kapaciteteve të këshillave vendorë rinorë përmes organizimit të workshopeve/trajnimeve në bashkëpunim me donatorë të huaj/OSHC-të rinore.

- Në datat 21-23 Dhjetor 2023, u zhvillua në Sarandë Shkolla Dimërore ku morën pjesë punonjësit rinorë të 51 bashkive. Kjo shkollë u përqëndrua në rritjen e kapaciteteve të punonjësve rinorë dhe trajtoi tema të rëndësishme si: përfshirja e të rinjve nga bashkitë

vendase në aktivitete sociale, kulturore, ekonomike dhe sportive; fuqizimi i Këshillave Vendorë Rinorë; njohja me Strategjinë Kombëtare të Rinisë; si dhe njohja me thirrjen Nr. III për grante për infrastrukturë rinore. Ky aktivitet u financua nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe World Vision Albania, duke shërbyer si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive mes punonjësve rinorë të bashkive në Shqipëri.

- Më 4 Korrik 2023, u organizua në Golem kampi "Rinia Vlerëson", ku morën pjesë 140 të rinj nga 59 Këshillat Vendor Rinorë. Ky aktivitet shërbeu si platformë për të diskutuar çështjet e raportimit për Strategjinë Kombëtare për Rininë (SKR), monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm të projekteve rinore. Në këtë kamp, u shpërnda pyetësoi U-Report dhe u prezantuan përfundimet e tij, duke i dhënë rëndësi të veçantë opinionit të të rinjve në proceset vendimmarrëse. Nëpërmjet këtij aktiviteti, u bë ndarja e përvojave nga anëtarët e Këshillave Vendor Rinor, duke përfshirë ide të reja për implementimin në qytetet e tyre. Ky aktivitet u mbështet nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për realizimin dhe suksesin e kampit "Rinia Vlerëson".
- Më datën 16 Dhjetor 2023, u organizua aktiviteti "Fuqizohemi së Bashku", një ngjarje e rëndësishme ku 80 të rinj nga Shqipëria, anëtarë të Këshillave Vendor Rinor, bashkë me 20 të rinj nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, u mbledhën për të fuqizuar lidhjet e bashkëpunimit dhe për të ndarë përvojat pozitive nga politikat për rininë, me fokus të veçantë në integrimin në Bashkimin Europian. Temat e trajtuara gjatë aktivitetit përfshinë politikat rinore në Ballkanin Perëndimor, modele dhe politika rinore pozitive për këtë rajon, si dhe perspektivën e të rinjve për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Aktiviteti po ashtu ofroi një platformë për të ndarë përvoja mes të rinjve nga vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor. Ky aktivitet u realizua me mbështetjen financiare të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA).

Me zhvillimin e teknologjisë, tashmë 94.4% e të rinjve kanë akses në internet dhe bashkë me këtë vijnë edhe efektet anësore të saj. Për të minimizuar të gjitha këto problematika, si dhe në kuadër të ditës ndërkombëtare të internetit të sigurt, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka ndërmarrë një nismë të re, për krijimin e një manuali për internetin e sigurt nga vetë të rinjtë.

Në kuadër të kësaj nisme, nga MSHRF dhe AKR, në datë 22 Shkurt 2023 u zhvillua një takim online për prezantimin e manualit "Trajnimi Mbi Internetin e Sigurt tek të rinjtë e Këshillave Vendor Rinorë". Në takim morën pjesë mbi 100 përfaqësues nga 54 Këshilla Vendorë Rinorë, ku u diskutua për problematikën që hasin fëmijët dhe të rinjtë në internet, si dhe hapat për krijimin e manualit.

Rritja e efektivitetit të strukturave si Këshilli Kombëtar i Rinisë dhe Këshillave Vendore Rinore do të vijojë të mbështetet përmes aktiviteteve të posaçme të zhvilluara në kuadër të SKR 2022-2029.

## Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, punonjësit e AKR kanë qenë të angazhuar gjatë gjithë vitit në koordinimin e aktiviteteve të ndryshme. Gjatë 2023 janë realizuar dhe janë mbështetur aktivitete shumë të rëndësishme si Kampi veror "Rinia Vlerëson", apo Konferenca me temë "Fuqizohemi së bashku - Këshillat Vendor Rinor të Ballkanit Perëndimor"

Realizimi i fondeve totale është 100%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%.

Tabela 9

## Realizimi Masa 1.1.2 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 100% pasi në 2023 ka pasur mbështetje dhe angazhim të donatorëve, siç është shpjeguar edhe më lart, ndërkohë shpenzimet kapitale nuk janë planifikuar. Rreth 1.6% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe rreth 98.4% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Në këtë masë aktivitetet janë mbështetur nga donatorët. Angazhimi i donatorëve në financimin e aktiviteteve ka bërë që hendeku financiar për këtë masë për 2023 të jetë 0 nga 4273000 lekë të planifikuara.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

**Masa 1.1.3** Përmes platformës rinore “Të rinjtë për të Rinjtë” dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje 2023-2029.

Kjo masë **nuk është realizuar ende**.

## Realizimi financiar

Për këtë masë ka realizim vetëm të shpenzimeve për pagat për fushatat sensibilizuese pasi është parashikuar puna e stafit të AKR. Realizimi i këtij zëri është 50%. Gjithashtu fushata janë realizuar

nga organizatat e ndryshme rinore dhe për të rinjtë që janë shpallur fituese në thirrjet e bëra për këto organizata për projekt propozime.

Ndërkohë portali "Të Rinjtë për Të Rinjtë" nuk është ngritur ende dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në lidhje me ngritjen dhe përdorimin e tij nuk janë realizuar.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e porealizuar**.

**Masa 1.1.4 AKR mbështet me anë të një programi grantesh organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes ngritjes së infrastrukturës për qendra rinore, biblioteka dhe hapësira për të rinjtë.**

*Mbështetja për organizatat dhe bashkitë për projekte me fokus rininë nëpërmjet thirrjes së dytë.*

Në zbatim të ligjit nr.75/ 2019 "Për rininë", VKM nr. 681, datë 02.09.2020 "Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë", si edhe konform ndryshimeve ligjore, diktuar nga VKM nr. 566 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë", Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka publikuar Thirrjen Publike Nr. 3, datë 27.04.2023 e cila ka qëndruar e hapur për një afat kohor prej 30 ditësh.

Gjatë periudhës raportuese, Korrik - Dhjetor 2023, ka vijuar zbatimi i projekteve fituese të Thirrjes së Dytë publike të programit të grantdhënies për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Si risi, këtë vit është dyfishuar granti për rininë dhe është siguruar efektivitet i lartë dhe transparencë në menaxhimin e thirrjeve për projekt-propozimet rinore, nëpërmjet metodologjisë LOD.

Nëpërmjet 24 projekteve fituese të Thirrjes II të AKR kanë përfitur në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi 7000 të rinj e të reja në 25 bashkitë: Devoll, Bulqizë, Tiranë, Korçë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Durrës, Kavajë, Gjirokastrë, Sarandë, Lushnje, Fier, Rrogozhinë, Mat, Tepelenë, Berat, Pogradec, Pukë, Fushë-Arrëz, Kamëz, Vau i Dejës, Skrapar, Maminas, Konispol, nëpërmjet 20 projekteve, si dhe në nivel kombëtar nëpërmjet 3 projekteve me shtrirje gjeografike në 61 bashki, si më poshtë vijon:

1. "Qendra ABC Tirana Club", me projektin "*Qyteti im evropian, Edicioni IV*".
2. "Instituti për konsulencë dhe kërkime", me projektin "*Fuqizimi i të rinjve për të lulëzuar sot dhe nesër në tregun e punës*".
3. "EESTEC LC Tirana", me projektin "*Youth for work and Entrepreneurship*".
4. "Unioni i sipërmarrësve të rinj të Shqipërisë" me projektin "*Aftësim dhe punësim për të rinjtë*".
5. "Qendra Protik", me projektin "*I STEM*".
6. "Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale", me projektin "*Fuqizohu në botën digjitale*".
7. "Qendra për ekselencë destiny-QED", me projektin "*Rinia udhëheq mirëqenien-RUM*".

8. Qendra “Lëvizja rinore për demokraci-Pukë” me projektin “*Rivitalizimi i sipërmarrjeve tradicionale për fuqizimin ekonomik të të rinjve*”.
9. “Qendra Youth Act” me projektin “*Rinia novatore*”.
10. “Linja e këshillimit për gra dhe vajza” me projektin “*Angazhimi qytetar dhe edukimi i djemve dhe vajzave “Bëhu burrë”*”!
11. “Women in technology Albania” me projektin “*3D Youth of Kavaja and Lushnja*”.
12. Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” me projektin “*Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit*”.
13. Shoqata “Albanian Committee of Medical Students” me projektin “*Youth for mental health*”.
14. “Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve” me projektin “*Dy të premtë në muajt janë RINI*”.
15. “Shoqata Mega Art” me projektin “*E para është vallja*”.
16. Qendra “AMAD” me projektin “*FuqiZona: Rritje kapacitetesh rinore*”.
17. Organizata “SWANS” me projektin “*We are all made of stars-2*”.
18. “Qendra Shqiptare për një zhvillim të qëndrueshëm” me projektin “*Aftësim dhe punësim për të rinjtë*”.
19. “Power of Education” me projektin “*Super Youth*”.
20. Qendra “Promus” me projektin “*Build in*”.
21. Qendra “Akademia e Studimeve Politike” me projektin “*Së bashku për të zhvilluar karrierën në Shqipëri*”.
22. “Qendra për Iniciativa Rajonale” me projektin “*Aftësimi i të rinjve për punë*”.
23. “ANEI - Albanian Network for European Integration” me projektin “*Rinia-garanci për të ardhmen evropiane të vendit*”.
24. “Partnerë për Fëmijët”, me projektin “*Ç’do të bëhesh kur të rritesh?*”- Mbështesim të rinjtë në karrierën e tyre (mbështetur financiarisht nga UNICEF).

Ndërsa, për projekt propozimet e ardhura nga bashkitë e vendit është siguruar një fond prej 50 milionë lekësh në total, për të mbështetur infrastrukturë rinore si qendra rinore, biblioteka apo hapësira për të rinjtë. Nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në 9 Dhjetor 2022, së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, u nënshkruan kontratat me Bashkinë e Durrësit, Dibrës, Gjirokastrës, Kamzës dhe Lushnjës, si fitues të granteve nga Thirrja e dytë për projekt propozime rinore, të cilat u financuan me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet AKR-së:

1. Bashkia Durrës me projektin “*Rindërtim i Qendrës Rinore Multifunksionale Durrës*”.
2. Bashkia Gjirokastrë me projektin “*TRY- Gjirokastra*”.
3. Bashkia Lushnje me projektin “*Të rinjtë për të rinjtë*”.
4. Bashkia Dibër me projektin “*Biblioteka dhe të rinjtë*”.
5. Bashkia Kamëz me projektin “*Bashkë për një Rini Aktive*”.



Nëpërmjet ndërhyrjeve në infrastrukturën rinore në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përfituar dhe vijojnë të përfitojnë 106,882 të rinj. Në bashkitë e Dibrës, Kamzës dhe Lushnjës, me anë të këtij financimi ka filluar rikonstruktimi apo ndërtimi i një biblioteke për qytetin, të konceptuara kështu jo vetëm si vende leximi, por edhe si hapësira multifunkionale, ku të rinjtë do të angazhohen në trajnime dhe bashkëbisedime të ndryshme. Ndërsa në Bashkitë e Durrësit dhe Gjirokastrës, me anë të këtij financimi ka filluar ndërtimi i Qendrave Rinore Multifunkionale.

*Mbështetja për organizatat dhe bashkitë për projekte të dedikuara për rininë nëpërmjet thirrjes së tretë nga AKR.*

Në zbatim të ligjit nr.75/ 2019 “Për rininë”, VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, si edhe konform ndryshimeve ligjore, diktuar nga VKM nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka publikuar Thirrjen Publike Nr. 3, datë 27.04.2023 e cila ka qëndruar e hapur për një afat kohor prej 30 ditësh. Prioritetet e thirrjes ishin si më poshtë vijon:

1. Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe mbështetja e aktivizimit shoqëror dhe qytetar të tyre.
2. Nxitja e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.
3. Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

Nga thirrja e tretë për rininë po financohen 23 projekt propozime rinore të organizatave rinore/për të rinjtë, nga të cilat 3 projekt propozime rinore po mbështeten nga UNICEF, UNDP, dhe UNFPA. 20 projekt propozimet të cilat po financohen nga Agjencia Kombëtare e Rinisë janë në vlerën totale 58 milionë lekë (buxheti 2023).

Në përfundim të procesit të vlerësimit, projektet e shpallura fituese renditen si më poshtë:

1. Organizata “The Door” me projektin “*Rinia në Veprim*”. Qëllimi i këtij projekti është nxitja e përfshirjes sociale nëpërmjet krijimit të një stili të ri jetese aktive, në harmoni me natyrën, për të rinjtë e shtresave të ndryshme sociale nga komunitete rural-urbane të Bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Malësi e Madhe dhe Pukë. Synohen përfshirja e 150 të rinjve të informuar dhe sensibilizuar mbi vlerat kulturore të traditës në bashkitë Shkodër, Pukë, Vau i Dejës, Malësi e Madhe (50% vajza–50% djem).
2. Shoqata studentore “Sport dhe Rekreacion” me projektin “*Adventure Sport & Mental and Physical Health in Youth*”. Qëllimi i këtij projekti është aktivizimi sportiv dhe rekreativ i rinisë shqiptare, në ndërthurje me njohuritë dhe aspektet mjedisore. Qëllimi i këtij projekti është të nxisë një bashkëjetesë pa paragjykime, pa diferencime, me barazi sociale i cili do të përfshijë 300 studentët më të mirë të gjimnazeve të Tiranës. Synohet puna në grup për aftësimin në zgjidhje problemesh dhe vendim-marrjesh dhe për afrimin e të rinjve me natyrën; aktivitete në

- bashkitë Himarë – Jalë, Liqeni i Farkës, Kepi i Rodonit, Liqeni i Fjollës (65% vajza – 45% djem).
3. Fondacioni “Qendra MAM” me projektin “*Porta e Fjalës*”. Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një modeli mbi edukimin informal nëpërmjet artit. Synohet organizimi i shfaqjeve me 20 persona në grupe gjithëpërfshirëse me nxënës dhe artistë – përfshirja 80% vajza dhe 20% djem në realizimin e projektit (50% vajza - 50% djem në shikueshmërinë/ndikimin e projektit) shfaqjet dhe diskutimet të cilat do të realizohen në bashkitë Shkodër, Durrës dhe Kamëz.
  4. “Media dhe Çështjet Shoqërore” me projektin “*GenZ*”. Qëllimi i këtij projekti është fuqizimi dhe ndikimi te të rinjtë, duke krijuar një kulturë të debatit, ndërgjegjësimin e tyre qytetar dhe përfshirjen aktive në proceset vendimmarrëse duke inkurajuar dialogun, respektin dhe tolerancën ndaj pikëpamjeve të tjera. Synohet përfshirja e 20 të rinjve në 10 seanca me nga 2 debate pro dhe kundër secila, në bashkitë Tiranë + Vorë, Kamëz (synohet 50% vajza - 50% djem).
  5. “Action for Albania” me projektin “*Action for Youth*”. Qëllimi i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve të të rinjve për aftësimin profesional, mentorimi dhe mbështetja e ideve inovatore të sipërmarrjes (start up-et), ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të bashkive si dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit. Synohet informimi dhe orientimi i rreth 300 të rinjve për nevojat dhe mundësitë e tregut të punës; trajnimi i 60 të rinjve – Programi i Sipërmarrjes (57% vajza - 43% djem) në bashkitë Peshkopi, Burrel dhe Bulqizë.
  6. Shoqata “Ressegnatia” me projektin “*Aktivizimi dhe nxitja e të rinjve për një ambient të shëndetshëm dhe social*”. Qëllimi i këtij projekti është ndikimi në ndryshimin e situatës nëpërmjet aktivizimit të të rinjve për ngritjen dhe krijimin e një modeli të një shoqërie me një mjedis social të shëndetshëm, duke identifikuar zonat me problematika sociale, duke sensibilizuar, informuar dhe aktivizuar të rinjtë dhe qytetarët për një mjedis të sigurt social dhe të shëndetshëm. Synohet aktivizimi dhe pjesëmarrja e 300 të rinjve në bashkitë Elbasan, Peqin dhe Belsh me informacione mbi aftësitë e nevojshme për të qenë aktivistë dhe iniciues të nismave mbi çështjet sociale (50% vajza – 50% djem).
  7. Shoqata “LIBURNETIK” me projektin “*Re-Debate Kampionati Kombëtar i Debatit*”. Projekti ka për qëllim të fuqizojë të rinjtë për të qenë qytetarë pro aktivë, të mirë-informuar dhe me mendim kritik e aftësi të të folurit në publik duke marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në komunitetin e tyre si dhe në jetën publike. Po ashtu, promovimin e kulturës së debatit në Shqipëri. Synohet realizimi i kampionateve të debatit me përfshirjen e 940 të rinjve në 21 bashki (50% vajza - 50% djem) Malësi e Madhe , Shkodër, Kukës, Mirditë, Lezhe , Dibër, Mat, Krujë, Durrës, Tiranë, Kamëz, Elbasan, Patos, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Konispol.
  8. “Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore” (Agri-En) me projektin “*Punësimi i të rinjve në zonat malore është sfidë dhe mundësi*”. Qëllimi i këtij projekti është integrimi i të rinjve në komunitete, motivimi dhe rritja e kapacitetit të tyre për punësim. Synohen 50 të rinj përfitues

- direkt (50% vajza - 50% djem) të përzgjedhur me thirrje të hapur me qëllim trajnimin e tyre në bashkitë Librazhd, Përrenjas dhe Elbasan.
9. “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” CRCA me projektin “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”. Qëllimi i këtij projekti është sigurimi i qeverisjes lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve. Krijimi, modelimi dhe mirëfunksionimi i Qendrës së Shërbimeve me një ndalesë për të rinjtë, si një shërbim model unik, që sjell në një vend të vetëm të gjitha shërbimet publike dhe ato të OSHC-ve për të rinjtë dhe të rejtat, për të mbështetur kujdesin, mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve për një jetë, punësim dhe karrierë të suksesshme. Synohen 2000 të rinj e të reja në bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll (50% vajza – 50% djem) të përfitojnë shërbime të drejtpërdrejta të këshillimit, mbështetjes dhe fuqizimit të tyre.
  10. “Qendra Konkret” me projektin “*Dedicated, Determined and Driven Youth of Elbasan*”: Qëllimi i këtij projekti është edukimi i të rinjve me në fokus vajzat e zonave të Bashkisë Elbasan, Librazhd dhe Gramsh rreth fenomeneve të ndryshme të krimeve kibernetike, risitë e fushës dhe dinamikën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe orientimin e tyre drejt profileve të punës së sigurisë së informacionit dhe profileve të ngjashme me të. Synohet trajnimi i 300 të rinjve (60% vajza – 40% djem) në bashkitë Elbasan, Librazhd dhe Gramsh në fushat e IT dhe sigurisë kibernetike.
  11. Shoqata “Mega Art” me projektin “*Tradita në Lëvizje - Edicioni Rinor*”. Qëllimi i këtij projekti është ruajtja dhe rritja e formave tradicionale të vales popullore dhe asaj të kultivuar, të cilat rrezikojnë të lihen në harresë apo të humbasin. Projekti synon të angazhojë të rinj nga grupet vulnerabël dhe synon të krijojë video tutoriale, të aksesueshme nga të gjithë falas, të cilat mund të sjellin përfitime për shumë të rinj shqiptarë të diasporës. Synohet angazhimi i 350 të rinjve në aktivitete artistike, koncerte dhe workshope (50% vajza - 50% djem) në 10 bashki të vogla.
  12. Organizata “AlbAccess Open” me projektin “*Vlerësimi i jashtëm me pjesëmarrje - Program i thelluar trajnimi*”. Qëllimi i këtij projekti është të rrisë kapacitetet e Këshillave Vendor Rinor (KVR), OSHC-ve dhe të rinjve në Shqipëri për të monitoruar dhe ndikuar në proceset e politikbërjes dhe zbatimit të politikave rinore. Projekti synon të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve, llogaridhënien dhe transparencën në vendimmarrje, duke çuar në përmirësimin e politikave rinore dhe zbatimin efektiv të tyre. Synohet krijimi i një rrjeti të trajnuar individësh/ojft; 200 - 250 përfaqësues nga KKR, KVR- të OSHC-VE, punonjës rinorë + të rinj aktivë në bashkinë Tiranë.
  13. Organizata “New Bridges” me projektin “*Pjesëmarrja e të Rinjve në Vendim-marrje Modelon të Ardhmen*”. Qëllimi i këtij projekti është fuqizimin e të rinjve për një pjesëmarrje aktive në proceset vendimmarrëse dhe mirëqenien e tyre. Synohen 300 të rinj në pjesëmarrje aktive në Bashkitë Berat, Kuçovë dhe Dimal për përmirësimin e angazhimit të tyre dhe funksionimin e KVR-ve (50% vajza – 50% djem).

14. “Qendra shqiptare për integrimin e njerëzve me nevoja të veçanta” me projektin “*Çelësi i harmonisë*”. Qëllimi i këtij projekti është të ndërhyjë në përmirësimin e situatës së të rinjve në Bashkitë Elbasan, Belsh, Peqin dhe Cërrik në aspektin e mirëqenies sociale, shëndetit mendor dhe aktivitetit fizik. Projekti synon të mbështesë fëmijët me nevoja të veçanta, prindërit për nevojat e fëmijëve të tyre, institucione të arsimit publik dhe qendra shëndetësore. Synohet përfshirja e 120 të rinjve nga Bashkitë Elbasan, Belsh, Peqin dhe Cërrik me seanca trajnimesh, aktivitete vullnetare dhe panaire.
15. “Qendra Impakt” me projektin “*Fuqizimi i këshillave rinorë në mbrojtje të mjedisit*”. Qëllimi i këtij projekti është informimi, edukimi dhe trajnimi i anëtarëve të Këshillave Vendor Rinorë dhe anëtarëve të qeverive të nxënësve (si grup i ardhshëm i targetuar për t’u bërë anëtarë të këshillave rinor) rreth tematikave dhe praktikave më të mira të menaxhimit të integruar të mbetjeve për të rritur breza të edukuar që kërkojnë llogari e mbajnë përgjegjësi për mjedisin. Synohen 150 të rinj (50% vajza - 50% djem) të përfshirë dhe anëtarët e KVR-ve në Bashkitë Belsh, Peqin, dhe Cërrik me aktivitete informuese, edukuese dhe orientuese.
16. “Qendra për formimin dhe zhvillimin” me projektin “*Parandalimi i dhunës dhe i krimit të rinjtë përmes sensibilizimit dhe edukimit ligjor mes bashkëmoshatarësh*”. Qëllimi i këtij projekti është realizimi për herë të parë në vendin tonë i një modeli praktik edukimi të të miturve/rinjve përmes ndërveprimit mes bashkëmoshatarëve, ku ata që kanë ose kanë patur rekorde të cenimit të ligjit ndajnë me shokët njohuritë e tyre për të drejtat dhe detyrimet që u njeh dhe u imponon ligji, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Synohet krijimi i 7 fokus grupeve me 7 persona (totali 147 persona) në 3 Bashkitë Kuçovë, Lezhë dhe Sarandë ku do të zhvillojnë seanca trajnimi dhe workshope.
17. “Federata Shqiptare e Skive” me projektin “*Të gjithë në borë*”. Qëllimi i këtij projekti është integrimi dhe zhvillimi i sportit të skive në programet e mësimin të edukimit fizik në shkollat e ciklit fillor dhe të mesëm. Synohen përfshirja e 75-100 të rinj në zonat e Elbasanit, Kukësit, Durrësit dhe Tiranës (50% vajza - 50% djem) në përgatitjen fizike, teorike, skijimi i sigurt dhe garat amatore.
18. Qendra “Youth Rise” me projektin “*Unlock your technological skills*”. Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë duke promovuar aftësitë inovative, digjitale dhe sipërmarrëse. Projekti synon rritjen e aftësive të të rinjtë në mënyrë që ata të mund të përdorin lehtësisht mundësitë e vetëpunësimit në sektorin e ICT dhe të startup-ve të teknologjisë. Synohen përfshirja e 150 të maturantëve dhe studentëve) në trajnimet digjitale (50% vajza - 50% djem) nga Qendra Rezidenciale për të rinjtë e modelit “Shtëpi- Familje”, me takime dhe trajnime digjitale, kontakt i të rinjve me tregun e punës në Bashkitë Kamëz, Fier, Tiranë (SOS) dhe Shkodër (SOS).
19. Qendra “Synergy” me projektin “*Ferma Edukative*”. Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë përgatitjen dhe aftësimin e të rinjve për të kontribuar në zhvillimin e turizmit rural dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve në fermën agroturistike. Nëpërmjet trajnimit, të rinjtë do të fitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për të punuar me sukses në fermën agroturistike dhe për të promovuar turizmin rural në komunitetin lokal dhe në tregun e gjerë. Synohet trajnimi

i 120 të rinjve (50% vajza – 50% djem) në sesione trajnimi të zhvilluara në Bashkitë Tiranë dhe Durrës.

20. Organizata “Be the Change” me projektin “*Të orientuar drejt suksesit*”. Qëllimi i këtij projekti është zbulimi i perceptimit dhe vlerësimi i nevojave që kanë nxënësit lidhur me orientimin në karrierë dhe informacioni që ata kanë mbi tregun e punës si edhe zbulimi i diferencave gjinore në perceptime dhe qëndrime. Informimi dhe forcimi i kapaciteteve të të rinjve për t’u orientuar në karrierë. Rritja e kapacitetit të psikologëve në shkolla dhe mësuesve për këshillim në karrierë të nxënësve. Synohet identifikimi i nevojave dhe mundësitë për zhvillim tek 1000 të rinj nga klasat e 10-ta (50% vajza - 50% djem) në aktivitete trajnimesh, tryeza të rrumbullakëta dhe sesione informuese në Bashkitë Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës. Kontratat mes AKR-se dhe organizatave të sipërcituara janë nënshkruar më datë 26 Shtator 2023. Aktualisht projektet janë në fazë implementimi.
21. Qendra “You are Not Alone” me projektin “*RomActivizëm*” (financuar nga UNFPA/UNDP).
22. “Qendra ABC Tirana Club” me projektin “*Fqinjët edicioni V*” (financuar nga UNFPA/UNDP).
23. “Qendra Europiane” me projektin “*Qyteti në duart e mia - tënxisim aktivizimin dhe vullnetarizmin*” (financuar nga UNICEF).

Shtrirja gjeografike e projekteve fituese në thirrjen e tretë të AKR përfshin 40 bashkitë: Kuçovë, Lezhë, Sarandë, Peshkopi, Burrel, Bulqizë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Belsh, Peqin, Malësi e Madhe, Shkodër, Kukës, Mirditë, Dibër, Mat, Krujë, Kamëz, Patos, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Konispol, Gjirokastër, Librazhd, Përrenjas, Himarë, Cërrik, Vorë, Pukë, Vau i Dejës, Maliq, Devoll, Gramsh, Dimal, Selenicë dhe Bilisht.

Me qëllim rritjen e informimit, Agjencia Kombëtare e Rinisë ka zhvilluar disa trajnime/sesione informuese sa i përket programeve të grant dhënies për organizatat dhe bashkitë:

- Me datë 2-6 Tetor 2023, AKR ka zhvilluar tre sesione informuese me organizatat fituese të thirrjes së tretë. Gjatë këtyre sesioneve, përfaqësuesit e organizatave u udhëzuan dhe u informuan në detaje rreth afateve, procedurave për raportimin narrativ dhe financiar, raporteve progresive, si dhe raporteve të veçanta. Gjithashtu u diskutua për vizitat monitoruese që do të kryhen për kontroll në zyrat e organizatave ose në aktivitetet e tyre të mbajtura në kuadër të projektit. Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga stafi i AKR-së. Gjithashtu përfaqësuesit e organizatës janë sqaruar për paqartësi të cilat lidheshin me zbatimin e projektit si dhe zbatimin e kontratës së grantit me AKR-në.

Gjithashtu duke pasur në konsideratë nevojën për promovimin e procesit të grant dhënies, në periudhën nga 8 Dhjetor 2023 deri më 7 Janar 2024, u realizua shpallja e thirrjes së tretë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Promovimi i kësaj thirrjeje për NJVV-të filloi me publikimin në faqen online të AKR-së, si dhe përmes postimeve në rrjetet sociale të AKR-së dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

- Më 29 Dhjetor 2023 u zhvillua një sesion informues për stafin e NJVV-ve, gjatë të cilit ata u udhëzuan rreth dokumentacionit që duhet të paraqesin për aplikimin e tyre.
- Përveç kësaj, një sesion informues për thirrjen e tretë u organizua përgjatë shkollës dimërore të mbajtur nga AKR, ku u dha një përshkrim i detajuar i kërkesave dhe procedurave për aplikimin në prani të punonjësve të NJVV-ve.

Këto sesione informuese janë pjesë e përpjekjeve për të siguruar që të gjithë aplikantët të kenë informacion të plotë dhe të qartë rreth procesit të aplikimit dhe kërkesave të nevojshme për të qenë të përgatitur për të aplikuar me sukses.


### Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, në këtë masë përfshihet mbështetja e organizatave rinore dhe atyre për të rinjtë si dhe mbështetja infrastrukturore për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Realizimi i fondeve totale është 94%. Kjo vjen për faktin që MSHRF dhe AKR kanë vendosur që fushatat informuese dhe trajnuese për organizatat apo edhe njësitë e qeverisjes vendore të realizohen në pjesën më të madhe, nëpërmjet takimeve dhe platformave të ndryshme në distancë dhe jo me organizim takimesh fizike.

Tabela 10

## Realizimi Masa 1.1.4 i SKR për vitin 2023



Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 90% pasi këtu janë fondet e granteve që jepen për organizatat rinore dhe shpenzimet për sesionet informuese. Ka ndryshuar vlera dhe mënyra e financimit. Në kostim është parashikuar 68 milion nga buxheti i shtetit ndërkohë gjatë 2023 janë financuar 59.2 milion nga buxheti i shtetit dhe 6 milion nga donatorët. Gjithashtu seancat informuese janë bërë online për të krijuar mundësinë që të gjitha organizatat e interesuara të marrin informacionin dhe të kenë mundësi të bëjnë pyetjet që kanë dhe sqarojnë paqartësitë.

I vetmi element i parealizuar është dhe trajnimi i stafit të AKR që ishte planifikuar të bëhej nga donatorët. Pra 4,641,200 lekë janë kosto që i janë kursyer buxhetit të shtetit ose që nuk kanë qenë në këtë vit të domosdoshme. Mbështetja nga donatorët e 3 projekt propozimeve për 2023 është 6

milion lekë. Shpenzimet kapitale, që përfshijnë investimet në infrastrukturë, janë realizuar në masën 100%.

Rreth 94% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe rreth 5% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

### **Masa 1.1.5 Nxitet zhvillimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit dhe mbështetet bërja sa më aktive e Këshillave Studentore/Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve.**

Me qëllim zhvillimin e mekanizmave për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave mes organeve përfaqësuese të nxënësve, më datën 12 Dhjetor 2023 u organizua mbledhja e parë e legjislaturës së re të Parlamentit të Nxënësve. Në këtë mbledhje morën pjesë deputetë të rinj, si dhe një përfaqësi nga legjislatura e mëparshme e Parlamentit të Nxënësve.

Proçesi i zgjedhjes së Parlamentit të Nxënësve është një aktivitet i cili ka përfshirë një numër të madh nxënësish dhe ka për qëllim krijimin e një strukture këshillimi të rëndësishme për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me synimin për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore. Kjo strukturë siguron që zërat e nxënësve të dëgjohen dhe të reflektohen në politikat dhe vendimet që kanë të bëjnë me arsimin në nivel qendror.

Gjithashtu, janë në proçes zhvillimi mekanizmat për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave mes organeve përfaqësuese të nxënësve, studentëve, organizatave rinore, këshillave rinore në nivel vendor, me mbështetjen e qeverisë lokale dhe Këshillit Rinor Vendor.

Në periudhën 31 Gusht - 3 Shtator 2023 u organizua kampi rinor “Rin Camp” në Dhërmi, Vlorë, i financuar nga AKR, UNDP dhe World Vision. Ky aktivitet kishte në qendër të rinjtë dhe synoi të inkurajonte angazhimin e tyre në sferën rinore, duke zhvilluar kapacitetet personale dhe profesionale të tyre. Gjatë këtij kampi, rreth 90 studentë nga universitetet publike dhe private të Shqipërisë morën pjesë dhe u trajtuan në tema të ndryshme, duke zgjeruar njohuritë e tyre në fusha si tranzicioni në tregun e punës, risitë në tregun e punës, politikat rinore, strukturat rinore vendore, lidhshipi dhe aftësitë ndërpersonale, digjitalizimi i vendit të punës dhe arsimit, etj. Në këtë kamp, u ftuan dhe morën pjesë të ftuar nga profile të ndryshme, duke përfshirë përfaqësues të sektorit bankar, të pushtetit vendor, të ambasadave, dhe organizatave jofitimprurëse, për të ndarë përvojat dhe për të ofruar udhëzime të vlefshme për të rinjtë.

### **Realizimi financiar**


Siç përshkruhet edhe më lart, në këtë masë përfshihen aktivitetet e ndryshme të sensibilizimit.

Realizimi i fondeve totale është në masën 68%. Në këtë masë janë parashikuar shpenzime vetëm për zërin e mallrave dhe shërbimeve të cilat po ashtu kanë një nivel realizimi 68%. Tek fondet e

planifikuara përfshihet kosto e RinCamp. Ndërkohë për mbledhjen e Qeverisë së Nxënësve të realizuar nuk ka pasur shpenzime. AKR ka pasur shpenzime në lidhje me organizimin e aktiviteteve.

Tabela II

## Realizimi Masa 1.1.5 i SKR për vitin 2023



Rreth 17% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe rreth 83% janë fonde të mbuluara nga donatorët. Gjatë 2023 janë përfshirë donatorët të cilët kanë financuar RinCamp.

Si konkluzion mund të thuhet se është masë **pjesërisht e realizuar**.

**Masa 1.1.6 Rritet ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja, nëpërmjet promovimit të programeve të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjësuese.**

Në zbatim të programeve specifike për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e target grupeve të veçanta, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vijoi me aktivitetet/takime në terren dhe në ambjentet e institucionit me gratë dhe vajzat.

Aktivitetet u zhvilluan në mënyrë informale, të hapur, shoqërore duke shpresuar që çdo grua të ndihej e lirë, e pagjykuar dhe në vëmendjen e gjithsecilit që është pjesë e aktivitetit.

Në këtë tryezë gratë u përfshinë në aktivitete, në diskutime për eksperiencën e tyre në votime dhe diskutuan për temat si më poshtë:

- \* Si ndihen ato në rast se janë penguar për të votuar, dhe çfarë është e nevojshme të ndryshojnë, për ti ndihmuar ata që zëri i tyre të dëgjohet në zgjedhje;
- \* Edhe nëse kanë votuar edhe nëse kurrë nuk kanë votuar, ne do të jemi aty për ti dëgjuar atë çka kanë për të thënë.

U zhvilluan 10 aktivitete edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese me gratë rome. Mesazhet që u përcollën ishin rëndësia e votës, që zëri i tyre të dëgjohet, rritja e pjesëmarrjes në zgjedhje; parandalimi i fenomenit negativ të shitblerjes së votës; rëndësia e pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor; Janë zhvilluar 6 takime me gratë dhe vajzat në 6 Qarqe të vendit për përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe angazhimi i tyre në politikbërje.



Gjithashtu targetet grupi tjetër me të cilin janë zhvilluar takime dhe aktivitete ne 6-mujorin e dytë të vitit kanë qenë të rinjtë. Këtotakime janë zhvilluar në gjimnaze me qëllim rritjen e informimit të tyre për procesin zgjedhor, ku janë përcjellë mesazhe për rëndësinë që ka vota, për të ardhmen e tyre. Janë zhvilluar 7 takime me të rinjtë, në gjimnaze dhe në ambientet e KQZ.

### Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, për realizimin e kësaj mase ka luajtur një rol të rëndësishëm KQZ dhe donatorët apo institucionet ndërkombëtare që e mbështesin. Gjithashtu, në realizimin e kësaj mase, siç përshkruhet më sipër kanë ndikuar edhe projektet fituese të organizatave rinore dhe atyre për të rinjtë. Gjatë 2023 KQZ ka raportuar të shpenzuara investime të huaja me titull “Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së” Grant në masën 86,400,000 lekë. Kjo nuk është referuar tek dokumenti i PBA por është dhënë informacioni tek Raporti i Monitorimit 2023.

Tabela 12

## Realizimi Masa 1.6 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale është 100%. Kjo përqindje vjen si pasojë e fondeve të vëna në dispozicion nga KQZ për zgjedhjet e 2023<sup>21</sup> që janë dhënë nga donatorët në formë granti. Këto fonde nuk janë parashikuar në momentin e hartimit të SKR. Kurse përsa i përket zërave specifike, mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca + shpenzime kapitale norma e realizimit është 100%.

<sup>21</sup>Raporti i Monitorimit Financiar të KQZ për vitin 2023, fq 10 [Raporti i monitorimit financiar të KQZ për vitin 2023 | KQZ](#)

Rreth 1% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe rreth 99% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

### **Masa 1.1.7 Promovohet dhe mbështetet e drejta e të rejave dhe të rinjve për vetë-shprehje në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor.**

Në kuadër të Masës 7, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka mbështetur organizatën “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA/ECPAT Shqipëri)” për projektin me titullin “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”. Qëllimi i këtij projekti është të ndërtojë një qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll, duke garantuar mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në jetën sociale dhe ekonomike.

Projekti synon të përfitojnë të paktën 2,000 të rinj dhe të reja në këto bashki, duke përfshirë të paktën 200 të rinj dhe të reja nga grupet në nevojë, si komuniteti Rom/Egjiptian/PAK dhe LGBTI. Kjo përpjekje do të sigurojë që të rinjtë të kenë mundësinë të ndikojnë në jetën e tyre dhe në komunitetin e tyre, duke siguruar një qasje të barabartë në shërbimet dhe mundësitë që ofrohen.


#### **Realizimi financiar**

Siç përshkruhet edhe më lart, në këtë masë përfshihet promovimi i të drejtës së të rinjve/të rejave për vetë-shprehje.

AKR ka mbështetur këtë promovim nëpërmjet thirrjes për projekte për organizatat rinore dhe për të rinjtë edhe pse buxheti i kësaj mase është planifikuar me donatorë, por deri tani nuk ka informacion. Një projekt është financuar me fonde të buxhetit të shtetit për organizatën “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA/ECPAT Shqipëri)” për projektin me titull “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”.

Tabela 13

## Realizimi Masa 1.1.7 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale është 0.4% pa përfshirë financimin e projektit të lartpërmendur pasi fondet për këtë projekt janë të përfshira në një masë tjetër të këtij objekti. Kurse përse i përket

zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit (pa përfshirë projektin e financiar) është 0% pasi mosngridja e portalit “*Të rinjtë për të rinjtë*” bën që kostot e planifikuara për promovimin nëpërmjet këtij portali të mos jenë plotësuar. 100% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se është **masë pjesërisht e plotësuar**.

### **Masa 1.1.8 Rishikohet ligji “Për vullnetarizmin”, me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve.**

Gjatë vitit 2022 ka nisur procesi i konsultimit në nivel politik dhe teknik mes Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, gjatë vitit 2020 e në vijim, me qëllim identifikimin dhe adresimin e të gjitha problematikave gjatë procesit të rishikimit ligjor.

Në përfundim të procesit të konsultimeve u vendos nisja e procesit të rishikimit tërësor të Ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe nga një grup i përbashkët pune, me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në këtë proces, ka nisur puna, duke synuar angazhimin e të gjitha resurseve të disponueshme dhe të dhënave të mbledhura gjatë dy viteve të fundit për përgatitjen e një ligji efektiv, të qëndrueshëm dhe të gjithë pranuar, që do përmirësonte strukturën e vullnetarizmit dhe krijonte një mjedisi më mundësues për sektorin në Shqipëri. Grupi i përbashkët i punës ka vijuar punën gjatë vitit 2023 për përgatitjen e propozimeve ligjore me synimin që paketa e plotë të jetë e përgatitur, e konsultuar publikisht dhe paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave brenda vitit 2024.

Hapat e ndërmarra në lidhje me procesin e rishikimit të ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”, janë si vijon:

Ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin”, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me iniciativë të një grupi deputetësh, duke ngritur kornizën ligjore për zhvillimin e vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë. Ligji në nenin 2 të tij, parashikon se ky rregullim ka si qëllim rritjen e angazhimit qytetar dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor.

Pas miratimit të ligjit janë miratuar dhe aktet nënligjore: Vendimi i Këshilli i Ministrave Nr. 506, date 17/07/2019 “Për miratimin e Kodit të Etikës së Vullnetarëve”; Urdhri i MFE Nr. 229/2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Kartës së Vullnetarit” dhe Urdhri i MFE NR 300/ 2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Kontratës së Vullnetarizmit”.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit janë: Ministria përgjegjëse për çështjet e punës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (pas ristrukturimit të shërbimit kombëtar të punësimit). AKPA ka detyrën të regjistrojë institucionet që janë të gatshëm të ofrojnë punë

vullnetare, të lëshojë një numër reference dhe këto institucione mund të regjistrojnë më pas individë dhe t'i pajisin ata me librezë personale regjistrimi (Libreza e Vullnetarit ) dhe dokumentet përkatëse.

Vullnetarizmi perceptohet si një kontribut në dobi të qytetarëve dhe komunitetit që na rrethon. Në themel të vullnetarizmit ekziston gjithmonë nevoja e pakushtëzuar për të ndihmuar të tjerët. Ndonëse fasha moshore e vullnetarëve ka një spektër të gjerë, në Shqipëri të rinjtë përbëjnë një ndër segmentet kryesore të personave që përfshihen në nisma qytetare vullnetare.

Organizatat që kanë më shumë se 60 vullnetarë janë kryesisht organizata që drejtohen nga të rinjtë dhe kanë në mision të punës së tyre realizimin e fushatave masive sensibilizuese, advokojnë për të mbrojtur të drejtat e të rinjve, grave apo fëmijëve (Partners Albania, 2019).

Për këtë arsye interesi i MSHRF-së është që vullnetarizmi i qëndrueshëm të nxitet dhe të mbështetet për benefitet që ai jep për të rinjtë në zhvillimin njerëzor, qytetar, shpirtëror dhe profesional të tyre. Organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet e vullnetarëve në vend, më gjithë vlerësimin e qëllimit të mirë të ligjit, kanë shprehur një numër shqetësimesh lidhur me efektet e ligjit në frenimin e aktivitetit vullnetar në vend<sup>22</sup>

Lidhur me problematikat në zbatimin e ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”, u mbajt më 21 shkurt 2022, një seancë dëgjimore në Komisionin Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, të Kuvendit të Shqipërisë, me deputetët dhe Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Aty u la rekomandim nga ky komision rishikimi i Ligjit me qëllim adresimin e problematikave që do të lehtësonin zbatimin e tij si edhe ndërmarrjen e një fushate ndërgjegjësuese për promovimin e ligjit dhe instrumenteve të tij.

Një rrjet i organizatave të shoqërisë civile të angazhuara me nismat e vlerësimit strukturor të Ligjit dhe ndikimin e tij, kontaktuan MSHRF-në mbi nevojën për adresimin në mënyrë të plotë dhe efektive të gjitha problematikat strukturore dhe të zbatimit të evidentuar gjatë procesit të analizës së Ligjit 45/2016 “Për Vullnetarizmin”. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zëvendës Ministri i Financave dhe Ekonomisë përgjegjës për çështjet e punësimit dhe Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive zhvilluan më datë 29 mars 2022 një takim online me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile ku përfshiheshin: Qendra Kombëtare Burimore e Shoqërisë Civile, Organizata Përtej Barrierave, World Vision, Korpusi i Vullnetarëve, Arka, Qendra Rinore Vlorë, Qendra Progres dhe Zhvillim. Gjatë këtij takimi, u diskutuan në detaje aspektet më problematike të Ligjit sipas vlerësimit të OSHC-ve lidhur me njohjen e punës vullnetare, kontraktimin dhe

---

<sup>22</sup> Studimi kombëtar Vullnetarizmi në Shqipëri, nga “Projekte Vullnetare Ndërkombëtare” në kuadër të projektit strategjik “VullnetarizmiPikëAL”, mbështetur nga “LëvizAlbania”, projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Sdc. 2021.[https://beyondbarriers.org/wp-content/uploads/2021/10/Vullnetarizmi-ne-Shqiperi\\_-\\_Studimi-Kombetar\\_compressed.pdf](https://beyondbarriers.org/wp-content/uploads/2021/10/Vullnetarizmi-ne-Shqiperi_-_Studimi-Kombetar_compressed.pdf)

Letër e hapur e OSHC-ve drejtuar institucioneve shtetërore [https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/08/Mbi-Vullnetarizmin\\_AL-.pdf](https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/08/Mbi-Vullnetarizmin_AL-.pdf)

regjistrimin e vullnetarëve, kostot e sigurimit të tyre, por edhe mbi mënyrën se si Ligji mund të kthehet në një instrument nxitës dhe mundësues për vullnetarizmin në Shqipëri. Nisur nga tërësia dhe shumëllojshmëria e elementëve që duhet të trajtohen dhe adresohen, dhe me synimin për të përgatitur një produkt që i përgjigjet nevojave të sotme dhe të ardhshme të zhvillimit të vullnetarizmit në vend, përfaqësuesit e Qeverisë dhe OSHC-ve dakordësuan që Ligji 45/2016 “Për Vullnetarizmin” të rishikohet në mënyrë tërësore dhe ky proces rishikimi duhet bërë me konsultim të gjithanshëm, duke përdorur të gjitha resurset e disponueshme dhe të dhënat e mbledhura përgjatë viteve të fundit.

Referuar VKM-së Nr.692, datë 26.10.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022-2029”, dalin masat strategjike shumëvjeçare, institucionet përgjegjëse dhe afatet e realizimit të tyre. Masa strategjike 1.1.8 e dokumentit të miratuar parashikon Rishikimin e ligjit “Për vullnetarizmin” me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve. Bazuar në Vendimin nr. 790, datë 28.12.2023 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”, rishikimi i Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” është parashikuar si bashkëpropozim i Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe duhet të miratohet gjatë katërmujorit të III-të të vitit 2024.

#### *Kalendari i punës dhe aktivitetet e zbatuara.*

Qëllimi i projekt ligjit synon rregullimin dhe përmirësimin e ligjit ekzistues 45/2016 “Për vullnetarizmin”, për krijimin e një mjedisi nxitës dhe mundësues për vullnetarizmin në vend. Objektivat konkrete që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji përfshinë:

- Rregullimin e paqartësive dhe problematikave të evidentuara në zbatim (të pa zbatueshme; ose zbatim pjesor);
- Përmirësimin e ligjit për të kushtet efektive për zhvillimin e vullnetarizmit në vend
- Lidhjen me planin kombëtar për aderimin në BE-së. Harmonizimi i ligjit me parashikimet e Rekomandimit të Këshillit Europian të (2022/C 157/01) për Mobilitetin e Vullnetarëve të rinj në BE;

#### Çështjet që rregullon projektligji:

Nëpërmjet projektligjit do të rregullohen dhe qartësohen parashikimet e ligjit sa i takon përcaktimit të marrëdhënies së veçantë ligjore që krijohet midis ofruesit të vullnetarizimit dhe vullnetarit; përcaktimit në mënyrë të qartë të llojit të mbulimit që ofruesi i vullnetarizmit duhet të bëjë për të siguruar shëndetin e vullnetarit; qëllimin e mbajtjes dhe përdorimit të regjistrit të vullnetareve; do të vlerësohet nëse duhet bëhen dallime në ligj mes vullnetarizmit të strukturuar dhe atij masiv apo afatshkurtër etj.

Gjithashtu, analiza synon vlerësimin nëse elementë të specifikuar në ligj si lëshimi dhe plotësimi i librezës së vullnetarit, apo plotësimi dhe raportimi pranë AKPA-s i të dhënave për vullnetarizmin, nevojitet të riformulohen duke përcaktuar zhvillimin e tyre në format elektronik, në mbështetje të objektivave të Qeverisë për digjitalizimin dhe riinxhinierizimin e shërbimeve publike, si dhe në

përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike” dhe Ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”.

Është miratuar metodologjia për hartimin e Projektligjit ku përfshihet:

1. Ngritja e grupi ndërinstitucional i punës me urdhër të Kryeministrit.
2. Proçesi i vlerësimit për rishikimin ligjor duhet të jetë gjithëpërfshirës duke përfshirë si vlerësimin e Ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.
3. Përgatitja e propozimeve për rishikimin e ligjit dhe RIA duke adresuar problematikat e dala nga vlerësimi dhe rregullimet në ligj bazuar në modelet krahasuese.
4. Konsultimi me aktorët dhe grupet e interesit për diskutimin e projektligjit, konsultimi publik.
5. Bashkëndimi i projektligjit në KM, Këshillin Konsultativ QQ- QV.

### Realizimi Financiar

Realizimi i kësaj mase nuk ka filluar sipas parashikimeve në 2022 por, siç shpjegohet edhe më lart, ka filluar në 2023. Për këtë arsye për të përcaktuar nivelin e realizimit është bërë analiza e aktiviteteve faktike të realizuara në 2023 dhe kosto e tyre është krahasuar me fondet e planifikuara në 2022.

Tabela 14

## Realizimi Masa 1.8 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale është 85%. Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 43% pasi ndryshimet ligjore nuk janë bërë gjatë 2023 dhe aktiviteti që ishte planifikuar për këtë vit do realizohet në 2024. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 100% pasi sipas informacioneve të dhëna nga MSHRF, organizatat kanë bërë identifikimin e hendeqeve. Për këtë arsye në këtë zë nuk ka

mosrealizim. Planifikim për shpenzime kapitale nuk ka pasur. Rreth 13% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe rreth 87% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se është **masë pjesërisht e realizuar**.

**Masa 1.1.9** Në përputhje me ligjet dhe VKM për njohjen e përvojës së punës dhe mësimin informal dhe jo-formal njihen kompetencat e fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (AKAFPK) dhe klasifikimit të profesioneve (European Youth Work Portfolio).

### Realizimi financiar

Kjo masë konsiston në fushatat informuese dhe sensibilizuese që duhet të bëheshin në lidhje me KKK (AKAFPK). Nga informacionet e marra këto fushata nuk janë ndërmarrë. Aktualisht AKAFPK po mbështetet me projekt të UNDP, dhe RisiAlbania<sup>23</sup>. Mospasja e informacionit bën që Realizimi i fondeve totale dhe i zërave specifike është 0%.


Duke pasur parasysh informacionin për mbështetje nga donatorët dhe gjithashtu përpjekje që janë bërë edhe më përpara<sup>24</sup> mund të thuhet se kjo është **masë e paraportuar**.

### Përmbledhje për objektivin specifik 1.1

#### Realizimi financiar

Realizimi i 9 masave në bazë të analizës financiare është si në grafikun e mëposhtëm

Tabela 15  
Statusi i realizimit të masave të Objektivit 1.1



<sup>23</sup> <https://www.facebook.com/epalealbania/posts/717275943765321/>

<sup>24</sup> Nga një lajm i MoF në 2021, proces i njehsimit është mbyllur


(<https://www.facebook.com/ShoqataShqiptareTurizmit/posts/shqip%C3%ABria-p%C3%ABrafron-sistemin-shqiptar-t%C3%AB-kualifikimeve-me-sistemin-evropian-t%C3%AB-ku/4409764772464437/>). Për këtë arsye duhet të ketë pasur fushata informuese.

**Objektivi specifik 1.2: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm, duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave, Agjencinë Kombëtare të Rinisë.**

Në këtë objektiv realizimin e ul ndjeshëm masa që ka të bëjë me ngritjen e portalit “Të rinjtë për të rinjtë”.

Tabela 16

## Realizimi Objektivi 1.2.1 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale është 64%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 10%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 79%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 0%. Rreth 53% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 47% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 1.2.1** Fuqizohen rolet zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes fuqizimit të saj me burime financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në këtë strategji.

Me qëllim zbatimin e kësaj mase, gjatë periudhës raportuese, ka nisur procesi i kryerjes së analizës funksionale të institucionit, me qëllim evidentimin e problematikave kryesore në organizimin dhe menaxhimin e punës dhe veprimtarisë së AKR-së, në aspektin organizativ dhe strukturor. Në këtë kuadër janë zhvilluar intervista me punonjësit e AKR-së, janë plotësuar pyetësorë nga ana e tyre, është kryer analiza e detyrave funksionale të ushtruara nga punonjësit duke e ballafaquar atë me detyrat e parashikuara në legjisllacionin në fuqi, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucionit.

Puna ka vijuar gjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2023, me hartimin dhe miratimin e të gjithë paketës ligjore të nevojshme për miratimin e ndryshimeve strukturore.

Në funksion të fuqizimit të AKR-së është rishikuar akti nënligjor i vitit 2020, që rregullon procesin e financimit nga buxheti i shtetit të projekteve rinore, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1141,




datë 24.12.2020, , “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, i cili shfuqizohet nga Vendimi Nr. 566, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”.

## Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, gjatë 2023 është vazhduar puna për të përfunduar analizën strukturore të AKR dhe për të bërë ndryshimet ligjore të nevojshme. Sipas planifikimit në SKR 2022 – 2029, këto aktivitete duhet të ishin realizuar më së shumti në 2022 dhe duhet të ishin përfunduar në 2023 dhe po në këtë vit duhet të ishin vënë në zbatim. Kjo shtyrje e proceseve bën që zërat e buxhetit të mos jenë të realizuar.

Tabela 17

## Realizimi Masa 1.2.1 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 11%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 13%. Nuk është realizuar fondi i pagave pasi nuk janë vënë në zbatim ndryshimet në burimet njerëzore, pra nuk janë punësuar punonjës të rinj. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca dhe gjithashtu për shpenzime kapitale niveli i realizimit është 0%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e porealizuar**.

**Masa 1.2.2** Përmes AKR sigurohen fonde për rritjen e prezencës së Shqipërisë në proceset e politikëbërjes rinore si në nivel rajonal, evropian dhe global.

AKR është partnere në Projektin “Pjesëmarrja e të rinjve në demokracinë Digjitale” i cili do të financohet nga Erasmus+ dhe synon të angazhojë dhe fuqizojë të rinjtë në Shqipëri, Mal të Zi, Serbi dhe Spanjë, veçanërisht ata nga komunitetet rurale dhe të marginalizuara, në botën digjitale. Ky Projekt synon të zhvillojë aftësitë digjitale të të rinjve duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e

tyre digjitale, me një qasje të balancuar që thekson mbrojtjen dhe pjesëmarrjen në demokracinë digjitale. Organizatat partnere janë nga Serbia, Mal i Zi, Shqipëria, Spanja.

AKR ka aplikuar në muajin Tetor 2023 për të qenë partnere me organizatën Cosmos Youth në një shkëmbim rinor të financuar nga Erasmus+ që do të zhvillohet në Van të Turqisë për të ndërgjegjësuar të rinjtë, për të mbrojtur liqenet dhe për të shmangur ndryshimet klimaterike. Ky shkëmbim rinor do të zgjasë 1 javë me 36 pjesëmarrës nga 6 shtete, Turqia, Sllovenia, Hungaria, Spanja dhe Belgjika.

Shqipëria është anëtare e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), një mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, i themeluar nga 6 (gjashtë) shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe që është një produkt konkret i Proçesit të Berlinit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, që synon të promovojë frymën e bashkëpunimi mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit.

Në bazë të neneve 36 dhe 43 të ligjit Nr. 116/2016 *“Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor, Statutit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR)”*, përqindja kontribuuese e Shqipërisë tek buxheti i RYCO-s është 17.3% e cila përkthehet në vlerën 173,000 euro në vit, tarifë e cila paguhet çdo vit nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Rinisë në monedhën vendase.

Në bazë të ligjit të sipërcituar, ligjit nr. 75/2019 *“Për Rininë”*, Urdhrit nr. 3, datë 09 Maj 2023 *“Për Fillimin e Procedurave dhe Ngritjen e Komisionit të Certifikimit për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor në bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR)”* të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF), u ngrit Komisioni i Certifikimit për Përzgjedhjen e Përfaqësuesit Rinor në Bordin Drejtues të ZRBR, i cili administroi proçesin e zgjedhjes së Përfaqësuesit të Shqipërisë në ZRBR.

Në këtë kuadër, u hap thirrja për aplikime, e cila qëndroi e hapur nga data 10-17 Maj 2023. Pas shqyrtimit të plotësimit të kriterëve të aplikimit për çdo aplikant, u shpall në faqen zyrtare të AKR-së lista e kandidatëve të kualifikuar, të cilët u votuan nga organizatat rinore për të rinjtë gjatë datave 22-29 Maj 2023 dhe proçesi u përmbyll me zgjedhjen e përfaqësuesit të vendit tonë në RYCO, i cili përfaqëson Shqipërinë së bashku me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Në 17 Korrik 2023 u mbajt në Tiranë mbledhja e 19-të e Bordit Drejtues të RYCO-s nën kryesinë e Shqipërisë. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përfaqësuesi i Rinisë dhe Sekretari i Përgjithshëm i RYCO, kryesuan takimin. Në këtë mbledhje u miratuan një seri dokumentesh të rëndësishme për RYCO-n duke i mundësuar RYCO-së të vazhdojë me reforma dhe të forcojë pjesën e saj operative dhe programe për të fuqizuar dhe më tej të rinjtë në rajon.

Në 7 Tetor 2023 u zhvillua Samiti i Liderave të Proçesit të Berlinit ku të rinjtë diskutuan rreth demokracisë, paqes dhe sigurisë gjithëpërfshirëse dhe jetesës së qëndrueshme me pjesëmarrjen e 90 të rinjve të Forumit Rinor të Ballkanit Perëndimor, aktivitet i mbështetur nga RYCO.

Në 27 Tetor 2023 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një bisedë me parlamentarët e rinj të BE në kuadër të rrjetit informal të parlamentarëve të rinj të Asamblesë Parlamentare të OSBE, ku u diskutua mbi politikën rinore dhe nxitjen e të rinjve në proçeset vendimmarrëse.

Në 3 Nëntor 2023 Ministri i Shtetit për të rinjtë dhe Fëmijët zhvilloi një takim me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të RYCO-s ku u diskutua për fuqizimin e RYCO, me qëllim përfshirjen e të rinjve të Ballkanit Perëndimor si aktorë thelbësorë të promovimit të paqes dhe dialogut konstruktiv.

Në kuadër të mbështetjes së pjesëmarrjes së përfaqësuesve rinorë në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar rinor, në fund të vitit 2022 u zhvillua një vizitë studimore dhe shkëmbim rinor në Helsingborg, Suedi, ku 15 të rinj nga Shqipëria u mirëpritën në Universitetin e Sundgarden, për të ndarë eksperiencat që përkonin me programet studimore të integruara në këtë universitet, me përvojën dhe fuqizimin e të rinjve në qasjen e përshtatshmerisë me kurrikula që studentët përdornin atje. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga MSHRF-ja, të rinj nga Këshilli Vendor Rinor Fier dhe të rinj pjesë e organizatave rinore/për të rinjtë.


Udhëzuesi për ngritjen e KVR-ve, është një manual i cili u përgatit në një bashkëpunim të Agjencisë Kombëtare të Rinisë së bashku me Olof Palm. Ky manual u është shpërndarë të gjithë bashkive të vendit nga MSHRF në mënyrë për të dhënë një udhëzim dhe një standardizim të procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të KVR-ve.

### Realizimi financiar

Gjatë 2023 janë realizuar shumica e aktiviteteve të planifikuara. Pra mund të thuhet se është një nga masat ku realizimi ka qenë shumë i lartë. Kjo vjen për faktin se është siguruar pjesëmarrja në organizata ndërkombëtare në mënyrë që të mundësohet lëvizja e të rinjve.

Tabela 18

## Realizimi Masa 1.2.2 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 80%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 0%. Kjo normë vjen si pasojë e faktit që nuk janë punësuar punonjës të rinj dhe nuk është punuar për të përgatitur manualin e planifikuar. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca norma e realizimit është 82% pasi është

siguruar anëtarësimi në organizata ndërkombëtare si RYCO dhe Erasmus+<sup>25</sup> por nuk është krijuar fondi për mbështetjen e KKR dhe KVR. Përsa i përket shpenzimeve kapitale niveli i realizimit është 0% pasi këto shpenzime janë për pajisjet që do duheshin për të siguruar kushtet e duhura të punës për stafin e planifikuar.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

**Masa 1.2.3** Bazuar në konceptin "*Të rinjtë për të rinjtë*" zhvillohen dhe aplikohen shërbime të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë informimi dhe shërbimesh për të rinjtë dhe organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që do të mbështesë formimin, punësimin, edukimin, mirëqenien, zhvillimin dhe aktivizimin e tyre.

Kjo masë **është e porealizuar.**

### **Realizimi financiar**

Gjatë 2023 nuk është arritur të ngrihet portali "*Të rinjtë për të rinjtë*". Vonesa e procesit ka bërë që të gjitha aktivitetet e lidhura me këtë masë të mos realizohen. E njëjta vonesë ka ndodhur edhe me ngritjen e këndeve digjitale të informacionit rinor (info-points) në të gjitha bashkitë me anë të tabletave ose tabelave smart.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e porealizuar.**

**Masa 1.2.4** Fuqizohen kapacitetet e politikë-bërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore, bazuar në konceptin e shërbimeve miqësore dhe të pranueshme nga të rejtat dhe të rinjtë dhe forcohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e politikave rinore.

Në datë 27 shkurt 2023, u mbajt mbledhja e dytë ndërqeveritare Shqipëri – Mali i Zi. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me homologun e saj, Vasilije Lalošević, Ministër i Sportit dhe Rinisë i Qeverisë së Malit të Zi, nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit në fushën e rinisë. Me anë të memorandumit që nënshkruan, do të punohet për të përmirësuar dhe rritur bashkëpunimin në fushën e rinisë, konkretisht duke rritur shkëmbimet rinore, aktivizimin rinor, zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta, shkëmbimin e eksperiencave, e shumë të tjera.

Në 17 Korrik 2023 u mbajt në Tiranë mbledhja e 19-të e Bordit Drejtues të RYCO-s nën kryesinë e Shqipërisë. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përfaqësuesi i Rinisë dhe Sekretari i Përgjithshëm i RYCO, kryesuan takimin. Në këtë mbledhje u miratuan një seri dokumentesh të rëndësishme për RYCO-n duke i mundësuar RYCO-së të vazhdojë me reforma dhe të forcojë pjesën e saj operative dhe programore për të fuqizuar dhe më tej të rinjtë në rajon.

---

<sup>25</sup> fondi i kontigjencës prej 11992000 lekë është skontuar

Në 7 Tetor 2023 u zhvillua Samiti i Liderave të Proçesit të Berlinit ku të rinjtë diskutuan rreth demokracisë, paqes, sigurisë gjithëpërfshirëse dhe jetesës së qëndrueshme me pjesëmarrjen e 90 të rinjve të Forumit Rinor të Ballkanit Perëndimor, aktivitetet i mbështetur nga RYCO.

Në datat 21-23 Dhjetor 2023, u zhvillua në Sarandë, Shkolla Dimërore ku morën pjesë punonjësit rinorë të 51 bashkive. Kjo shkollë u përqëndrua në rritjen e kapaciteteve të punonjësve rinorë dhe trajtoi tema të rëndësishme si: përfshirja e të rinjve nga bashkitë vendase në aktivitete sociale, kulturore, ekonomike dhe sportive; fuqizimi i Këshillave Vendorë Rinorë; njohja e Strategjisë Kombëtare të Rinisë; si dhe njohja me thirrjen Nr. III për grante për infrastrukturë rinore. Ky aktivitet u financua nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe World Vision Albania, duke shërbyer si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive mes punonjësve rinorë të bashkive në Shqipëri.


### Realizimi financiar

Në këtë masë janë realizuar një pjesë e aktiviteteve që janë mbështetur edhe nga donatorët.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 83%. Kjo normë e lartë realizimi vjen si pasojë e realizimit të aktiviteteve të ndryshme si Ministeriali në nivel rajonal i financuar nga RYCO apo edhe shkolla dimërore e organizuar nga AKR në bashkëpunim me Word Vision Albania. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 33%. Nuk është realizuar fondi i pagave pasi nuk janë realizuar trajnimet, manuali dhe fushatat e mirëfillta në lidhje me shërbimeve miqësore rinore.

Tabela 19

## Realizimi Masa 1.2.4 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 83% pasi edhe pse trajnimet apo manuali nuk është arritur të realizohen si pasojë e vonimit të proçesit, përsëri janë zhvilluar aktivitetet e shpjeguara edhe më lart si Shkolla Dimërore (21-23 Dhjetor). Shpenzime kapitale niveli i realizimit është 0%.

Si masë ka një kontribut të ndjeshëm të donatorëve me 97% të fondeve faktike financim i huaj dhe 3% i fondeve financim nga buxheti i shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se është **masë pjesërisht e realizuar**.


**Institucionet kanë raportuar të gjithë masat që lidhen me objektivin specifik 1.2.**

### **Realizimi financiar**

Për këtë objektiv është vlerësuar norma e realizimit të 4 masave. Realizimi i masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë

Tabela 20


## Statusi i realizimit të masave të Objektivit 1.2



**Objektivi specifik 1.3: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm, duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.**

Realizimi i fondeve totale është 5%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 21%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 0%, ndërkohë për masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime kapitale. Në këtë objektiv pothuajse 100% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit.

## Realizimi Objektivi 1.3 i SKR për vitin 2023



Në këtë objektiv, realizimin e ulin ndjeshëm studimet për të rinjtë dhe baza e të dhënave për të rinjtë. Hendeku financiar nuk është mbuluar dhe vlera e planifikuar është pothuajse e barabartë me hendekun faktik.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 1.3.1** Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri, përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe fuqizohet studimi i rinisë si fushë akademike dhe shkencore.

Gjatë periudhës raportuese, INSTAT është duke zhvilluar Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023, i cili do të sigurojë të dhëna për të rinjtë sipas karakteristikave socio-demografike, arsimit, punësimit, aftësive të kufizuara, lindjeve të gjalla, migracionit etj. CENS 2023 mundëson zhvillimin e analizave të thelluara dhe kërkimin shkencor në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe të rinjtë.

Fushat kryesore që mbulohen në këtë botim përfshijnë: popullsinë, shëndetësinë, arsimin, përkujdesjen alternative, drejtësinë, punësimin dhe trajnimin, si dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara në këtë botim mund të jenë bazë për zhvillimin e politikave zhvillimore rinore në vijim.

Gjithashtu, MSHRF ka kontribuar në realizimin e ushtrimeve për të përcaktuar indikatorët që konsiderohen me rëndësi për Shqipërinë në fushën e rinisë, për t'u përfshirë në modulet e anketimit MICS që është në proces realizimi nga UNICEF në bashkëpunim me INSTAT në Shqipëri. MICS (Multiple Indicator Cluster Surveys) është një platformë e përbërë nga një sërë anketash të ndërmarra nga UNICEF. Këto anketa mbledhin të dhëna mbi shumë tregues të lidhur me mirëqenien e fëmijëve dhe grave. Të dhënat e MICS janë gjerësisht përdorura për hartimin e politikave, planifikimin e programeve dhe monitorimin e progresit drejt qëllimeve ndërkombëtare për zhvillim, duke përfshirë këtu dhe lidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs).


## Realizimi financiar

Në këtë masë ishte planifikuar që të krijohej një njësi tek INSTAT për tu marrë me të dhënat për rininë, por në 2023 kjo nuk është realizuar pasi në INSTAT nuk është përcaktuar një punonjës që të merret me të dhënat për rininë. Përsa i përket mbështetjes së donatorëve, UNICEF është angazhuar në 2023. Në këtë masë nuk janë planifikuar fare shpenzime kapitale.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 7%. Kjo normë kaq e ulët realizimi lidhet me faktin që ka një mosrealizim të theksuar qoftë përsa i përket studimeve që ishin planifikuar të realizoheshin, qoftë edhe përsa i përket stafit të dedikuar për të punuar me të dhënat rinore.

Tabela 22

## Realizimi Masa 1.3.1 i SKR për vitin 2023



Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 17%. Nuk është realizuar fondi i pagave pasi nuk janë shtuar punonjës që merren me të dhënat për të rinjtë, por nga ana tjetër punonjës të INSTAT kanë bashkëpunuar me UNICEF për hartimin e MICS. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 0%.

Me këtë masë hendeku financiar i planifikuar është më i lartë se hendeku financiar faktik. Si masë nuk ka kontribut të ndjeshëm të donatorëve pasi procesi për MICS është në fillime.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e porealizuar**.

**Masa 1.3.2** Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare.

**Masa është e porealizuar** për shkak të vështirësive në gjetjen e donatorëve për të mbuluar studimet.

## Realizimi financiar

Në këtë masë ishte planifikuar që të realizoheshin 6 studime në nivel kombëtar në lidhje me aspekte të ndryshme të lidhura me të rinjtë dhe të rejtat. Për këto studime deri tani nuk ka pasur zhvillime.

Pra, niveli i realizimit në total dhe për çdo zë është 0%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e porealizuar**.



**Masa 1.3.3** Në përputhje me Ligjin për Rininë dhe aktin nënligjor të dalë në bazë dhe për zbatim të tij, zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë, duke përfituar edhe nga proçeset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

Përmbushja e detyrimit të parashikuar nga kjo masë ka nisur me proçesin konsultativ të koordinuar nga MSHRF dhe AKR. Kështu, për të diskutuar rreth mënyrës së ngritjes, administrimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në dhjetor 2022, zhvilloi një diskutim të hapur me përfaqësues nga organizatat rinore/për rininë dhe aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile. Pikat kyçe për diskutim ishin mbi të dhënat që mund të përfshihen si pjesë e bazës së të dhënave, si një platformë ndërvepruese dhe një iniciativë që synon rritjen e transparencës, përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes qytetare. Kjo do të shërbejë për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave nga organizatat rinore/për të rinjtë në proçeset e politikave rinore, në nivel qendror dhe vendor, si dhe për nevojat dhe punën e tyre. Gjithashtu, databaza do të shërbejë edhe për të rritur ndërveprimin e të rinjve me këto organizata, qoftë si vullnetarë, praktikantë apo edhe si drejtues të ardhshëm.

Proçesi i filluar gjatë muajit dhjetor 2022 për ngritjen e Bazës së të Dhënave për Rininë, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, vijoi dhe gjatë 2023 me takime konsultative me organizatat rinore/për rininë. Gjatë zhvillimit të këtyre takimeve u vendos krijimi i një grupi pune, me përfaqësues të organizatave rinore/për rininë, i cili ka për qëllim të ndjekë të gjithë proçesin e ngritjes së bazës së të dhënave për rininë.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese, AKR-ja ka nisur hapat e nevojshëm proçeduriale për të vijuar më tej me bashkëpunimin me AKSHI-n për krijimin e databazës së rinisë. Më datën 16 Gusht 2023 u themelua grupi i punës për krijimin e bazës së të dhënave për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, i quajtur Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore dhe për të Rinjtë. Kjo iniciativë u shpall në kontekstin e miratimit të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, ku në nenin 18 parashikohet ngritja e bazës së të dhënave për rininë. Qëllimi kryesor i kësaj baze të të dhënave është të sigurojë informacion të përditësuar për të rinjtë në vend, si dhe të ndihmojë në proçeset e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore, në nivelet qendror dhe vendor. Baza e të dhënave është e njohur si “Regjistri Elektronik për Rininë” dhe do të jetë i aksesueshëm përmes platformës së e-Albania.

Më datën 12 Shtator 2023 u dërgua drafti i parë i Termave të Referencës për “Regjistrin Elektronik për Rininë” nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Pas kësaj, u vazhdua komunikimi mes Agjencisë Kombëtare të Shtetësisë dhe e-Albania për të plotësuar kushtet e përcaktuara në draft. Drafti i fundit u dërgua nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) më datën 26 Janar 2024, pas një proçesi të gjatë konsultimesh dhe përpunimeve. Kjo përparësi e rëndësishme përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të qeverisjes dhe mbështetjes së rinisë në Shqipëri.


## **Realizimi financiar**

Në këtë masë, si tek masa e lidhur me Ligjin e Rinisë apo ligjin e Vullnetarizmit, procesi është shtyrë në kohë. Kështu kjo ka shkaktuar spostim të aktiviteteve të 2022 në 2023.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 10%. Kjo normë kaq e ulët realizimi lidhet me faktin që procesi është vonuar dhe në 2023 është finalizuar hartimi i termave të referencës që ishte planifikuar të përfundohej në 2022.

Tabela 23

## Realizimi Masa 1.3.3 i SKR për vitin 2023



Përsa i përket pagave dhe sigurimeve shoqërore, niveli i realizimit është 100%<sup>26</sup>. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca, niveli i realizimit është pothuajse 0% pasi janë bërë takime konsultative dhe këto kanë shpenzime minimale. Në këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e porealizuar.**

### **Përmbledhje për këtë objektiv specifik**

**Institucionet kanë raportuar të gjithë masat që lidhen me objektivin specifik 1.3 Realizimi financiar**

Për këtë objektiv është vlerësuar norma e realizimit të 3 masave. Realizimi i masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë

---

<sup>26</sup> shpenzimet e planifikuara janë të 2022

## Statusi i realizimit të masave të Objektivit 1.3



### QËLLIMI POLITIK II

Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity)

**Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.**

Qëllimi i Politikave II, ka në përmbajtje të tij 3 Objektivat Specifikë dhe 13 Masa, nga të cilat 10 fillojnë zbatimin e tyre gjatë periudhës raportuese. Ky qëllim politik zbërthehet në masa që lidhen me punësimin e të rinjve, aftësimin e tyre në fushën e TIK dhe digjitalizimit, këshillimin e karrierës, zhvillimin e programeve sportive, artit, zejeve dhe programe të tjera jashtë-kurrikulare, mbështetjen e sipërmarrjes dhe start-up.

### Përmbledhje për Qëllimin Politik 2

Tabela: Niveli i raportimit të masave (në nr. dhe %)

Tabela 25

Numri i Masave	Të Paraportuara	Të Raportuara
13	3	10
100%	23%	77%


Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik.

### Realizimi financiar

Gjithsej për qëllimin 2 janë analizuar 10 masa. Realizimi i masave në bazë të analizës financiare për të tre objektivat e qëllimit të dytë është:

Tabela 26

## Statusi i realizimit të masave të Qëllimit 2




Për këtë qëllim politik dhe dy qëllimet e mëtejshme është analizuar edhe realizimi nga ana financiare dhe rezulton se zëra të ndryshëm të shpenzimeve kanë nivel realizimi të ndryshëm.

**Kështu realizimi i fondeve totale është 47%.** Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 68%. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 40%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 106%. Rreth 97% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 3% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Tabela 27


## Realizimi Qëllimi II i SKR për vitin 2023



Në pjesën më të madhe të masave të planifikuara për të tre objektivat nuk ka shpenzime kapitale të planifikuara. Gjithashtu, siç detajohet për çdo masë, ka pasur një përfshirje të donatorëve për fushatat promovuese por edhe për mbështetje të organizatave. Për këtë arsye vërehet një reduktim i hendekut financiar. Por mosrealizimi i Fondit të StartUp nga MiSHMB bën që hendeku financiar të rritet ndjeshëm. Ky është një faktor i jashtëm që nuk mund të kontrollohej apo ndikohej nga përgjegjësit për koordinimin e politikave rinore.

Tabela 28

## Realizimi Qëllimi II dhe tre objektivat




Përsa i përket zërave, vihet re një lутje shumë e madhe e normës së realizimit përsa i përket shërbime dhe mallra. Ndërkohë shpenzimet kapitale janë parashikuar vetëm për objektivin 2.1.

Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik. Gjithashtu jepet informacion në lidhje me shkallën e realizimit nga ana financiare për secilin nga objektivat dhe masat përkatëse.

**Objektivi specifik 2.1: Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive.**

Realizimi i fondeve totale është **23%**. Kjo përqindje kaq e ulët ndikohet nga mosrealizimi i Fondit të StartUp që shpërndahet nga MiSHMB. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 67%. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 6%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 106%.

## Realizimi Objektiv 2.1 i SKR për vitin 2023



Rreth 97.5% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 2.5% janë fonde të mbuluara nga donatorët. Këto rezultate vijnë si pasojë e faktit që në këtë objektiv ka qenë shumë e vështirë për të përfshirë investimet e donatorëve si pasojë e mungesës së informacionit.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 2.1.1** Bashkërendohet Politika Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, duke rritur nivelin e punësueshmërisë rinore, punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes angazhimit dhe ndërveprimit të këshillave vendorë rinorë, ndërmarrjeve dhe startup-eve.

### ➤ Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Gjatë periudhës raportuese ka vijuar zbatimi i Thirrjes VIII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

- Thirrja VIII (1 Shtator-1 Dhjetor 2023)

Në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës (PKPP) në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike”, i ndryshuar, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë, kryejnë rolin e sekretariatit teknik dhe koordinorit ndërinstytucional të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në institucionet e administratës shtetërore në nivel qendror e vendor, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe shoqëritë tregtare për fazat e mbetura nga çelja e fondeve me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, deri tek printimi, plotësimi dhe shpërndarja e certifikatave për të gjithë praktikantët.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët shpalli më 1 qershor 2023, Thirrjen e VIII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, ku u shpallën 1,613 vende praktike vakante.

Gjatë periudhës së raportimit është zhvilluar Thirrja e VIII e PKPP-së, e shpallur më 1 qershor 2023 me plot 1,612 pozicione vakante prej të cilave 704 në administratën shtetërore, 560 në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 94 në institucionet e pavarura, 175 në shoqëritë tregtare dhe 79 në

organizatat jofitimprurëse. Thirrja e VIII e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës është një vazhdimësi e thirrjeve të mëparshme, që ka si synim zhvillimin e një praktike profesionale 3-mujore për të gjithë të rinjtë 21-26 vjeç dhe njihet si përvojë pune gjatë rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore.

Thirrja e VIII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, qëndroi e hapur deri më 5 korrik me plot 1,327 aplikime. Përgjatë muajit korrik dhe gusht, kanë vijuar procedurat për vlerësimin e aplikantëve nga institucionet pritëse. 531 kandidatët e përzgjedhur janë njoftuar nga institucionet përkatëse dhe kanë filluar procedurat për të nënshkruar marrëveshjen për zhvillimin e praktikës profesionale 3-mujore, nga data 1 shtator deri më 1 dhjetor 2023, e cila njihet si përvojë pune nga DAP. Prej 531 kandidatëve, 314 të rinj përfunduan me sukses praktikën tre mujore. Të rinjtë e vlerësuar me pikë maksimale, do të kenë mundësinë të punësohen me kontratë 1-vjeçare në bazë të performancës së tyre dhe nevojave të institucioneve pritëse.

#### ➤ Programi i Kodimit

Një nga programet e krijuara me qëllim rritjen e nivelit të punësueshmërisë rinore dhe punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve është edhe Programi i Kodimit, i cili është lançuar më datë 23 janar 2023 nën koordinim të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ky program implementohet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Kurset e formimit profesional në fushën e teknologjisë së informacionit për periudhën 3-12 mujore, mbështeten në masën 50% ose 100% deri në vlerat maksimale prej 150,000 lekë ose 300,000 lekë respektivisht nga Qeveria Shqiptare sipas kategorisë së aplikantëve, të cilët pas përfundimit të kursit mund të integrohen lehtësisht në tregun e punës së teknologjisë.

Ofruesit e kurseve profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit të kualifikuar deri më tani janë: “Albanian ICT Academy”, “BetaPlan Coding Bootcamps”, “Holberton School”, “SDA by Protik”, “IkubInfo Academy” dhe “Communication Progress”. Aplikimi online për kurset profesionale kryhet me anë të portalit e-Albania, nëpërmjet shërbimit “Aplikim për Kursin e Formimit Profesional me Mbështetje Financiare” dhe më pas kjo kërkesë ndiqet dhe administrohet nga AKPA.

Deri në dhjetor 2023, ky program është ndjekur nga 1,291 pjesëmarrës (1,135 punëkërkues dhe 156 punëkërkues të papunë) prej të cilëve 1,043 pjesëmarrës ose 81% e totalit ishin 15-29 vjeç.

Mbështetja e qeverisë në këtë program nuk është vetëm në anën financiare, por përfshin edhe ndërlidhjen me tregun e punës me anë të bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm në treg. Të gjithë ofruesit e kurseve të formimit profesional kanë përgjegjësinë për t’i ofruar të gjithë individëve që ndjekin kurset me mbështetjen e qeverisë, module që lidhen me këshillimin e karrierës dhe aktivitete që mundësojnë ndërlidhjen e kursantëve me kompani që mund t’i punësojnë gjatë ose pas përfundimit të kursit të formimit profesional.

#### ➤ Trajnimi i stafit për qasje të dedikuara në kuadër të zbatimit të Garancisë Rinore.

Në kuadër të zbatimit të fazës pilot të Garancisë Rinore në Shqipëri, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, me mbështetjen e EU4SI, realizoi trajnimin e stafit të Zyrave të Punës, Qendrave të Formimit Profesional Publik, si dhe Shkollave Profesionale në 3 bashkitë Pilot,

përkatësisht në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Trajnime të vazhdueshme të dedikuara kanë vijuar përgjatë monitorimit periodik të zyrave të punës për ecurinë e zbatimit të fazës pilot të Garancisë Rinore.

➤ Shërbimi i Orientimit në Karrierë.

Organizimi dhe proceset e punës të realizuara nga zyrat e punësimit mbështeten në Vendimet e Këshillit të Ministrave, në Paketën e Udhëzuesve të miratuar dhe në Rregulloret e ndryshme.

Një prej Udhëzuesve të miratuar është Udhëzuesi për orientimin në karrierë dhe formimin profesional të punëkërkuësve të papunë të regjistruar.

Shërbimet ndaj punëkërkuësit të papunë që janë pjesë e orientimit në karriere janë:

- Këshillim individual/ ose në grup;
- Aftësitë e buta (Soft Skills);
- Kurrikula për aftësitë dixhitale;

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 rezulton se 1,990 (pu.pa) kanë ndjekur kursin e aftësive digjitale prej të cilëve 67% i përkisnin grupmoshës 15-29 vjeç.

Gjithashtu, në DROFPP Fier dhe Vlorë u zhvillua kursi *Start Smart* i cili u ndoq prej 609 punëkërkuës të papunë (pu.pa) 59% e të cilëve ishin të rinj.

*pu.pa pjesëmarrës në kursin Aftësi Digjitale*

*Tabela 30*

<b>DROFPP-të</b>	<b>Total</b>	<b>15-19 Vjec</b>	<b>%</b>
DROFPP Durrës	170	113	66%
DROFPP Elbasan	198	100	51%
DROFPP Fier	247	123	50%
DROFPP Gjirokastrë	57	37	65%
DROFPP Korçë	78	53	68%
DROFPP Lëvizëse	233	185	79%
DROFPP Nr. 1	302	271	90%
DROFPP Nr. 4	264	145	55%
DROFPP Shkodër	143	99	69%
DROFPP Vlorë	298	206	69%
<b>Total</b>	<b>1990</b>	<b>1332</b>	<b>67%</b>



Tabela 31

DROFPP-të	Total	15-19 Vjec	%
DROFPP Fier	14	11	79%
DROFPP Vlorë	595	346	68%
<b>Total</b>	<b>609</b>	<b>357</b>	<b>59%</b>

➤ Panair edukimi, trajnimi dhe punësimi në çdo qark;

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, në përputhje me qëllimin e dytë politik të Strategjisë, mbështet dhe nxit novacionin rinor dhe rritjen e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës. Në muajin qershor 2023, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, lançoi nismën “Panair edukimi, trajnimi dhe punësimi në çdo qark”.

Gjithashtu, Objektivi Specifik 1.1. i Strategjisë Kombëtare të Rinisë përcakton se “Të rinjtë janë të mirë informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike.

Me qëllim realizimin e masave dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, që prej muajit qershor, janë realizuar 6 Panaire edukimi, trajnimi dhe punësimi me qëllim informimin e të rinjve në këto drejtime dhe prezantimin e mundësive ekzistuese reale për të lehtësuar kalimin e të rinjve nga shkolla në tregun e punës, por edhe për zhvillimin e tyre personal, akademik dhe profesional.

Panairët për edukim, trajnim dhe punësim janë zhvilluar deri më tani në Kukës, ku edhe ishte panairi i parë për të rinjtë, duke vijuar në Sarandë, Vlorë, Shkodër, Korçë dhe Tiranë.

Në total në të gjithë panairët, mbi 250 aktorë që ofrojnë shërbime për të rinjtë, kanë prezantuar ofertën e tyre për mbi 1,700 të rinj. Të rinjtë janë njohur me mundësi, shërbime dhe oferta lokale me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes aktive në qytetet dhe zonat respektuese banuese, por njëkohësisht janë njohur edhe me mundësi kombëtare, në mënyrë që edhe ata të rinj që studiojnë dhe janë përkohësisht banues në qytete apo zona të tjera, të kenë mundësi të integrohen në tregun e punës dhe të kenë të ardhurat e tyre.

Më konkretisht çdo panair është realizuar në bashkëpunim me bashkitë, konkretisht Bashkia Kukës, Sarandë, Vlorë, Shkodër, Tiranë dhe Korçë, si dhe me zyrat e punës dhe aftësimin në çdo qytet. Nga ana tjetër, ka pasur përfaqësi të ministrive të linjës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (energjia e rinovueshme, hidrocentralet, aeroportet, aviacioni civil, OSHEE), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (skemat mbështetëse për fermerët dhe skemat për fermerët e rinj), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (agjencitë për zonat e mbrojtura), Ministria e Mbrojtjes me anë të Forcave të Armatosura Shqiptare, të cilët kanë promovuar skemat për të rinjtë që duan t’i bashkohen forcave të armatosura.

Gjithashtu në çdo panair, ka pasur përfaqësi nga shoqata e bankave dhe bankat të cilat kanë degë në qytetet ku janë zhvilluar panairët, universitetet publike dhe private të cilët kanë prezantuar bursat në dispozicion të studentëve. Nga bizneset sipas qyteteve kemi pasur prezentë dhe bizneset lokale në fushat e artizanatit, bujqësore, hoteleri turizëm, dhe industria ushqimore.

Në çdo panair të rinjtë janë informuar lidhur me programet në dispozicion të tyre, si programi kombëtar i praktikave të punës, programi i kodimit për të rinjtë, dhe programet periodike të trajnimit apo punësimit, siç është edhe lancimi i skemës së garancisë rinore që do të mbështesë në vitin e ardhshëm të rinjtë që nuk janë në arsim, në punësim ose në trajnim. Ndër të tjera, pjesë e panairove kanë qenë edhe donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë të cilët kanë programe për të rinjtë, si praktika.al, Swiss Contact, Ambasada Britanike dhe Ambasada Amerikane.

Përgjatë panairove, të rinjtë janë njohur edhe me projektet rinore që po zbatohen në qarqet përkatëse nga organizatat rinore dhe për të rinjtë me mbështetjen financiare nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, mundësuar kjo nga thirrja e dytë dhe e tretë për projekt-propozime për projekte rinore.

Deri më tani janë organizuar panairët si më poshtë vijon:


- Kukës - 30 qershor - 25 aktorë pjesëmarrës - Pallati i Kulturës “Hasan Prishtina” - 150 të rinj pjesëmarrës;
  - Sarandë - 22 Shtator - 30 aktorë pjesëmarrës - Pedonalja Sarandë - 100 të rinj pjesëmarrës;
  - Vlorë - 23 Tetor - 40 aktorë pjesëmarrës - Pallati i Sportit “Flamurtari” - 500 të rinj pjesëmarrës;
  - Shkodër - 27 Tetor - 40 aktorë pjesëmarrës - Bashkia Shkodër - 400 të rinj pjesëmarrës;
  - Tiranë - 30 Tetor - 50 aktorë pjesëmarrës - Piramida Tiranë - 500 të rinj pjesëmarrës;
- Korçë – 24 Nëntor - 30 aktorë pjesëmarrës – Biblioteka Korçë - 150 të rinj pjesëmarrës.

### **Realizimi financiar**

Nga informacioni i mësipërm dhe analiza e raportimeve mund të thuhet se për realizimin e kësaj mase janë zhvilluar një sërë aktivitete, kostot e të cilave mbulojnë dhe tejkalojnë kostot e parashikuara në strategji. Kështu për aktivitetet që janë planifikuar të realizohen në 2023, ka filluar zbatimi i tyre por për një pjesë të tyre përfundimi është në 2024.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 66%. Kjo normë është më e lartë se sa ajo që rezulton nga vlerat e raportuara, sepse krahas realizimit të shpenzimeve të buxhetit të shtetit, janë përfshirë edhe donatorë në mbështetjen e aktiviteteve të kësaj mase.

## Realizimi Masa 2.1.1 i SKR për vitin 2023



Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 14%. Puna e shtyrë në 2024, konsiston në përcaktimin e standardeve për shërbime të pranueshme e miqësore për të rinjtë në zyrat e punës apo edhe identifikimi nga KVR dhe KKR në nivel bashkie i situatës së të rinjve të kategorisë APAA/ NEET (As në punë, arsim apo aftësim). Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 29%, Fondi Arte dhe Zeje është realizuar plotësisht por nuk janë realizuar analizat për situatën e të rinjve që ishin parashikuar të financoheshin me donatorë. Ndërkohë realizimi i shpenzimeve kapitale është 106% dhe ka mbi realizim pasi fondet për Kodimin janë më të larta se ato të planifikuara në strategji.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

**Masa 2.1.2** Nxitet dhe forcohet punësimi rinor në fushën e TIK dhe digjitalizimit përmes zhvillimit të programeve të aftësimin në kodim, TIK dhe digjitalizim, bazuar në studimet e tregut dhe zhvillimit të punësimit në këtë fushë si në Shqipëri dhe me gjerë.

Thirrja e 2 për projekt-propozime të dedikuara për rininë e shpallur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për organizatat rinore dhe për të rinjtë fokusohet në 3 prioritet kryesore që lidhen ngushtë me SKR 2022-2029. Prioritetet e thirrjes janë përcaktuar nëpërmjet një procesi konsultues dhe gjithëpërfshirës. Ndër të tjera, thirrja e dytë ka synuar të adresojë fushën e përparësisë: Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë. Në kuadër të thirrjes së 2-të të AKR, nga 24 organizata rinore/për të rinjtë që kanë përfituar mbështetje në total, 7 prej tyre lidheshin drejtpërdrejt me nxitjen e inovacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë, zbatimi i të cilave ka përfunduar gjatë periudhës së raportimit.

Lidhur me sigurimin e informacioneve të përshtatshme dhe miqësore për të rinjtë mbi punësueshmërinë e të rinjve, punësimin dhe sipërmarrjen rinore, projektet fituese të thirrjes II të AKR që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e këtij synimi janë:

- Organizata “Albanian Network for European Integration/Rrjeti Shqiptar për Integrimin European-ANEI” ka implementuar projektin “Zhvillimi i kompetencave midis të rinjve dhe sipërmarrësve të shekullit XXI në Shqipëri”. Janë trajnuar për të gjitha modulet, 191 të rinj nga të cilët (76 djem dhe 115 vajza) nga të cilët 14 të rinj të komunitetit Rom dhe egjiptian. Janë hartuar 8 plane biznesi të përgatitura gjithashtu edhe 8 projekt propozime të hartuara.

- Organizata “Unioni i Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë” ka implementuar projektin: *“Aftësim dhe punësim për të Rinjtë”* me fushë përparësie: Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës. Numri i përfituesve në këtë projekt është 40 të rinj, (25 vajza dhe 15 djem) të trajnuar dhe të çertifikuar si dhe 5 të rinj nga kategoritë vulnerabël (nga familje me ndihmë ekonomike, jetim, rom dhe egjiptian) për secilën Bashki nga të cilët janë punësuar 5 të rinj.
- Organizata “Instituti për Konsulencë dhe Kërkime” ka implementuar projektin: *“Fuqizimi i të rinjve për të lulëzuar sot dhe nesër në tregun e punës”* me fushë përparësie: Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës. Totali i të rinjve të përfshirë ka qenë 180 të rinj (64 djem dhe 116 vajza), në këto takime me fokus grupe, seanca të këshillimit të karrierës, sesione trajnimit dhe workshop.
- Organizata “Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë” ka implementuar projektin: *“Rivitalizimi i sipërmarrjeve tradicionale për fuqizimin ekonomik të të rinjve”* me fushë përparësie: “Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës”. Janë mbështetur 175 të rinj (104 vajza dhe 71 djem) me probleme sociale të zonave rurale të Pukës dhe Fushë Arrëzitet, përmes trajnimeve në fushat: *“Aftësi për punë”*, *“Aftësitë sipërmarrëse”*, *“Përdorimi i teknologjisë për biznes dhe për gjenerim të ardhurash”*, *“Ngritja e fondeve dhe gjenerimi i të ardhurave”*, *“Aftësitë ndërpersonale”* si dhe është zhvilluar trajnim 5-ditor me pjesëmarrjen e 30 të rinjve (18 vajza dhe 12 djem). Gjithashtu është realizuar panairi i ideve të biznesit tradicional me pjesëmarrjen e 92 të rinjve (58 vajza dhe 34 djem).
- Organizata “Akademia e Studimeve Politike” ka implementuar projektin *“Së bashku për të zhvilluar karrierën në Shqipëri”* me fushë përparësie: Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës. Qendra “Akademia e Studimeve Politike” ka realizuar deri në këtë fazë të projektit një raport të bazuar në analiza dhe kërkime të ekspertëve mbi tregun aktual të punës, me të dhëna mbi punësimin e të rinjve. Janë hartuar 3 kurrikula që synojnë aftësimin e të rinjve për akses të suksesshëm në tregun e punës në Shqipëri si edhe një manual në formën e një udhëzuesi për të orientuar të rinjtë në karrierë. (Në fazë raportimi përfundimtar).
- Organizata “Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm”-ASDO ka implementuar projektin: *“Zhvillimi i kompetencave midis të rinjve dhe sipërmarrësve të shekullit XXI në Shqipëri”* me fushë përparësie: Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë. Janë 50 të rinj të trajnuar të zonave rurale ose të marginalizuara, kryesisht me vendbanime në Kamëz, Konispol dhe Libohovë. Janë trajnuar në 5 qytetet (Tiranë, Shkodër, Korçë, Sarandë, Gjirokastrë), për të gjashtë kurrikulat, 218 (70 djem dhe 148 vajza) të rinj si dhe kanë realizuar praktika 75 të rinj (54 vajza dhe 21 djem).

Lidhur me zhvillimin e programeve që mundësojnë zhvillimin e karrierës dhe punësimin në fushat e TIK dhe kodimit, projektet fituese të thirrjes II të AKR që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e këtij synimi janë:

- Organizata “WIT” ka implementuar projektin: *“3D Youth of Kavaja & Lushnja”* me fushë përparësie: Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë. Janë impaktuar në total 209 të rinj (73 djem dhe 136 vajza).

- Organizata “EESTEC LC Tirana” ka implementuar projektin: “*Youth 4 work & entrepreneurship*” me fushë përparësie: Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë si edhe me fushë përparësie: Mbështetja e Këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës. Janë impaktuar 90 të rinj.
  - Organizata “Lëvizja Rinore për Demokraci Pukë” ka implementuar projektin: “*Rivitalizimi i sipërmarrjeve tradicionale për fuqizimin ekonomik të të rinjve*” me fushë përparësie Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës. Janë mbështetur 175 të rinj (104 vajza dhe 71 djem) me probleme sociale të zonave rurale të Pukës dhe Fushë Arrëzitet, përmes trajnimeve në fushat: “Aftësi për punë”, “Aftësitë sipërmarrëse”, “Përdorimi i teknologjisë për biznes dhe për gjenerim të ardhurash”, “Ngritja e fondeve dhe gjenerimi i të ardhurave”, “Aftësitë ndërpersonale” si dhe është zhvilluar trajnim 5-ditor me pjesëmarrjen e 30 të rinjve (18 vajza dhe 12 djem). Gjithashtu është realizuar panairi i ideve të biznesit tradicional me pjesëmarrjen e 92 të rinjve (58 vajza dhe 34 djem).
  - Organizata “Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale- Qendra ALTRI” ka implementuar projektin: “*Fuqizohu në botën digjitale*” me fushë përparësie: Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë. Janë trajnuar 123 të rinj (72 djem dhe 51 vajza) nga Tirana, Shkodra dhe Lushnja.
  - Organizata “Qendra Youth Act” ka implementuar projektin: “*Rinia novatore dhe sipërmarrëse*” me fushë përparësie: Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit 21-të tek të rinjtë. Janë 117 të rinj të përfshirë në 5 konkurse rajonale Hackathon në Berat, Durrës, Pogradec, Shkodra dhe Tiranë ku të rinjtë kanë sjellë ide biznesi në fushën kompjuterike, digjitale, teknologji, graphic designer, nën mbikëqyrjen e specialistëve të fushës.
1. Lidhur me Thirrjen Publike Nr. 3, e cila është lancuar më datë 27 Prill 2023, dhe qëndroi e hapur për një periudhë 30-ditore, janë shpallur fituese 23 projekt-propozime rinore, tre prej të cilave mbështeten nga UNICEF, UNDP dhe UNFPA. Prioritetet e thirrjes 3 adresojnë 3 qëllimet politike të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, po njësoj si të thirrjes së dytë, me një prej prioriteteve në lidhje drejtpërdrejt me nxitjen e inovacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë. Në shtator 2023, Agjencia Kombëtare e Rinisë nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me 23 organizatat e reja fituese të thirrjes së tretë. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, gjatë periudhës së raportimit ka filluar zbatimin e projekteve fituese të thirrjes së tretë. Shtrirja gjeografike e projekteve fituese në thirrjen e tretë të AKR përfshin 40 bashkitë: Kuçovë, Lezhë, Sarandë, Peshkopi, Burrel, Bulqizë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Belsh, Peqin, Malësi e Madhe, Shkodër, Kukës, Mirditë, Dibër, Mat, Krujë, Kamëz, Patos, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Konispol, Gjirokastrë, Librazhd, Përrenjas, Himarë, Cërrik, Vorë, Pukë, Vau i Dejës, Maliq, Devoll, Gramsh, Dimal, Selenicë dhe Bilisht.

2. Lidhur me Thirrjen Publike Nr. 3, e cila është lancuar më datë 27 Prill 2023, dhe qëndroi e hapur për një periudhë 30-ditore, janë shpallur fituese 23 projekt-propozime rinore, tre prej të cilave mbështeten nga UNICEF, UNDP dhe UNFPA. Prioritetet e thirrjes 3, adresojnë 3 qëllimet politike të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, po njësoj si të thirrjes së dytë, me një prej prioriteteve në lidhje të drejtpërdrejtë me nxitjen e inovacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë. Në shtator 2023, Agjencia Kombëtare e Rinisë nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me 23 organizatat e reja fituese të thirrjes së tretë. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, gjatë periudhës së raportimit ka filluar zbatimin e projekteve fituese të thirrjes së tretë. Shtrirja gjeografike e projekteve fituese në thirrjen e tretë të AKR përfshin 40 bashkitë: Kuçovë, Lezhë, Sarandë, Peshkopi, Burrel, Bulqizë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Belsh, Peqin, Malësi e Madhe, Shkodër, Kukës, Mirditë, Dibër, Mat, Krujë, Kamëz, Patos, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Konispol, Gjirokastrë, Librazhd, Përrenjas, Himarë, Cërrik, Vorë, Pukë, Vau i Dejës, Maliq, Devoll, Gramsh, Dimal, Selenicë dhe Bilisht.

Projektet fituese të thirrjes III të AKR që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e synimit për nxitjen e punëve të denja dhe ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës janë:

- Organizata Qendra për Media dhe Çështjet Shoqërore me projektin “*GenZ*”. Synimi i projektit është krijimi i një platforme novatore me qëllim që të aktivizojë, të përfshijë dhe të mbështesë të rinjtë për të zhvilluar mendimin kritik duke diskutuar pro dhe kundër për tema që prekin ata dhe shoqërinë shqiptare. “*GenZ*” synon të krijojë një kulturë të debatit dhe të ndikimit pozitiv të të rinjve në proceset vendimmarrëse, duke kontribuar në formimin e një shoqërie më të përgjegjshme dhe të përfshirë. Shtrirja e projektit: Vorë, Kamëz & Tiranë.
- Organizata: “Action for Albania” me projektin “*Action for youth*”: Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ngritja e kapaciteteve të të rinjve për aftësimin profesional si dhe mentorimi dhe mbështetja e ideve inovatore të sipërmarrjes (startups) si aktivitet kritik për ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të bashkive si dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit. Shtrirja e Projektit: Peshkopi, Burrel & Bulqizë.
- Organizata: “Qendra Synergy” me projektin “*Ferma educative*”. Qëllimi i Projektit është të sigurojë përgatitjen dhe aftësimin e të rinjve për të kontribuar në zhvillimin e turizmit rural dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve agroturistike në fermën agroturistike dhe për të promovuar turizmin rural në komunitetin lokal dhe në tregun e gjerë. Të rinjtë do të sjellin ide të reja, inovacion dhe energji të freskëta në fushën e bujqësisë dhe turizmit rural. Shtrirja e Projektit: Tiranë dhe Durrës.
- Organizata: “Be the Change” me projektin “*Të orientuar drejt suksesit*”. Qëllimi i projektit është rritja e kapacitetit të të rinjve për edukim dhe orientim në karrierë dhe për rrjedhojë dhe rritja e nivelit të tyre të punësimit. Shtrirja e projektit: Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës.
- Organizata: “Qendra Youth Rise” me projektin “*Unlock your technological skills*”. Qëllimi i projekti është krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë duke promovuar aftësitë inovative, digjitale dhe sipërmarrëse.

- Organizata: “Qendra “Konkret” me projektin “*Dedicated, determined and driven youth of Elbasan*”. Qëllimi i projektit: Edukimi i të rinjve me në fokus vajzat rreth fenomeneve të ndryshme të krimeve kibernetike, risitë e fushës dhe dinamikën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe orientimin e tyre drejt profileve të punës së sigurisë së informacionit dhe profile të ngjashme me të. Shtrirja e projektit: Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Gramsh.
- Organizata: “Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore (Agri-En)” me projektin “*Punësimi i të rinjve në zonat malore është sfidë dhe mundësi*”. Qëllimi i projektit: Integrimi i të rinjve në komunitetet, motivimi dhe rritja e kapacitetit të tyre për punësim. Shtrirja e projektit: Bashkia Librazhd (Njësia Administrative Lunik), Bashkia Prrenjas (Njësia Administrative Stravaj), Bashkia Elbasan (Njësia administrative Labinot Mal)
- Organizata: “Shoqata LIBURNETIK” me projektin “*RE-DEBATE Kampionati Kombëtar i Debatit*”. Qëllimi i projektit: Të fuqizojë të rinjtë për të qenë qytetarë pro-aktivë, të mirë informuar dhe me mendim kritik e aftësi të të folurit në publik duke marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në komunitetin e tyre si dhe në jetën publike. Shtrirja e projektit: 21 Bashki (Malësi e Madhe, Shkodër, Kukës, Mirditë, Bashkia Lezhë, Dibër, Mat, Krujë, Durrës, Tiranë, Kamëz, Elbasan, Patos, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Konispol).
- Organizata: “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” (CRCA/ECPAT Shqipëri) me projektin “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”. Qëllimi i projektit: Qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec. Maliq, Korçë dhe Devoll. Shtrirja e projektit: Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll.
- Organizata: “Qendra You Are Not Alone” – (Donator UNFPA/UNDP) me projektin “*ROMActivism*”. Qëllimi i Projektit është të kontribuohet në përmirësimin e përfshirjes sociale të të rinjve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke i mbështetur të integrohen në tregun e punës, duke i fuqizuar për tu mbrojtur nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si dhe duke rritur aktivizmin e tyre qytetar përmes bashkëpunimit me Këshillat Vendore Rinore (KVR). Shtrirja e Projektit: Peqin, Cërrik & Elbasan.

## **Realizimi financiar**

Realizimi i kësaj mase ka të bëjë me fushatat informuese dhe sensibilizuese. Gjithashtu janë zhvilluar mundësi që të zhvillohen dhe promovohen programe që mundësojnë zhvillimin e karrierës dhe punësimin në fushat e TIK dhe kodim. Këtu vlen të theksohet edhe nisma e qeverisë për të bërë të mundur që kushdo mund të marrë informacion dhe të regjistrohet në kurse të tilla në një modul të veçantë në e-Albania.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 100%. Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%. Këto shpenzime janë realizuar pasi kanë të bëjnë me promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të ndryshme.

## Realizimi Masa 2.1.2 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 100%. Kurrikulat janë ngritur por portali “Të rinjtë për të rinjtë” nuk është ngritur. Por mbështetja është dhënë nëpërmjet formave të tjera që janë përfshirë në masat e tjera. Sidomos informacioni është shpërndarë nëpërmjet projekteve të ndryshme të shpërndara nga AKR gjatë 4 thirrjeve. Pra, edhe këto shpenzime mund të quhen të realizuara. Për të gjithë elementët, komponenti i aplikimit është shtuar në eAlbania. Këto shpenzime nuk ishin parashikuar në strategji.

Duke marrë parasysh edhe shpenzimet e përfshira në masat e tjera mund të thuhet se hendeku financiar është mbuluar. Për këtë masë 100% e fondeve janë të buxhetit të shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se është masë e realizuar.

**Masa 2.1.3** Pranë institucioneve arsimore dhe aftësuese zhvillohen shërbime inovative dhe digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë miqësore për të rinjtë dhe në respektim të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor.

Ministria e Arsimit dhe Sportit në kuadër të zhvillimit të masave afirmative për të ndihmuar gratë e reja, veçanërisht në zonat rurale, për të bërë karrierë si sipërmarrëse, ka zhvilluar disa aktivitete:

- Trajnime dhe seminare të specializuara për të vajzat e moshës 15-18 (19) vjeç. Trajnimet janë kryer nga Shërbimi Psiko-Social pranë ZVAP-ve, nga specialiste të suksesshme në biznese të fushave të ndryshme, nga femra intelektuale të suksesshme në shkollat e mesme të ZVAP-ve etj.
- Mentorim: Krijimi i programeve të mentorimit ku sipërmarrëset e suksesshme (gratë), ofrojnë ndihmë dhe këshilla për të rinjtë që duan të fillojnë bizneset e tyre. Një aktivitetet i tillë është organizuar dhe vazhdon të organizohet në çdo periudhë në shkollat e Mesme Profesionale si “Kolin Gjoka”- ZVA-Lezhë, të ZVA-Shkodër, Mirditë.
- Funksionimi dhe organizimi i aktiviteteve nga Qendrat Rinore ku të rinjtë (femra) nga zonat rurale kanë zhvilluar dhe zbatuar idetë e tyre për biznese të reja (ZVAP Kurbin dhe ZVAP Lezhë).



- Ndërveprim me komunitetin lokal: Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe informimit në komunitetet rurale për rëndësinë dhe mundësitë në sipërmarrje për gratë e reja. Kështu mund të përmendim takimet e organizuara komunitare, panairët e punës dhe promovimin e modeleve pozitive të sipërmarrjes nga gratë në shkollat e mesme rurale.

### 3. Udhëzuesi i Orientimit në Karrierë

Gjatë muajit Janar 2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar “Udhëzuesin e orientimit për karrierën” për nxënësit në klasën e 9-të. Ky Udhëzues u hartua nga grupi i punës me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para universitar (ASCAP), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Para universitar (DPAP) në bashkëpunim me drejtues të shkollave në arsimin bazë.

“Udhëzuesi i orientimit për karrierën” është një material ndihmës për shkollat dhe për institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin para universitar.

Udhëzuesi ka për qëllim:

- të mbështesë shkollat për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive për orientimin për karrierën me nxënësit e klasave të 9-ta;
- të ndihmojë dhe të orientojë drejtuesit e shkollave për koordinimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarive të orientimit për karrierën;
- të orientojë dhe të mbështesë koordinatorin e orientimit për karrierën për koordinimin dhe zhvillimin e veprimtarive të orientimit për karrierën;
- të mbështesë mësuesit kujdestarë, mësuesit e lëndëve/fushave të të nxënësve, psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë, për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive për orientimin dhe këshillimin për karrierën me nxënësit e klasës së 9-të;
- të mbështesë forcimin e bashkëpunimit me prindërit dhe me aktorët e tjerë, si shkolla të mesme profesionale, profesionistë të fushave të ndryshme, pushteti lokal, biznese etj., për orientimin e nxënësve për karrierën;
- t’u vijë në ndihmë Zyrave Vendore të Arsimit Para universitar (ZVAP-ve) dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit para universitar (DRAP-ve) për mbështetjen, koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive të institucioneve arsimore.

Udhëzuesi orienton koordinatorët e orientimit për karrierën, mësuesit, drejtuesit e shkollave, punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe aktorë të tjerë të angazhuar në këtë proces, në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Koncepti dhe rëndësia e orientimit për karrierën;
- Veprimtaritë e institucioneve arsimore për orientimin për karrierën e nxënësve në klasën e 9-të;
- Rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar në këtë proces.

#### 4. Koordinatorin për orientimin në karrierë

Bazuar në Udhëzimin nr. 14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", çdo Institucion i Ofritit të Arsimit dhe Formimit Profesional (IOAFP) ka në përbërje të saj edhe njësinë e zhvillimit.

Neni 93 i këtij udhëzimi përcakton:

Për realizimin e funksionit të orientimit dhe këshillimit për karrierë të nxënësve/kursantëve të ofruesit të AFP-së, njësia e zhvillimit, nëpërmjet koordinatorit përkatës:

- a) sigurohet që kandidatët për nxënës/kursant, prindërit dhe komuniteti, kanë informacion të mjaftueshëm mbi natyrën e profesioneve dhe kualifikimeve që ofrohen;
- b) kontribuon në procesin e regjistrimit dhe hartimit të procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për programe të AFP-së;
- c) sigurohet që nxënësit kanë informacion të mjaftueshëm për zgjedhjen e profilit, sipas strukturës së programit të kualifikimit;
- d) në bashkëpunim me koordinatorin/en për zhvillimin e kurrikulës, sigurohet që kurrikula e zbatuar përmban elemente të edukimit për karrierë;
- e) në bashkëpunim me koordinatorin/en për marrëdhënie me biznesin, qëndron i informuar dhe orienton nxënësit dhe prindërit e tyre me tregun e punës, mundësitë për karrierë dhe punëdhënësit e mundshëm, si edhe nivelet e pagave.

Për sa më sipër në të gjitha shkollat e mesme profesionale janë ngritur njësitë e zhvillimit me personat përgjegjës si dhe është kryer trajnimi dhe zhvillimi profesional i tyre nëpërmjet mbështetjes së AKPA dhe projekteve që mbështesin arsimin profesional.

Agjencia Austriake për Arsim dhe Ndërkombëtarizim, OeAD në bashkëpunim me AKPA ka organizuar në muajin qershor 2023 "Workshopin e Rrjetëzimit për Orientimin në Karrierë" për Koordinatorët e orientimit të karrierës të shkollave të AFP-së dhe DROFPP-ve, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës ndërmjet koordinatorëve të karrierës mbi sfidat dhe praktikat më të mira të ofritit të shërbimeve të orientimit në karrierë, si dhe stimulimi i një rrjeti ndërmjet koordinatorëve të karrierës për shkëmbim të vazhdueshëm mbi ofrimin e shërbimit të karrierës.

#### 5. Bashkëpunim ndërinstitucional me qëllim nxitjen e rritjes së numrit të nxënësve në arsimin profesional

Në kuadër të identifikimit dhe adresimit të sfidave është ngritur grupi ndërinstitucional i punës, me Urdhrin Nr. 23, datë 27.01.2023, me përfaqësues nga MFE, MAS, AKPA dhe DPAP. Ky grup pune ka kryer një analizë të arsimit të mesëm të sistemit para universitar me fokus nxitjen e regjistrimeve në arsimin e mesëm profesional. Gjithashtu, ai dakordësoi draftin dhe vendosi rikonceptimin e shërbimit për aplikim në e-Albania për regjistrim në shkollë të mesme profesionale dhe përfshirjen e mundësisë së revokimit të aplikimit online.

## 6. Krijimi i Akademisë së Inovacionit në shkollën e mesme profesionale “Gjergj Canco”

Bazuar në ligjin nr. 25, datë 31.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, si dhe në zbatim të vendimit nr. 315, datë 11.05.2022, të Këshillit të Ministrave, në datën 5-10 qershor 2022, u shpall thirrja për lehtësues të startup-eve, me qëllim krijimin e mundësisë për mbështetje me grante të tyre, ku një nga kategoritë që mbështeten, përfshinte dhe shkollat profesionale publike dhe private.

AKPA mbështeti aplikimin për 2 shkolla profesionale, nga të cilat Shkolla Teknike Elektrike “Gjergj Canco” Tiranë, rezultoi dhe fituese e këtij granti për projektin “*Akademi Inovacioni- nxitja dhe mbështetja e ideve sipërmarrëse të nxënësve të shkollës Gjergj Canco dhe jo vetëm.*”

Nëpërmjet këtij projekti u synua të zbatohet një ndërhyrje e integruar, që të stimulojë të rinjtë në shfrytëzimin e aftësive të tyre sipërmarrëse, duke vënë në dispozicion infrastrukturën fizike për të filluar një sipërmarrje dhe asistencën e nevojshme për tu konsoliduar në treg, duke u fokusuar në:

- Zhvillimin e aftësive të nevojshme të nxënësve me ide sipërmarrëse;
- Ofrimi i një programi trajnimi inovativ, të hapur, fleksibël dhe të dedikuar për dezenjimin dhe ngritjen e startup-eve;
- Rritjen e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm që kanë në fokus sipërmarrjen;
- Nëpërmjet përfshirjes së përfaqësuesve të biznesit, partnerëve socialë dhe novatorëve të mundshëm, synohet krijimi i një urë lidhëse midis nxënësve me ide sipërmarrjeje dhe palëve të treta të interesuar për financim.

Projekti, i cili gjen zbatim gjatë periudhës raportuese, në fazën fillestare realizoi rehabilitimin e hapësirave aktuale që shkolla ka në dispozicion dhe i përshtati ato për krijimin e një akademie inovacioni brenda shkollës “Gjergj Canco”. Kjo e fundit, nëpërmjet zbatimit të projektit, u pajis me bazë materiale fizike dhe software për trajnimin e nxënësve, si dhe krijimin e programeve të dedikuara të trajnimit ndaj nxënësve të shkollës për të stimuluar dhe nxitur idetë inovatore dhe iniciativat sipërmarrëse. “Akademia e Inovacionit” u inagurua në muajin shkurt të 2023 dhe aktualisht vijon me promovimin e kulturës së zhvillimit të ideve të reja dhe zbatimin e tyre në praktikë. Kjo ndihmon në nxitjen e kreativitetit dhe zhvillimit të teknologjive të reja, produkteve të reja dhe metodave të reja të biznesit, nga vetë nxënësit. Gjatë zbatimit të projektit, nxënës dhe mësues të kësaj shkolle ishin pjesëmarrës në takimet me ekspertë të fushës mbi sipërmarrjen, zhvillimin e seancave “brainstorming”, gjenerimin e ideve, ndërtimin e planit të biznesit për të krijuar startup-et e para dhe për konsolidimin e tyre në treg.

### ➤ Projekti i AFD-së- Expertise Francë

Në muajin mars 2023, AKPA ka nisur ciklin e takimeve me Aleancën Franceze për Zhvillim, me qëllim zbatimin e Programit të Asistencës Teknike (AT) të ofruar nga Expertise France (EF), i cili synon të mbështesë përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të zbatuar veprimet prioritare të Matricës së Politikave dhe në përgjithësi për të rritur barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave dhe vajzave të reja në ekonomi. Matrica e politikave është ndërtuar në bazë të tre shtyllave:

- Shtylla 1: Promovimi i aksesit të grave në asete përmes njohjes së pronësisë të pronave të paluajtshme.
- Shtylla 2: Përmirësimi i fushës së veprimit për gratë që të kenë akses në mundësitë e gjenerimit të të ardhurave.
- Shtylla 3: Forcimi i aranzhimeve institucionale për politikë bërje të informuar mbi gjininë.

Gjithashtu, asistenca teknike e Expertise France synon të mbështesë zbatimin e metodologjisë së menaxhimit të rasteve, duke përdorur këshillimin me katër faza, si dhe rritjen e kapaciteteve të stafit në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ekipi i ekspertëve po punon me grupin e punës në AKPA për aktivitetet sa më poshtë:

1. Hartimi i një pakete shërbimesh punësimi që synojnë gratë e papuna në zonat rurale dhe në zonat e pambuluara, që do të pilotohet në planin e punës në 3 bashki.
2. Hartimi i standardeve për shpërndarjen e zyrave të punësimit në territor, duke përfshirë zyrat e lëvizshme të ofrimit të shërbimeve të punësimit në Shqipëri dhe i komunikimit me publikun. Draft dokumenti “Drejt një pakete shërbimesh punësimi të përshtatur për gratë në zonat rurale dhe zona e pa mbuluara nga ofrimi i shërbimeve ekzistuese në Shqipëri” ka përfunduar dhe do të pilotohet në Elbasan, Lushnje dhe Kamëz. Zbatimi i këtij plani pilot do të ofrojë dëshmi të vlefshme për ecurinë apo mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm dhe zgjerimin e qasjes edhe në bashki të tjera.

Expertise France gjithashtu ka mbështetur organizimin e sesioneve të seminareve për të trajnuar stafet dhe rritur kapacitetet përkatëse në nivel qendror si dhe në nivel lokal, gjatë muajve tetor-nëntor 2023.

- Faqja web AFPro, si një hapësirë e dedikuar për orientimin në karrierë e promovimin e AFP përmes angazhimit, modeleve të suksesit (profesionistëve të spikatur) <https://afpro.al/rrjeti-afpro/>

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të ngritjes së rrjetit të profesionistëve AFPro, nga ana e AKPA, në bashkëpunim me UNICEF, është ndërtuar dhe aktivizuar Rrjeti i Profesionistëve për 3 fushat kryesore, i cili ka dhe një faqe të dedikuar web.

AFPro është një platformë, e cila bashkon studentë, mësues, sipërmarrës dhe biznese, profesionistë të rinj dhe politikëbërës, në një komunitet të fortë dhe të qëndrueshëm.

Rrjeti i Profesionistëve, AFPro - është një iniciativë e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe ka për qëllim të nxisë arsimin cilësor, të pasurojë ndërveprimet shkollë-biznes dhe të promovojë potencialet e karrierës në sistemin e Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri.

Aktivitetet e realizuara gjatë periudhës së raportimit në kuadër të Rrjetit të Profesionistëve AFPro, renditen më poshtë:

- Hack for Albania, u zhvillua në datë 26 – 27 qershor 2023. Ky aktivitet synonte ekspozimin e pjesëmarrësve ndaj kodimit dhe dizajnit me në qendër njeriun. Ky aktivitet bashkoi ekspertë të

rinj dhe teknologji për të punuar së bashku në ekipe, duke zgjidhur problemet e botës reale. Pjesëmarrës ishin nxënës nga shkollat e mesme profesionale “Hermann Gmeiner”, “Kamëz”, “Hoteleri Turizëm” dhe “Charles Telford Erickson”. Për nxënësit që shfaqën angazhim më të lartë dhe projektin më të pëlqyer u ofruan tre bursa nga Code for Albania.

- “Pyet Mentorët” Sesioni 1, u zhvillua online në datë 24 qershor 2023. Kjo rubrikë e AFPro iu dedikua informimit mbi arsimin/formimin profesional, këshillimit të karrierës, shkëmbimit të mendimit dhe dhënies së ekspertizës në fushat e TIK, Hoteleri-Turizmit dhe Bujqësisë.
- “Pyet Mentorët” Sesioni 2, u zhvillua në tre raunde, përkatësisht:
  - Në datën 12 dhjetor, u zhvillua forumi online dedikuar drejtimit TIK.
  - Në datën 20 dhjetor, u zhvillua forumi online dedikuar drejtimit Hoteleri-Turizëm.
  - Në datën 19 dhjetor, u zhvillua forumi online dedikuar drejtimit Bujqësi.
- Aftësitë e buta, Sesioni 1, u zhvillua online, në platformën zoom, më 29 Qershor 2023.
- Aftësitë e buta, Sesioni 2, u zhvillua online, në platformën zoom, më 13 Dhjetor 2023.

“Aktiviteti Aftësitë e Buta” synon të mbështesë nxënësit në kalimin nga shkolla në punë, duke u fokusuar te rëndësia e aftësive të buta. Ky forum trajtoi tema si: aftësitë e buta përpara aplikimit për punë (fuqia e networking), gjatë procesit të aplikimit (intervistat e punës) dhe në punë. Trajnimet u zhvilluan nga specialistë të fushës. Në takim morën pjesë mësuesit e kulturës profesionale, nxënësit e viteve të treta dhe të katërta nga të gjitha shkollat profesionale.

- “Festivali i Ushqimit” u organizua në datën 25 tetor 2023 në Shkollën Profesionale Elbasan, duke bërë bashkë nxënësit e arsimit dhe formimit profesional të drejtimit Hoteleri-Turizmit nga 10 qytete të Shqipërisë. Ky event u konceptua si një festival i mirëfilltë ushqimi, ku përmes sfidave në gatim, shërbim restoranti dhe në përgatitjen e pijeve, nxënësit patën mundësinë të përfaqësojnë shkollën e tyre në garën për çmimin fitues. Shkolla profesionale Elbasan u shpall fituese e kësaj sfide.
- Aktiviteti ‘Ditët e Shkëmbimit’ u zhvillua në datën 22 Nëntor 2023 në shkollën e mesme profesionale Kamëz. Përmes bashkëpunimit me partnerët dhe bizneset kryesore në këto industri, nxënësit patën rastin të eksplorojnë mundësi të ndryshme profesionale, të njihen me përfaqësues të bizneseve të industrive, të këshillohen për karrierën, si dhe të zgjerojnë rrjetin e tyre profesional. Gjithashtu, ky aktivitet i dha mundësinë bizneseve të shohin nga afër forcën e re të tregut të punës si dhe të eksplorojnë mundësi të reja bashkëpunimi. Nga shkollat profesionale Kamëz, Hoteleri-Turizëm Tiranë, Gjergji Canco dhe Hermann Gmeinner, në Tiranë u ftuan të ishin të pranishëm rreth 20 nxënës të klasave të 12-ta dhe të 13-ta nga secila shkollë, me qëllim krijimin e një rrjetëzimi midis nxënësve, bizneseve pjesëmarrëse dhe universiteteve. Gjithashtu, në këtë aktivitet kishte dhe një stendë përfaqësimi nga Zyra e Punës lidhur me politikat e punësimit ku u prezantuan jo vetëm programi i vetëpunësimit por edhe programet e tjera që ofrojnë Zyrat e Punës duke përfshirë edhe ato të parashikuara në kuadër të Garancisë Rinore me qëllim prezantimin e mundësive për punësim që mund të mbështesin këta nxënës pas përfundimit të shkollës.

## 7. Faqja e dedikuar për AFP aftesi.al

Në qershor 2023 u përfundua një faqe e dedikuar për AFP-ne <http://aftesi.al/>. Kjo faqe zyrtare është krijuar për t'i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve që dëshirojnë të marrin informacion të detajuar

dhe përditësuar rreth AFP në Shqipëri. Edhe ky instrument synon të rrisë nivelin e informimit mbi programet, kurset dhe nismat e lidhura me arsimin dhe formimin profesional.

- Plani i promovimit dhe orientimit në karrierë i ndërtuar nga AKPA në funksion të rritjes së numrit të nxënësve në arsimin profesional.

Gjatë muajve janar dhe shkurt 2023 u hartua plani i vitit të aftësive. Bazuar në objektivat dhe indikatorët në fushën e AFP-së, u ndërtua edhe skelet-plani i promovimit, proces i cili nisi të zbatohet duke filluar nga data 1 mars dhe vijoi deri në fillimin e vitit shkollor 2023-2024.

Plani i cili përmbledh aktivitetet në nivel kombëtar dhe nivel shkolle është miratuar në AKPA dhe është konsultuar dhe me drejtuesit e IOAFP-ve në takimet rajonale që u organizuan gjatë periudhës shkurt-mars.

Gjatë periudhës mars-shtator 2023 është zhvilluar një fushatë promovimi intensive në nivel kombëtar dhe në nivel shkolle. Aktivitetet promovuese të realizuara gjatë kësaj periudhe në nivel shkolle paraqiten sa më poshtë:

- Nga 2,907 shkolla 9-vjeçare në rang vendi, numri total i shkollave të vizituara në kuadër të promovimit ka arritur në 1,967.
- Janë kontaktuar 2,676 familje të nxënësve të klasave të 9-ta.
- Për promovimin e shkollave profesionale deri më tani janë realizuar 170 intervista në televizionet lokale.
- Gjatë 2023 shkollat profesionale kanë marrë pjesë në 93 panaiere.
- Janë realizuar 699 takime me aktorë të ndryshëm të tregut të punës si biznese, Zyrat e Punës, Zyrat Arsimore në bashki, shoqatat e turizmit dhe hotelerisë dhe institucione të tjera.
- Janë realizuar rreth 5,000 postime në rrjetet sociale
- Janë zhvilluar 634 aktivitete të këshillimit për karrierë, të tilla si takime me nxënës të klasave të 9-ta, takime me nxënës të klasave të XI-ta për profilizimin, dhe njohja e nxënësve të klasave të X-ta me modele CV, letra motivimi dhe kërkesa punësimi.
- Nxënësit e të gjitha shkollave profesionale kanë marrë pjesë në 119 konkurse të zhvilluara si nga vetë shkolla ashtu dhe në nivel rajoni me tematika si: Olimpiada botërore e ekonomisë, Re-debate, konkurse në fushat e pikturës, muzikës, volejbollit dhe futbollit.

Aplikimi për regjistrim në klasat e X-ta në shkollat e mesme profesionale ka qëndruar i hapur për periudhën 7 korrik - 30 shtator 2023, periudhë gjatë së cilës janë regjistruar gjithsej 4,377 nxënës, prej të cilëve 724 vajza. Ndërkohë, pas përfundimit të fazës së dytë e cila përfshiu dhe transferimet, rezultojnë të regjistruar në total në klasat e X-ta 4,709 nxënës.

AKPA nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit promovon në mënyrë të vazhdueshme rastet e suksesit të rinjve, që pas trajtimit me shërbime apo programe integrohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të suksesshme në tregun e punës apo orientohen drejt arsimit dhe formimit profesional. Gjatë vitit 2023 është realizuar publikimi/promovimi i 52 rasteve të suksesit të nxënësve që studiojnë në shkollat profesionale si dhe janë realizuar 53 video për promovimin e rasteve të suksesit të ndërmjetësimeve nga ana e Zyrrave të Punës apo të punësimeve nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.

Ndërkohë, janë realizuar dhe një sërë aktivitetesh të organizuara në nivel qendror dhe rajonal, kryesisht të orientuara drejt konkurseve, panairove dhe tavolinave të debatit, si nisma që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit/informimit mbi dobinë e benefitet e arsimit dhe formimit profesional.

Ndër to mund të përmendim:

#### 8. Projekti Super-Schools

Programi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) për programin rajonal Supershollat – Program i Shkëmbimit të Shkollave në Ballkanin Perëndimor. Supershollat ka për qëllim ndërtimin e paqes dhe të pajtimit në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (BE), Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) si edhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Në ciklin e parë, nga Shqipëria u mbështetën 11 shkolla të mesme (gjashtë gjimnaze të përgjithshme, një privat dhe 4 shkolla profesionale) dhe u shkëmbyen mbi 120 nxënës shqiptar. Gjatë vitit 2023, i cili përkon me ciklin e dytë të programit, u përzgjodhën 9 shkolla të mesme profesionale për të qenë pjesë e mobilitetit në rajon janë si më poshtë: Shkolla “Beqir Çela”, shkolla "Rakip Kryeziu”, shkolla “Hamdi Bushati, shkolla "Tregtare", shkolla "Kristo Isak", shkolla “Petro Sota”, shkolla "Salih Ceka", shkolla “Kamëz”, shkolla "Charles Telford Erickson".

Në datat 22-24 Nëntor 2023 në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë u zhvillua Konferenca Rajonale “RYCOgnized Vision: Education as a Peace Catalyst”. Në këtë konferencë morën pjesë 100 nxënës të shkollave të mesme, 100 mësues dhe 50 aktorë të tjerë rajonalë e zyrtarë të lartë. Në këtë event u shfaqën rezultatet e arritura në fushën e mobilitetit, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të paqes së të rinjve në Ballkanin Perëndimor, si dhe shërbeu gjithashtu si një platformë për shkëmbimin e përvojave.

#### 9. Projekti kombëtar “Re-Debate” në kuadër të projektit "Qëndro" në bashkëpunim me UNICEF.

Në kuadër të projektit “QENDRO”, UNICEF këtë vit ka mbështetur projektin kombëtar “Re-Debate” të zbatuar nga organizata Liburnetik, duke përfshirë dhe 14 shkolla të mesme profesionale, përkatësisht: Kolin Gjoka, Nazmi Rushiti, Hoteleri-Turizëm, Teknike Ekonomike, Profesionale Kamëz, Fan S. Noli, Enver Qiraxhi, Salih Çeka, Hasan Gina, Thoma Papapano, Shkolla Tregtare Vlorë, Antoni Athanas, Charles Telford Ericson, Kristo Isak.

Qëllimi kryesor i projektit ishte promovimi i kulturës së debatit nëpërmjet zhvillimit të aftësive komunikuese, të menduarit kritik dhe inkurajimit të tolerancës dhe respektit mbi idetë e ndryshme të nxënësve të shkollave të mesme. Projekti u zbatua gjatë periudhës shkurt – korrik 2023 në shkollat e mesme të qyteteve të Shqipërisë. Të rinjtë u trajnuan nga ekspertë në fushën e debatit dhe u organizuan debate në nivel qyteti/qarku dhe në nivel kombëtar. Shkolla e mesme profesionale Teknike-Ekonomike Tiranë u kualifikua deri në finale.

Kjo iniciativë do të vijojë edhe gjatë vitit të ardhshëm, dhe do të përfshijë 14 shkolla profesionale, përkatësisht: Kolin Gjoka, Nazmi Rushiti, Hoteleri-Turizëm, Teknike Ekonomike, Profesionale

Kamëz, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Tregtare Vlorë, Antoni Athanas, Charles Telford Ericson, Hermann Gmeinner, Pavarësia, Hamdi Bushati, Beqir Çela.

### **Organizimi dhe pjesëmarrja në Panairë**

10. **Panairi Future2Tech2023**, (21-22 Shtator 2023). Gjatë dy ditëve të panairit, mësues dhe nxënës/e të shkollave profesionale që ofrojnë drejtimin Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, së bashku me stafin e S4J, shpalosën për vizitorët përdorimin dhe ndërthurjen e teknologjive të ndryshme të mësimdhënies dhe mësim nxënies, përdorimin e platformave moodle dhe të industrisë si Cisco Academy, metodologjinë e pasurimit të kurrikulës të zbatuar me materiale digjitale mësimore, përdorimin e Zoom dhe Google Classroom për mësimin online dhe hibrid, vlerësimin e nxënësve përmes Kahoot etj.
11. **Panairi i punës dhe karrierës, Automotive Fair Albania**, (26-29 Tetor 2023). Në këtë aktivitet, qëllimi kryesor ishte prezantimi i të rinjve me tregun automotiv, kualifikimi dhe aftësimi i tyre në përputhje me sfidat e reja në tregun e punës lidhur me kriteret e bizneseve, si dhe studimi i trendeve më të reja në treg. Shkollat profesionale pjesëmarrëse ishin: shkolla Karl Gega, shkolla Beqir Çela dhe shkolla profesionale Kamëz. AKPA u përfaqësua në forumin "Start-Up Solutions and Innovation".
12. **Panairi Agrotech 2023\_Expocity Albania** Konkursi i shkollave profesionale, (18-20 Tetor 2023). Në ambientet e ExpoCity Albania, në datat 18-20 tetor u zhvillua edicioni i 4-ët i panairit të bujqësisë "Agrotech Expo", ku morën pjesë shkollat profesionale që ofrojnë drejtimin bujqësi. Pjesëmarrja e shkollave ishte në formën e një konkursi.

### **Realizimi financiar**

Realizimi i kësaj mase është 100%. Kjo vjen si pasojë e aktiviteteve të shumta të organizuara dhe mbështetjes së donatorëve.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 100%. Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%.



## Realizimi Masa 2.1.3 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 100%. Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale por në 2023 është ngritur faqe e dedikuar për AFP-në <http://aftesi.al/>. Si konkluzion mund të thuhet se janë kryer shumë më tepër shpenzime se sa janë planifikuar në strategji.

Kjo masë nuk ka hendek financiar. Për këtë masë 100% e fondeve janë të buxhetit të shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

**Masa 2.1.4** Nxitet dhe forcohet novacioni, përmes sipërmarrjeve rinore dhe nga të rinjtë duke e vënë novacionin rinor në fokus të kuadrit ligjor dhe politikave publike të Start Up-eve, politikave të punësimit dhe mbështetjes së nismave si co-working spaces.

Gjatë periudhës raportuese, nëpërmjet Fondit Startup nga MiSHMS janë mbështetur 5 Bashki me suport financiar për zhvillimin e nismave për hapësira të përbashkëta pune (mbështetje infrastrukture dhe program). Konkretisht bashkitë e mbështetura janë: Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Pukë, Bashkia Dimal, Bashkia Roskovec, dhe Bashkia Bulqizë.

Në dhjetor të vitit 2022 rezulton se, nëpërmjet Fondit Startup të parashikuar për këtë vit, janë mbështetur 29 startupe dhe 29 lehtësues.

Mbështetja për zhvillimin e startup-eve ka për synim:

- lehtësimin e krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së startup-eve;
- krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore;
- lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare;
- përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike.

### Realizimi financiar

Në këtë masë është parashikuar fondi i mbështetjes për start up i Ministrisë së Shtetit për Mbështetjen e Sipërmarrjes. Por në 2023 nuk u hap thirrja dhe si pasojë shpenzimet e planifikuara nuk janë realizuar

Si konkluzion mund të thuhet se është **masë e porealizuar**.

**Masa 2.1.5** Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit e më gjerë.

Kjo **masë është e porealizuar**.

### **Realizimi financiar**

Në këtë masë janë parashikuar aktivitete që lidhen me përdorimin e portalit “Të rinjtë për të rinjtë” dhe mbështetjen e lëvizshmërisë së të rinjve për arsye punësimi. Në 2023 nuk është ngritur portali dhe nuk janë ndërmarrë politika mbështetëse për mbështetjen e lëvizshmërisë së të rinjve

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e porealizuar**.

### **Përmbledhje për këtë objektiv specifik.**


**Institucionet kanë raportuar të gjithë masat që lidhen me objektivin specifik 2.1.**

### **Realizimi financiar**

Realizimi i 5 masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë:

Tabela 35

## Statusi i realizimit të masave të Objektivit 2.1




**Objektivi Specifik 2.2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.**

Realizimi i fondeve totale është 99.6%. Kurse përsa i përket zërave specifikë mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 77%. Për zërin materiale, shërbime dhe

kontigjenca niveli i realizimit është 99.6%, ndërkohë për masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Tabela 36

## Realizimi Masa 2.2 i SKR për vitin 2023



Rreth 98.3% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 1.7% janë fonde të mbuluara nga donatorët. Hendeku financiar për këtë masë është relativisht i vogël dhe ka pasur një ulje në krahasim me planifikimin.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 2.2.1** Mbështeten të rejtat dhe të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit, si kalimi në shkollën e mesme të lartë dhe kalimi nga shkolla në tregun e punës ose në studimet e nivelit universitar, me këshillim dhe informacione, që lidhin përzgjedhjen e fushës së arsimimit me mundësitë në tregun e punës, në bashkërendim me masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

Politikat arsimore në arsimin para universitar, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 dhe reforma e kurrikulës së bazuar në kompetenca, kanë vënë në fokus edukimin dhe orientimin në karrierë të nxënësve, duke synuar mbështetjen e tyre për t'u orientuar dhe për të bërë zgjedhje dhe për të ndërmarrë vendime të mirë informuara, si dhe për t'i mbështetur ata në tregun e arsimit apo në tranzicionin e sistemit arsimor.

Kurrikula e bazuar në kompetenca, që po zbatohet në të gjithë arsimin para universitar, synon që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të nxënit gjatë gjithë jetës. Në arsimin bazë (klasat 1-9) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12), njohuritë e integruara në lëndë të ndryshme, si qytetaria, gjuha shqipe etj., dhe aftësitë që nxënësit zhvillojnë, i udhëheqin ata në procesin e njohjes së interesave, potencialit dhe nevojave të tyre, i ndihmojnë të zbulojnë rëndësinë e secilit profesion, të orientohen për të menduar në të ardhmen, për të menduar mirë, për t'u orientuar drejt zgjidhjes së problemit të tyre dhe aftësitë sipërmarrëse.

Gjithashtu, në arsimin e mesëm të lartë, rreth 12 module profesionale, si pjesë e kurrikulës me zgjedhje, synojnë zhvillimin e aftësive profesionale dhe sipërmarrëse të nxënësve. Moduli "*Edukimi në karrierë*" është një lëndë që i kushtohet tërësisht orientimit të nxënësve në karrierën e tyre, e cila ofrohet në arsimin e mesëm të lartë si pjesë e kurrikulës me zgjedhje. Kjo lëndë ka 1 orë/javë ose 36 orë në vit.

Krahas mbështetjes që ofron kurrikula për edukimin në karrierë të nxënësve, orientimi në karrierë i nxënësve mbështetet edhe nëpërmjet planifikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëshkollore, me pjesëmarrjen dhe angazhimin e mësuesve, drejtueseve të shkollave, shërbimit psiko-social në shkollë, si dhe bashkëpunimit e partneritetit me partnerë socialë, si prindërit, bizneset, pushteti vendor, institucione të tjera arsimore, organizata të tjera etj.

Vëmendje e veçantë i kushtohet dy pikave të tranzicionit, kalimit nga klasa e 9-të në arsimin e mesëm të lartë dhe kalimi nga klasa e 12-të në arsimin e lartë ose tregun e punës.

Në secilën shkollë është caktuar një koordinator i orientimit në karrierë, i cili në bashkëpunim me mësuesit, punonjësit e shërbimit psiko-social, drejtuesit e shkollës, prindërit dhe anëtarët e tjerë të komuniteteve mbështetin edukimin dhe orientimin në karrierë të nxënësve.

Aktivitetet e orientimit të karrierës në shkolla synojnë të sigurojnë që nxënësit të jenë të mirë informuar, të ndihen të mbështetur për ta bërë sa më efektiv kalimin nga arsimi 9-vjeçar në arsimin e mesëm dhe të lartë dhe të ndjekin me sukses rrugët e tyre të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Aktivitetet për orientim në karrierë përfshijnë ditët e karrierës, bisedat me prindërit, vizitat në institucionet arsimore dhe të zhvillimit profesional, aktivitete që mbështetin zhvillimin socio-emocional të nxënësve etj.

Krahas mbështetjes që kurrikula ofron për edukimin e nxënësve për karrierën në të gjithë arsimin para universitar, orientimi i nxënësve për karrierën është një fushë prioritare e përgatitjes dhe formimit të nxënësve në sistemin arsimor para universitar. Me Urdhërin Nr. 600, datë 19.10.2023 është miratuar dhe ka filluar zbatimin “*Udhëzuesi i orientimit për karrierë të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6 – 9)*”. Udhëzuesi ka si qëllim mbështetjen e shkollave dhe të institucioneve arsimore përgjegjëse për arsimin para universitar për ndërtimin e praktikave të qëndrueshme të orientimit dhe këshillimit për karrierën.

Ne këtë kuadër për fuqizimin e kapaciteteve të ekipeve të orientimit për karrierën në shkolla (drejtues, koordinatorë të shkollave, mësues të klasave 6 dhe 9) janë zhvilluar:

- Trajnime intensive për koordinatorët e këshillimit të karrierës në teknikat dhe strategjitë më efektive të këshillimit të karrierës, përfshirë metodat e intervistimit, analizën e preferencave të karrierës, dhe zhvillimin e planeve të karrierës për të rinjtë.
- Janë organizuar sesione trajnuese për të përmirësuar aftësitë e koordinatorëve të këshillimit të karrierës në fusha të tilla si komunikimi, konsultimi, dhe ndihma në zhvillimin e aftësive të punës. Këto sesione mund të përfshijnë role-playing, analiza të rasteve, dhe shkëmbim të përvojave. (ZVAP) (afërsisht 5,000 të trajnuar).
- Sigurimi i aksesit për koordinatorët e këshillimit të karrierës në një bazë të mirë informuar të burimeve dhe informacioneve për karrierën dhe zhvillimin e aftësive. Trajnimi në përdorimin e burimeve të ndryshme të informacionit dhe softuerëve të specializuar për këshillimin e karrierës. (ZVAP)
- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave: organizimi i takimeve të rregullta dhe aktiviteteve kombëtare/ ndërkombëtare për koordinatorët e këshillimit të karrierës për të shkëmbyer përvojat dhe praktikat më të mira në fushën e këshillimit të karrierës, vizita në institucione të tjera, konferenca dhe workshop-e të përbashkëta.

- Promovimi i arsimit profesional nëpërmjet fushatës informuese “Zgjidh zanatin”, që ka si qëllim fuqizimin e ekipeve të këshillimit të karrierës në shkolla dhe promovimin e arsimit profesional, për t’i orientuar nxënësit drejt formimit profesional dhe zanatit, që do ju shërbejë për të ardhmen e tyre.
- Duke filluar nga klasa e 10-të e në vazhdim, por në mënyrë të veçantë në klasën e 12-të, zhvillohen seanca informuese me nxënës dhe prindër për lëndët dhe provimet me zgjedhje, në lidhje me mundësitë për ndjekjen e drejtimeve të caktuara, ditët e hapura të informimit pranë universiteteve, panairët e karrierës, vizita në kompani të ndryshme etj.
- Ditët e hapura dhe ditët e informimit me maturanët janë veprimtari që zhvillojnë bashkëpunimin e shkollave të mesme me universitetet përgjatë të cilave nxënësit informohen lidhur me programet e studimit që mund të ndjekin.

Në arsimin e mesëm e të lartë, duke e njohur rëndësinë e orientimit në karrierë për nxënësit, shkollat kryejnë aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe jashtëshkollore, përmes angazhimit dhe punës ekipore, për të informuar nxënësit dhe për të mbështetur zgjedhjet dhe vendimet e tyre në lidhje me arsimimin e mëtejshëm dhe përgatitjen për tregun e punës. Duke filluar nga klasa e 10-të e në vazhdim, por veçanërisht në klasën e 12-të, zhvillohen seanca informuese me nxënës dhe prindër për lëndët me zgjedhje dhe provimet. Organizohen ditë të hapura informimi në universitete, panairë karriere, vizita në kompani të ndryshme, panair pranë Dhomës së Tregtisë (Punë dhe Studim) etj.

Shërbimi psiko-social në shkolla luan një rol të rëndësishëm nëpërmjet mbështetjes që u ofron nxënësve në përpjekjet e tyre për të kapërcyer sfidat, për të njohur dhe kuptuar veten për sa i përket interesave, aftësive, pikave të forta dhe të dobëta, mundësive për përmirësim duke i mbështetur ata gjatë gjithë tranzicionit dhe karrierës së tyre.

Forcimi i orientimit në karrierë në arsimin para universitar mbështetet nëpërmjet trajnimeve dhe zhvillimit profesional të kapaciteteve të shkollave dhe të zyrave arsimore vendore dhe rajonale.

Gjithashtu:

- Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare (ZVAP) dhe Institucionet e Arsimit Para universitar (IAP-shkollat e mesme), kanë hartuar kalendarin e aktiviteteve për informimin dhe këshillimin e nxënësve të klasave 10-të, 11-të dhe 12-të, me qëllim orientimin e tyre drejt rrugës së suksesit.
- ZVAP-të kanë ofruar mbështetje dhe këshillim pranë institucioneve arsimore, për çështje të ndryshme që lidhen me orientimin për karrierën.
- ZVAP-të kanë iniciuar shkëmbimin e përvojave pozitive midis institucioneve arsimore në punën edukuese mbi këshillimin e karrierës.
- Shërbimi Psiko-Social pranë ZVAP-ve, ka realizuar seanca trajnuese me mësues, nxënës, prindër, të tilla si: trajnim me mësues: “*Mësuesi si këshillues karriere në shkollë*”; trajnim me nxënës: “*Menaxhimi i kohës, element kyç në suksesin e përgatitjes për të ardhmen*”; “*Koncepti për veten dhe njohja e aftësive personale si faktor në zgjedhjen e profesionit*”. Bisedë me nxënës: “*Si të menaxhojmë stresin para provimeve*”. Takim me prindër: “*Roli i prindit në zgjedhjen e degëve të fëmijëve, dilema dhe çështje*”.

*Bashkëpunimi i ZVAP-ve, IAP-ve me AKPA ku janë realizuar:*

➤ Tryeza të rumbullakëta me drejtues, mësues, nxënës të rinj të Qendrës Rinore, përfaqësues të IAP-ve, mbi rëndësinë e mbështetjes së të rinjve me qëllim orientimin për gjatë gjithë jetës për karrierën dhe sipërmarrjen.

➤ Biseda informuese me nxënës, mësues, prindër, drejtues të arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional, përfaqësues të AKPA, mbi rëndësinë e ndjekjes së kurseve afatshkurtra ose post-sekondare nga të rinjtë që janë duke ndjekur studimet e arsimit të mesëm të lartë ose arsimit profesional, si dhe atyre që kanë përfunduar studimet universitare me qëllim integrimin në tregun e punës, si dhe me aftësitë e duhura që duhet të zotërohen nga të rinjtë për punësim/vetëpunësim ose edhe për hapjen e një biznesi personal dhe familjar. Vizita pranë bizneseve lokale të nxënësve të grupmoshave të ndryshme të arsimit bazë dhe të lartë, të mësuesve, drejtuesve të IAP-ve për t'u njohur më nga afër me praktikën e punës, për t'u socializuar me mjedisin dhe profilin e punës etj.

➤ Ditë të hapura, të realizuara nga shkollat profesionale me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave 9-vjeçare të ZVAP, përfaqësues të bizneseve lokal, për orientimin dhe informimin e tyre mbi përfitimet e të ndjekurit të arsimit profesional dhe mundësitë e karrierës që rrjedhin prej arsimimit në këto IAP.

Takim me prindër: “Roli i prindit në zgjedhjen e shkollës së arsimit të mesëm të lartë të fëmijëve, dilema dhe çështje”. Bisedë me nxënës: “Si të menaxhojmë stresin para provimeve”.

## Realizimi financiar

Duke u nisur nga të dhënat e raportuara në lidhje me aktivitetet që janë kryer në lidhje me realizimin e kësaj mase rezulton se gjatë 2023 janë kryer aktivitete të shumta nga institucionet shtetërore dhe nga donatorët.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 99%. Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 71%. Ky nivel realizimi vjen si pasojë e mosngritjes së portalit “Të rinjtë për të tinjtë”.

Tabela 37

## Realizimi Masa 2.2.1 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 100%. Ky fond financohet nga “Qëndro në shkollë”, projekt i financuar nga Italia dhe UNICEF. Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

**Masa 2.2.2** Promovohet përdorimi i sigurt i teknologjive të reja dhe mbështetet përvetësimi i aftësive dhe kompetencave digjitale të shekullit të 21-të për të rinjtë, si në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe atë profesional ashtu edhe në sistemin e trajnimeve formale dhe jo-formale.

Programi "Shkollat e Shekullit 21" të British Council në Shqipëri ka qenë një ndër pionierët në promovimin e përdorimit të teknologjive të reja dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencave digjitale të shekullit të 21-të në sistemin arsimor. Fokusi kryesor i këtij programi është rritja e kapacitetit të drejtorëve të shkollave dhe mësimit në trajtimin e nxënësve për mendim kritik, zgjidhjen e problemeve dhe shkathtësitë digjitale, duke përfshirë njohuritë praktike të kodimit.

Ky program ka filluar të zbatohet me sukses që nga viti 2018, duke u përdorur në të gjitha shkollat e mesme të ulëta në Shqipëri. Financimi për këtë projekt ka ardhur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Një pjesë e rëndësishme e këtij programi është përdorimi i pajisjeve mikro:bit, një lloj kompjuteri xhepi që lejon nxënësit të programojnë dhe përdorin aftësitë e tyre digjitale për zgjidhjen e problemeve në të gjitha lëndët.

Trajnimi i mësimit nënxënësve për përdorimin e pajisjeve mikro:bit dhe kodimin është ofruar në mënyrë online përmes një platforme të posaçme në Moodle dhe është zhvilluar nga ekspertë britanikë dhe lokale të British Council. Pjesëmarrja në trajnim mund të jetë fizike ose online, duke përfshirë një version self-pace ose autodidakt, të cilat janë të akredituara nga ASCAP.

Ky program trajnimi për mësimit nënxënësit përfshin një varg modulesh, duke filluar nga njohja e mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, deri te përdorimi i pajisjeve mikro:bit për krijimin e projekteve të shkollës. Në fund të trajnimit, mësimit nënxënësit mund të fitojnë një certifikatë duke kaluar një test online dhe duke demonstruar aftësitë e tyre të fituara në praktikë në klasë.

Për mësimit nënxënësit dhe drejtorët e shkollave, programi ka përfshirë sesione trajnuese në fusha të ndryshme, përfshirë ndërtimin e një ambienti përkras për aplikimin e njohurive, themelimin e klubeve të kodimit dhe çertifikimin e mësimit nënxënësve. Programi përfshin edhe një komponent mentorimi, ku pjesëmarrësit mbështeten gjatë një periudhe 12-javore nëpërmjet resurseve dhe shembujve të praktikave më të mira. Vizitat mentoruese përfshijnë shqyrtimin e planeve mësimore, projektin e shkollës dhe krijimin e klubeve të kodimit në shkolla.


## **Realizimi financiar**

Duke u nisur nga të dhënat e raportuara në lidhje me aktivitetet që janë kryer në lidhje me realizimin e kësaj mase, rezulton se gjatë 2023 janë kryer aktivitete të cilat janë mbështetur nga donatorët dhe

gjithashtu janë zhvilluar trajnimet e planifikuara. I vetmi element që e ul realizueshmërinë është mos shtrirja e këtyre trajnimeve në sistemin e trajnimeve formale dhe joformale.

Tabela 38

## Realizimi Masa 2.2.2 i SKR për vitin 2023



Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 79%. Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100% pasi është bërë promovim i aktiviteteve gjatë gjithë vitit. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 79% pasi ka hartim kurrikulash dhe realizim trajnimesh për mësuesit por këto masa nuk janë shtrirë në sistemin e trajnimeve formale dhe joformale. Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

51% e fondeve të realizuara janë të financuara nga donatorët dhe 49% janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe hendeku financiar faktik është 0.8 milion lekë kurse ai i planifikuari është rreth 2.3 milion lekë

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

**Masa 2.2.3** Mbështeten dhe zhvillohen programe të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanatit dhe aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme, me fokus të veçantë tek të rejtat.

### ➤ Programi Jashtë orarit mësimor

Implementimi i programit “Jashtë orarit mësimor” për fëmijët filloi në muajin janar 2023 gjatë semestrit të dytë të vitit shkollor 2022-2023 nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë në 200 shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Për t’i ofruar çdo fëmije mundësinë të ndjekë kurse pas-shkolle falas është konceptuar Programi “Jashtë orarit mësimor”, i cili përfshin kurse në pikturë, muzikë, kor, teatër, zeje, teknologji, sport dhe kulturë. Programi ka si qëllim të rrisë orientimin pro-social dhe komunitar te fëmijët dhe të rinjtë, duke i shndërruar shkollat në qendra të jetës në komunitet; të përmirësojë të nxënit te nxënësit, duke ofruar mundësi joformale të të nxënit në bashkërendim dhe si shtojcë e kurrikulës formale; të përmirësojë gatishmërinë dhe ndërgjegjësimin rreth karrierës; të mbështesë shëndetin fizik dhe psiko-social të nxënësve.



Programi po zbatohet në formën e lëndëve me zgjedhje që zhvillohen në mjediset e shkollës dhe zhvillohen nga mësuesit e së njëjtës shkollë, rregullisht (dy herë në javë) gjatë gjithë vitit shkollor. Në total, u hapën 1041 kurse tematike në 8 disiplina (pikturë, muzikë, kor, teatër, artizanat, teknologji, sport dhe permakulturë), duke angazhuar mbi 644 mësues dhe duke përfshirë më shumë se 10,000 nxënës të sistemin para universitar.

Në shtator 2023 ka filluar sërish implementimi i nivelit të parë të programit nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë për vitin akademik 2023-2024.

Në datën 28 tetor 2023 u organizua aktiviteti "Sporti për Zhvillim" në Thumanë, zonë në rindërtim pas tërmetit të vitit 2019. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të programit jashtëshkollor, duke synuar të evidentojë zonat ku niveli i dytë i programit do të zbatohet.

Në të njëjtën kohë, gjatë periudhës së raportimit, grupi ndërinstitutional ka punuar në nivelin e dytë të Programit Jashtëkurrikular, i cili do të përbëhet nga kurse më të avancuara që zhvillohen në qendra të specializuara.

#### ➤ Ekipet Sportive

Programi i Ekipeve Sportive ka si qëllim të promovojë jetën e shëndetshme sportive, të largojë të rinjtë nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet në jetën e tyre sociale, si dhe t'i ndihmojë ata që të shpenzojnë kohën pas orarit mësimor në mënyrë cilësore.

Në edicionin e parë, ky projekt përfshiu rreth 10,000 fëmijë dhe të rinj të ekipeve sportive në volejboll dhe basketboll nga 61 qytete të Shqipërisë, dhe mbi 235 shkolla pjesëmarrëse.

Gjatë periudhës së raportimit, ka filluar zbatimin edicioni i dytë i Programit "Ekipet sportive" në shkolla. Gjatë vitit 2022 janë formuar rreth 700 ekipe basketbollit dhe volejbollit për të dyja gjinitë në arsimin para universitar. Çdo fëmijë e i ri sportist i përfshirë në programin e ekipeve sportive, merr gjithashtu falas të gjithë bazën e nevojshme materiale për të zhvilluar trajnimet dhe ndeshjet sportive si pjesë e kampionateve sportive në nivel bashkie, qaraku dhe kombëtar.

Implementimi i suksesshëm i edicionit të parë të programit, u ndoq nga fillimi i punës për edicionin e dytë, ku u ristrukturuan ekipet për sezonin e ri.

Në qershor 2023 u realizua trajnimi i Volejbollit në bashkëpunim me GIZ, ku ishin pjesëmarrës 51 trajnerë, ndërsa në korrik 2023 u realizua trajnimi i Basketbollit, ku ishin pjesëmarrës rreth 30 trajnerë të ekipeve sportive.

Gjithashtu, janë zhvilluar trajnimet e mësuesve në basketboll dhe volejboll, ku morën pjesë 102 mësues në volejboll dhe 160 në basketboll, të cilat u ndoqën me trajnime edhe nga federatat ndërkombëtare të këtyre sporteve ku morën pjesë dhe u certifikuan 170 mësues për secilin sport. Për mbarëvajtjen e ndeshjeve janë trajnuar edhe 76 arbitra të rinj në volejboll dhe 68 në basketboll.

Për edicionin e dytë të programit, gjatë vitit 2023 janë konfirmuar 10,000 nxënës, 389 trajnerë dhe në total janë 760 ekipe.

Të gjitha shkollat janë përzgjedhur duke plotësuar kushtin bazë të të paturit dy ambiente sportive, palestër të brendshme dhe të jashtme për kryerjen e stërvitjes si dhe përzgjedhje të trajnerëve të kualifikuar.

Ekipe për edicionin e dytë të programit kanë nisur stërvitjen nga data 15 shtator sipas planit stërvitor miratuar nga federatat për të dyja disiplinat, volejboll dhe basketboll.

Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë periudhës raportuese lidhur me programin “Ekipe sportive” në shkolla gjithashtu ka ndërmarrë aktivitetet si më poshtë vijon:

13. Trajnim me drejtues, mësues të edukimit fizik të IAP-ve tona ku zbatohet programi kombëtar “Ekipet sportive në shkolla”, në disiplinat e ndryshme sportive, si: volejboll, basketboll, futboll me qëllim njohjen dhe zbatimin e këtij programi që ka në fokus promovimin e jetës së shëndetshme sportive, largimin e të rinjve nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet në jetën e tyre sociale, si dhe t’i ndihmojë ata që të shpenzojnë kohën pas orarit mësimor në mënyrë cilësore;
14. Zhvillimi i aktiviteteve/garave sportive në nivel shkolle, midis shkollave dhe në nivel qarku me qëllim nxitjen e të rinjve për pjesëmarrjen në këto aktivitete dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë që ato kanë në sigurimin e një jetese të shëndetshme.
15. “Shëndeti, sporti dhe mjedisi”, në kuadrin ligjor të politikave për mbrojtjen e shëndetit dhe të shtrirjes së edukimit shëndetësor në institucionet dhe kurrikulat e arsimit para universitar. Aktivitete në fushën e ndërgjegjësimin për ruajtjen e mjedisit. Fushata sensibilizuese mbi mbrojtjen e pyjeve, mbajtjen pastër të mjedisit, riciklimi.
16. Kampionati i volejbollit për vajza/djemtë mes shkollave të qytetit me tematikë: “Të rinjtë e duan sportin”, me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm lokalë dhe sportistë të njohur të qytetit.
17. Aktivitete ekstrakurrikulare të zhvilluara nga nxënësit gjimnazistë, vullnetarë, të talentuar në fusha dhe disiplina të ndryshme: art, sport, kulturë, me nxënës të shkollave 9-vjeçare me mbështetjen e ZVAP-ve dhe Qendrave Rinore;
18. Shpërndarja e ndihmave për familjet në nevojë nga të rinjtë vullnetarë në bashkëpunim me Qendrën Lira (Berat). Konkurs me ese të nxënësve të shkollave të mesme, në bashkëpunim me UNICEF;
19. Punë vullnetare: Vizitë në një qendër sociale në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve. Qeveria e nxënësve shpërndau disa pako ushqimore në një qendër të moshuarish në qytetin e Elbasanit, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dega Elbasan, me qëllim ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve me ndjenjën e respektit për të moshuarit;
20. Plotësim i formularëve: Përzgjedhja e kurseve të arteve dhe zejeve nga ana e nxënësve dhe prindërve. Identifikimi i profesioneve dhe preferencave për të ardhmen. Aktivitete në kuadër të kurseve arteve dhe zeje.
21. Zhvillimi i takimeve për organizimin e projekteve dhe trajnimeve edukative, me organizatat rinore për të promovuar njohuritë dhe aftësitë në fushat e edukimit global, qytetarisë globale, dhe paqëndrimit. Këto trajnime kanë patur në fokus temat e përfshira si, paqja në nivel lokal dhe global., solidariteti, dhe barazi gjinore;
22. Organizimi i fushatave sensibilizuese dhe informuese për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit për rëndësinë e vlerave të shoqërisë gjithëpërfshirëse, tolerancës dhe barazisë gjinore;
23. Krijimi i partneriteteve dhe rrjeteve të bashkëpunimit me organizata të tjera rinore, institucione akademike, dhe institucione të tjera për të përforcuar përpjekjet në fushën e

edukimit global dhe të qytetarisë globale. Këto partneritete ndihmojnë në shkëmbimin e përvojave dhe burimeve për të përmbushur qëllimet e përbashkëta;

24. Shkëmbime të eksperiencave midis shkollave të mesme të rajonit, në kuadër të projektit Western Balkans School Exchanges "*Super Schools*", të zbatuar nga RYCO. Aktiviteti përmyllës për shkëmbimin e eksperiencave midis shkollave të mesme, për vitin shkollor 2022-2023 u realizua në nëntor 2023, në Bosnje-Hercgovinë.

➤ Fushat e përparësisë së Thirrjes nr. 2 dhe 3 të AKR-së

Thirrjet II dhe III të AKR-së, nëpërmjet përcaktimit të fushave të përparësisë, kanë synuar adresimin e prioriteteve të Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe konkretisht, e lidhur me këtë masë është, përcaktimi i një prej tre fushave të përparësisë "*Mbështetja mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve*".

Nga Organizatat rinore dhe Organizatat për të rinjtë nëpërmjet mbështetjes të projekteve rinore të thirrjes II, zbatimi i projekteve të së cilës ka përfunduar gjatë 6-mujorit të dytë të 2023, janë impaktuar 5,666 të rinj në nivel kombëtar, ku në raport me prioritetin "*Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve*" janë impaktuar 3,359 të rinj në total.

Projektet fituese të thirrjes së III të AKR-së, janë aktualisht në zbatim.

➤ Aktivitete të tjera

### **RINCAMP**

Një nga aktivitetet më dinamike dhe interaktive ishte realizimi i Shkollës Verore "RinCamp", i realizuar në bashkëpunim e UNICEF Albania e World-Vision Albania, partnerë dhe mbështetës në përmbushjen e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, nga data 31 gusht deri më 3 shtator. Qëllimi i këtij aktiviteti është të ndihmojë të rinjtë të zgjerojnë horizontet e tyre, të zhvillojnë aftësi të reja, si dhe të socializohen me njëri-tjetrin.

Në "RinCamp 2023" morën pjesë 100 të rinj nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, të cilët përgjatë kampit u njohën me këndvështrimet dhe përvojat e 26 panelistëve rreth tranzicionit në tregun e punës – risitë dhe ndryshimet e tregut në vitet e fundit; digjitalizimit të vendit të punës dhe arsimit; kërkimit shkencor mbi politikën rinore; strukturat vendore rinore; zhvillimin e aftësive të lidershit dhe aftësive ndërpersonale; si dhe aftësive të buta. Në përfundim të kampit, të rinjtë sugjeruan programe e nisma që mund të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë së jetesës tek të rinjtë, në përputhje me tre qëllimet politike të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 për fuqizimin e të rinjve.

### **CODE WEEK - HACKATHON**

Gjata datave 8-10 Shtator 2023 u zhvillua Albania Code Week Hackathon si pjesë e EU Code Week nga Komisioni Europian. Gjatë këtij aktiviteti u mbajtën 10 sfida në nivel kombëtar. 50 konkurrentë energjikë dhe plot pasion rreth teknologjisë punuan për zgjidhjen e disa sfidave në vendin tonë në fushën e arsimit, transportit, turizmit, mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit, monitorimin e ajrit, ujit dhe zjarreve.

## Realizimi financiar

Këtu është programi i mbështetjes së zhvillimit të sporteve i zbatuar nga KOKSH. Fondi i planifikuar për këtë masë ishte vetëm me fonde të buxhetit të shtetit. Ndërkohë, nga sa është raportuar dhe përshkruhet më sipër, mund të thuhet se masa ka mbi realizim

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 100%. Përsa i përket zërave specifike pagat dhe sigurimet shoqërore nuk janë planifikuar ndërsa niveli i realizimit të shpenzimeve materiale shërbime dhe kontigjenca është 100%. Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Sipas planifikimit 100% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe masa nuk ka hendek financiar.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

## Përmbledhje për këtë objektivin specifik 2.2,


### Realizimi financiar

Realizimi i 3 masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë

**Objektivi Specifik 2.3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.**

Tabela 39


## Statusi i realizimit të masave të Objektivit 2.2



Në vitin 2023 ka vazhduar apo filluar realizimi i 2 nga 4 masat e planifikuara. Realizimi i fondeve totale është 78%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%.

Tabela 40

## Realizimi Objektivi 2.3 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 78%, ndërkohë për masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime kapitale. Rreth 15.6% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 84.4% janë fonde të mbuluara nga donatorët. Hendeku financiar për këtë masë është relativisht i vogël dhe ka pasur një ulje në krahasim me planifikimin.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 2.3.1** Nxiten punët e denja dhe të përshtatshme për të rejtat dhe të rinjtë përmes politikave të punësimit, miqësore dhe të orientuara nga të rinjtë, që kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës për të rejtat dhe të rinjtë dhe që sigurojnë qasje novative dhe digjitale në informacionet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e punësimit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 rezultojnë rreth 16,860 punëkërkues të papunë të grupmoshës 15-29 vjeç të cilët janë përfshirë në programet aktive të tregut të punës. Numri më i lartë i të rinjve paraqitet në punësim dhe formim, ndërsa pjesëmarrja në programet e nxitjes së punësimit mbetet e kushtëzuar nga fondet në dispozicion për këto programe.

*(Pu.pa) 15-29 vjeç pjesëmarrës në Programet Aktive të Tregut të Punës*

Tabela 41

	Të Rinj Përfitues 2023	Total Përfitues	%
Punësim (nëpërmjet zyrave të punës)	9,340	27,651	34%
Nxitje Punësimi (PNP)	1,019	2,635	39%
Formim Profesional	6,501	10,547	62%

<b>Total PATP</b>	<b>16,860</b>	<b>40,833</b>	<b>41%</b>
-------------------	---------------	---------------	------------

AKPA nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit promovon në mënyrë të vazhdueshme rastet e suksesit të të rinjve që pas trajtimit me shërbime apo programe integrohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të suksesshme në tregun e punës apo orientohen drejt arsimit dhe formimit profesional. Gjatë vitit 2023 është realizuar publikimi/promovimi i 52 rasteve të suksesit të nxënësve që studiojnë në shkollat profesionale si dhe janë realizuar 53 video për promovimin e rasteve të suksesit të ndërmjetësimeve nga ana e Zyrrave të Punës apo të punësimeve nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.

Zbatimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm në shkollat profesionale (projekt në bashkëpunim me UNICEF)

AKPA në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri po starton projektin *"Zbatimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe të nxënës socio-emocional në shkollat e arsimit profesional për parandalimin e braktisjes së shkollës"*. Është zhvilluar event i lançues i projektit: Ngritja e sistemit parandalues për braktisjen dhe të nxënës socio - emocional në arsimin profesional.

Në vijim të eventit startues të këtij projekti, nga UNICEF Shqipëri në bashkëpunim me AKPA, u zhvilluan dhe trajnimi i parë, i ndarë në tre grupe:

Gjatë periudhës prill-qershor 2023 janë zhvilluar 2 sesione trajnuese me pjesëmarrjen e nëndrejtorëve, psikologut, punonjësit social, koordinatorit të orientimit të karrierës, koordinatorit të trajnimit të mësuesve, koordinatorit të gjurmimit, si dhe përfaqësues nga administrata e konvikteve të shkollave të mesme profesionale.

Nëpërmjet analizimit të faktorëve të riskut, treguesve, do të ngrihet dhe zbatohet një sistem i parandalimit të hershëm të braktisjes së shkollave, nëpërmjet ngritjes së grupeve të punës, ku çdo person përgjegjës do të ketë rol të përcaktuar dhe do të kontribuojnë në parandalimin e këtij fenomeni.

Gjithashtu, në kuadër të Thirrjes së Tretë për projekt-propozime, Agjencia Kombëtare e Rinisë është duke mbështetur me grant Shoqatën "AGRI-EN" e cila do të implementojë projektin *"Punësimi i të rinjve në zonat malore është sfidë dhe mundësi"*. Nëpërmjet këtij projekti, ndër të tjera synohet dhe trajnimi dhe rritja e kapaciteteve e 50 të rinjve nga Bashkitë Librazhd, Prrenjas dhe Elbasan në tema si: Motivimi në bujqësi, vetëpunësim, gjenerimi i të ardhurave, rritja e aftësive komunikuese dhe digjitale, etj.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në kuadër të promovimit të programeve dhe informimit të të rinjve rreth tyre ka organizuar dhe aktivitete të tjera si më poshtë vijon:

- Në datë 23 Shtator 2023 zhvillohet në Sarandë Panairi i Rinisë, Arsimit dhe Edukimit duke u informuar rreth mundësive për arsimin, trajnime dhe punësim për të rinjtë, në përputhje me profesionet, dëshirat dhe kërkesat e tregut dhe të ndërthurura me promovimin e vlerave turistike dhe kulturore të Sarandës.

- Në datë 23 Tetor 2023 zhvillohet panair për të rinjtë në çdo qark – Edicioni Vlorë. Më të rinjtë e qytetit të Vlorës të cilët patën mundësi të eksploronin të gjitha mundësitë lokale për të rinjtë, për arsim, trajnim dhe punësim, të prezantuara këto nga 30 aktorë që ofrojnë shërbime për të rinjtë, si dhe mundësi kombëtare si: Programi i Kodimit, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës dhe Garancinë Rinore. Të rinjtë kuriozë dhe me dëshirë të madhe për tu zhvilluar akademikisht dhe profesionalisht, vizituan çdo stendë duke u informuar për fushat e tyre të interesit, për të ndjekur më tej mundësitë si dhe për ti ndarë ato me miqtë e tyre.
- Në datë 27 Tetor 2023 u zhvillua panair për të rinjtë në çdo qark – Edicioni Shkodër. Të rinjtë të Bashkisë Shkodër iu bashkuan Panairit të Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit, për tu informuar për mundësi lokale e kombëtare që i ndihmojnë për tu zhvilluar më tej. Më shumë se 30 institucione, biznese dhe organizata që ofrojnë shërbime për të rinjtë që u bashkuan në këtë panair, për të njohur të rinjtë me shërbimet e tyre dhe mundësi punësimi.
- Në datë Tetor 2023 u zhvillua panairi për të rinjtë në çdo qark – Edicioni në Tiranë u zhvillua Panairi i Guidës Studentore me qëllimin kryesor për të orientuar studentët me jetën studentore, duke krijuar kështu ura lidhëse me universitetet, me organizatat me ofruesit e shërbimeve për të rinjtë. Ky panair u përshëndet nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe Drejtoresha e Rinisë së bashkisë Tiranë.
- Në datë Nëntor 2023 u zhvillua panair për të rinjtë në çdo qark – Edicioni Korçë. U mbajt në Korçë Panairi i Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit me qëllim informimin e të rinjve për mundësitë për edukim, trajnim dhe punësim. Pjesë e panairit ishte dhe Kryetari i Bashkisë Korçë dhe biznese, organizata dhe universitete të ndryshme.
- Në datë Dhjetor 2023, MSHRF zhvilloi takimin me studentët në auditorin e Universitetit Metropolitan të Tiranës në kuadër të orientimit të karrierës. Studentët u njohën me programet që MSHRF ofron për ta në kuadër të SKR 22-29, si dhe morën përgjigje për pyetjet dhe problematikat që ata kanë hasur.
- Në datë Dhjetor 2023 “Under 30 (<30)” Në aktivitetin për rininë luajtën rol të rëndësishëm 110 ofruesit e shërbimeve për të rinjtë, në promovimin e gamës së gjerë të mundësive lokale dhe kombëtare të edukimit, trajnimit dhe punësimit për të rinjtë.
- Gjatë datave 8-10 Shtator 2023 u zhvillua Albania Code week Hackathon si pjesë e EU Code Week nga Komisioni Europian. Gjatë këtij aktiviteti u mbajtën 10 sfida në nivel kombëtar. 50 konkurrentë energjikë dhe plot pasion rreth teknologjisë punuan për zgjidhjen e disa sfidave në vendin tonë në fushën e arsimit, transportit, turizmit, mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit, monitorimin e ajrit, ujit dhe zjarreve.

## **Realizimi financiar**

Për këtë masë ka pasur angazhim të donatorëve që nuk është planifikuar gjatë hartimit të SKR 2022 – 2029. Ky fakt ka bërë që të mbyllet edhe hendeku financiar me bashkëpunimin e UNICEF dhe World Vision Albania, mbështetje nga BE etj.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 100%. Përsa i përket zërave specifike pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100%. Në këtë zë parashikohet fondi për video apo aktivitete të ndryshme nga AKPA dhe mbështetja e

UNICEF me projektin "Zbatimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe të nxënimit socio-emocional në shkollat e arsimit profesional për parandalimin e braktisjes së shkollës". Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Sipas planifikimit 21.5% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe 78.5% janë financuar nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

**Masa 2.3.4** Fuqizohen qasjet e integruara për të mbështetur të rinjtë që rrezikojnë lënien e parakohshme të shkollimit dhe pa mbështetje për shkollim në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit (Garancia Rinore dhe UNICEF).

Në bazë të rekomandimeve të ardhura nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020 për prezantimin e Skemës së Garancisë Rinore në Shqipëri me qëllim adresimin e inaktivitetit të të rinjve në Shqipëri, duke filluar nga viti 2033 ka filluar pilotimi i këtij programi. Në vijim të këtyre rekomandimeve, në vitin 2021-2022 u hartua Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024 në Shqipëri. Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore në Shqipëri u dizajnuar nga Grupi Ndërinstitucional dhe me mbështetje e Asistencës Teknike për Mbështetjen e Reformës në Politikën e Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional (SREPVET) dhe më pas nga Asistenca Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Reformave në Fushat e Përfshirjes Sociale në Shqipëri (EU4SI).

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore është në linjë të plotë me Pëllimin Evropian për të Drejtat Sociale, si dhe inkorporon rekomandimet e paraqitura nga Bashkimi Evropian.

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore është i integruar në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive të miratuar me Vendim Nr. 173, datë 24.3.2023 të Këshillit të Ministrave. Ky plan përcakton fazat dhe kontributin e institucioneve të ndryshme, për zhvillimin dhe koordinimin e politikave arsimore, të punësimit dhe ato sociale për të rinjtë, duke synuar heqjen e barrierave dhe krijimin e mundësive që të rinjtë të hyjnë në tregun e punës dhe të kenë një zhvillim të suksesshëm profesional.

Në zbatim të Planit të Garancisë Rinore dhe duke synuar diversifikimin e ofertave dedikuar target grupit të synuar, përkatësisht: të rinjtë 15-29 të cilët nuk janë të punësuar, nuk janë duke ndjekur një trajnim apo formim profesional dhe nuk janë duke ndjekur një cikël arsimor, u miratua një Program i ri Nxitjeje të Punësimit "*të Nxënimit në Vendin e Punës, sipas Skemës së Garancisë Rinore*". Programi i ri synon të zbatohet sipas skemës të garancisë rinore, realizohet me anë të kurseve 3 deri në 6-mujore të formimit profesional nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës dhe më pas punësimit për 6 (gjashtë) muaj të tjerë. Programi do të zbatohet për here të pare në 3 rajonet pilot të Garancisë Rinore.

Me qëllim nisjen e fazës pilot, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizuan planin e zbatimit të Fazës Pilot në tre bashki; përkatësisht në bashkinë Tiranë, Vlorë dhe Shkodër. Sipas rekomandimeve të Bashkimit Evropian, për përzgjedhjen e rajoneve për pilotimin e Garancisë Rinore, indikatorët që janë analizuar dhe konsideruar një set indikatorësh, si: hartëzimi i të rinjve, flukset e të rinjve; ekonomia rajonale;



mbulimi me institucione të arsimit dhe formimit profesional; eksperiencia në lëvrimin e masave aktive të tregut të punës, etj.

Plani i Zbatimi të Fazës Pilot të Garancisë Rinore në Shqipëri u nda dhe dakordësua nga Koordinatori Kombëtar në grupin teknik të skemës së Garancisë Rinore në muajin Tetor 2023 me qëllim lancimin dhe nisjen e zbatimit të Skemës. Kështu me datë 27 Tetor 2023, u lancua faza pilot e Garancisë Rinore me prezencën e përfaqësuesve të lartë të Delegacionit European në Shqipëri, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Shtetit të Fëmijëve dhe Rinisë, si dhe partnerëve të tjerë si ILO, EU4SI, UNICEF, etc.

Me qëllim zbatimin në bashkitë Pilot të Garancisë Rinore, Agjencia Kombëtare e Punësimit gjatë vitit 2023 ka realizuar:

- a) Ndërtimi i procedurës për zbatimin e Skemës së Garancisë Rinore në Shqipëri dhe instrumenteve për monitorimin dhe raportimin e të dhënave lidhur me zbatimin e Skemës,
- b) Trajnimi i stafit të zyrave të punës, qendrave të formimit dhe shkollave profesionale për zbatimin e fazës pilot të Garancisë Rinore në tre bashkitë pilot,
- c) Realizimi dhe dakordësim i planit të pilotimit të Garancisë Rinore në Shqipëri në Grupin Teknik të drejtuar nga Koordinatori Kombëtar i GR-së (me mbështetjen e TA EU4SI),
- d) Lancimi i Garancisë Rinore 27 tetor 2023,
- e) Dizenjimi dhe kalimi live i shërbimit të Garancisë Rinore në portalin qeveritar e-Albania,
- f) Miratimi i paketës rregullatore të PNP së re 264, të Nxënimit në Vendin e Punës për zbatim në 2024 dhe përgatitjet për trajnimin e stafit brenda muajit Shkurt 2024,
- g) Shpallja e 3 programeve të Nxitjes së Punësimit brenda muajit nëntor për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme të ofertës ndaj të rinjve brenda vitit 2023,
- h) Krijimi i Skedës në Sistemin informatik për monitorimin e Skemës dhe dizenjimi i nënmodulit të Garancisë Rinore,
- i) Promovimi dhe informimi i punëdhënësve dhe të rinjve të targetuar në 3 rajonet pilot të Garancisë Rinore, me qëllim rritjen e angazhimit të tyre në skemën e Garancisë Rinore, përmes punësimit dhe pjesëmarrjes në programet e nxitjes së punësimit.

Target grupi i synuar për tu trajtuar gjatë fazës pilot të Garancisë Rinore janë të paktën 200 të rinj, që plotësojnë kriteret e paracaktuara.

### **Realizimi financiar**

Për këtë masë, aktivitetet që do realizoheshin ishin bazuar tek vënia në zbatim e Garancisë Rinore. Por, siç shpjegohet edhe më sipër, Garancia Rinore filloi të zbatohet vetëm në fund të 2023.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 50%. Përsa i përket zërave specifike, nuk janë parashikuar shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 50%. Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale. Sipas planifikimit 100% e fondeve të realizuara janë të financuara nga donatorët.


Si konkluzion mund të thuhet se është **është masë pjesërisht e realizuar**.

### **Përmbledhje për objektivin specifik 2.3.**

#### **Realizimi financiar**

Realizimi i 2 masave në bazë të analizës financiare do të detajohet në vazhdim dhe grafiku më poshtë jep raportin e masave të realizuara me ato pjesërisht të realizuara

Tabela 42  
Statusi i realizimit të masave të Objektivit 2.3



### **QËLLIMI POLITIK III**

#### **Mirëqenia dhe Përfshirja**

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Qëllimi i Politikave III, ka në përmbajtje të tij 3 Objektiva Specifikë dhe 15 Masa, nga të cilat 13 masa fillojnë zbatimin e tyre gjatë periudhës raportuese. Ky qëllim politik zërthehet në masa që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e të rinjve, duke përfshirë dhe hapësirën digjitale, gjithëpërfshirjen, tolerancën dhe të drejtat e njeriut dhe të pakicave, mirëqenien dhe shërbimet miqësore, shëndetin mendor dhe psikologjik, shëndetin riprodhues, programet e strehimit dhe hapësirave publike për të rinjtë.

#### **Përmbledhje për Qëllimin Politik 3**


Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik.

#### **Realizimi financiar**

Realizimi i 13 masave në bazë të analizës financiare për të tre objektivat e qëllimit të tretë është si në grafikun e mëposhtëm

Tabela 43

## Realizimi Qëllimi III i SKR për vitin 2023




Për këtë qëllim politike dhe dy qëllimet e mëtejshme është analizuar edhe realizimi nga ana financiare dhe rezulton se zëra të ndryshëm të shpenzimeve kanë nivel realizimi të ndryshëm.

**Kështu realizimi i fondeve totale është 78%.** Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 99.8%.

Tabela 44


## Realizimi Qëllimi 3 dhe tre objektivat



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 77.2%, ndërkohë shpenzimet kapitale nuk ka të planifikuara për këtë qëllim. Rreth 94% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit dhe vetëm rreth 6% janë fonde të mbuluara nga donatorët.

Tabela 45

## Realizimi Qëllimi III dhe tre objektivat



Në të gjitha masat e planifikuara për të tre objektivat nuk ka shpenzime kapitale të planifikuara. Gjithashtu, në siç detajohet për çdo masë, ka pasur një përfshirje të donatorëve për fushatat promovuese por edhe për mbështetje të organizatave. Për këtë arsye vërehet një reduktim i hendekut financiar me 67%.


Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik. Gjithashtu jepet informacioni në lidhje me shkallën e realizimit nga ana financiare për secilin nga objektivat dhe masat përkatëse.

**Objektivi specifik 3.1. Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale.**

Në vitin 2023 ka vazhduar apo filluar realizimi i 6 nga 7 masat e planifikuara. Realizimi i fondeve totale është 68%. Kurse përse i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 98%.

Tabela 46

## Realizimi Objektivi 3.1 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 67%, ndërkohë për masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 3.1.1 Bashkërendohet zbatimi i strategjive dhe programeve Kombëtare të Mbrojtjes dhe Sigurisë me një fokus të veçantë tek prezenca virtuale e të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta, krimi kibernetik dhe bullizmi online (digjital).**

Më 20 Nëntor 2023 MSHRF së bashku me CRCA Shqipëri dhe ALO 116-111 nënshkruan “Paktin Kombëtar Kundër Dhunës Seksuale ndaj Fëmijëve në Shqipëri” për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve në platforma online ku janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme.

Në 21 Nëntor, në kuadër të Ditës Botërore të Fëmijëve, MSHMS, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, AKCESK, Qendra Tumo e Edukimit të Inovacionit dhe Teknologjisë për të rinjtë, organizuan një aktivitet sensibilizues për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me fokus mbrojtjen e tyre në mjedisin digjital.

Lidhur me sesionet informuese mbi programet për sigurinë në internet nga institucionet e varësisë së MAS janë zhvilluar aktivitetet si më poshtë vijon:

1. ASCAP ka zhvilluar trajnime në 10 shkolla ku kanë marrë pjesë rreth 150 mësues të ciklit të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë, lidhur mbi "Edukimin për Median dhe Informimin". Përveç njohurive të marra rreth botës së medias dhe informimit, janë diskutuar çështje të rëndësishme të cilat lidhen me sfidat dhe rreziqet në botën virtuale dhe ofrimin e këshillave për të rinjtë;
2. ASCAP ka hartuar "Manualin për sigurinë në internet", një material i cili ofron një paketë udhëzimesh dhe këshillash lidhur me promovimin e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt dhe efektive nga ana e nxënësve dhe mësuesëve. Ky material është publikuar në faqen zyrtare të ASCAP, si dhe është ndarë me mësues drejtues rrjetesh dhe qendra rinore;
3. Janë organizuar sesione ku gjatë diskutimeve (pyetjesh-përgjigjesh) për të rinjtë, prindërit dhe punonjësit e arsimit kanë sjellë përvojat personale dhe kanë ndarë këshilla për të mbrojtur veten në internet;
4. Ndërgjegjësimi i komunitetit: Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit të komunitetit rreth rrezikut të sigurisë në internet dhe mënyrave për të promovuar përdorimin e internetit në mënyrë të sigurtë dhe të ndërgjegjshme. Këto fushata kanë përfshirë takime komunitare, fushata sensibilizuese dhe aktivitete informuese;
5. Policia e shtetit ka zhvilluar takime me nxënësit e gjimnazit, dhe 9- vjeçare për rreziqet në internet dhe për bullizmin, nëpërmjet të cilës janë informuar nxënësit ku të drejtohen dhe gatishmërinë e tyre në raste të sulmeve kibernetike apo shantazheve online;
6. Takime me qeverinë e nxënësve nga Shërbimi Psiko-Social, me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm (të fushës së arsimit dhe lokalë) me tematika si: *“Problemet që hasen në klasë dhe adresimi i tyre”*, *“Marrëdhëniet mësues-nxënës dhe përhapja e fenomenit të bullizmit”*, *“Agresiviteti, baza shoqërore dhe gjenetike e tij”*, *“Zhvillimi emocional në fëmijëri”*, *“Normat sociale dhe sjelljet antisociale”*, etj.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kuadër të kësaj mase dhe në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), kanë krijuar një faqe

të posaçme për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme gjatë shfletimit në internet<sup>27</sup>. Ky shërbim synon të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të raportojnë lidhje të paligjshme/të dëmshme, që hasen gjatë shfletimit në internet. Raportimet trajtohen me konfidencialitet të plotë nga autoritetet përgjegjëse për të ndërmarrë veprimet e duhura, si dhe për të marrë masa të menjëhershme ndaj këtyre përmbajtjeve.

Në faqen zyrtare të MAS-it, dhe institucioneve vartëse të saj, që lidhen me portalin online [www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al) të AKCESK-ut, është vënë në funksion shërbimi “*Raportoni përmbajtje të paligjshme*”, për bllokimin e aksesit në faqet e internetit me përmbajtje të paligjshme.

Nga ISHP, realizohet promovimi i sjelljeve të shëndetshme, si aktiviteti fizik, praktikimi i një jetese të shëndetshme, mirushqyerja etj.


Marrja e hapave për zbatimin e mëtejshëm të kësaj mase do të shtrihet në gjithë periudhën e parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Rinisë.

### Realizimi financiar

Për këtë masë ka pasur angazhim të donatorëve që nuk është planifikuar gjatë hartimit të SKR 2022 – 2029 dhe janë kryer shumë më tepër aktivitete sesa janë parashikuar. Pra hendeku financiar mbulohet nga shpenzimet e bëra. Gjithashtu, këtu është vendosur edhe një fond nga donatorët. AKCESK ka rreth 160,000,000 lekë investime për sistemet që nuk janë planifikuar në fondet e masës.

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është 88%. Përsa i përket zërave specifike pagat dhe sigurimet shoqërore kanë një realizim prej 100% dhe shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 85%.

Tabela 47  
Realizimi Masa 3.1.1 i SKR për vitin 2023



I vetmi aktivitet që nuk është realizuar është ai i përdorimit të portalit “Të rinjtë për të rinjtë”. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kuadër të kësaj mase dhe në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), kanë krijuar një faqe

<sup>27</sup> <https://cesk.gov.al/raporto/>

të posaçme për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme gjatë shfletimit në internet. Ky fakt, bën që të përfshihen shpenzimet e mirëmbajtjes. Por për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale. Pra mund të thuhet se ky zë ka mbi realizim dhe në përgjithësi të gjitha aktivitetet e masës kanë qenë të mirë financuara.

Sipas planifikimit 70% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe 30% janë financuar nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

**Masa 3.1.2** Fuqizohen programet që trajtojnë çështjet e rreziqet e sigurisë, me të cilat përballen të rejtat dhe të rinjtë e trafikuar, rreziqet e formave të ndryshme të krimit dhe, parandalimi dhe luftimi i dhunës seksuale me bazë gjinore dhe dhunës nga partneri ndaj grave të reja dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore/të rinjve.

Në kuadër të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është institucion kontribuues në hartimin e Planit të Ri të Veprimit 2024-2026 për këtë Strategji, me në krye Ministrinë e Brendshme.

Gjithashtu, në kuadër të zhvillimit të fushatave të komunikimit dhe ndërgjegjësimit, prej vitesh zbatohet Programi “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”, në shkollat 9 –vjeçare.


Në një vit shkollor ky program zbatohet në 860 shkolla, prej të cilave 802 shkolla publike dhe 58 shkolla jo-publike, dhe përfitues janë rreth 23.000 nxënës.

Ndihmës Specialistë të Policimit në Komunitet janë gati për zhvillimin e këtij Programi gjatë vitit akademik 2023-2024, me temë “*Alkooli, Duhani, Droga dhe substanca të tjera të rrezikshme*”.

### **Realizimi financiar**

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është 36%. Përsa i përket zërave specifike pagat dhe sigurimet shoqërore kanë një realizim prej 100% madje me vendimmarrjen e fundit të qeverisë për vitin shkollor 2023 - 2024 për masat e sigurisë në shkolla mund të thuhet se shpenzimet në paga janë më të larta se ato të parashikuara. Pra ka mbi realizim të këtij zëri.

## Realizimi Masa 3.1.2 i SKR për vitin 2023



Shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 35%. Si aktivitete të porealizuara mund të konsiderohen Raporti monitorues i realizimit të dispozitave ligjore apo forumet që do organizohen dhe këto ishin planifikuar të mbulohen nga donatorët. Policimi në komunitet dhe masat e marra praktikisht nënkupton këtë. Pra mund të quhen si aktivitete të realizuara. Nga ana tjetër nuk janë realizuar aktivitetet që ishte planifikuar që të realizoheshin duke përdorur portalin “Të rinjtë për të rinjtë”. Por për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Sipas planifikimit 70% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe 30% janë financuar nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar.**

**Masa 3.1.3.** Fuqizohen programet që u mundësojnë të rinjve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat "strategjitë e daljes".

### **3.1.3 Mase e paraportuar.**

Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) u krijua si rezultat i një sërë masash që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë për të trajtuar shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm tek shtetasit shqiptarë që u bashkuan në radhët e organizatave ekstremiste në konfliktet në Lindjen e Mesme vitet e fundit, duke përfshirë të ashtuquajturin Shtet Islamik në Siri dhe Irak (ISIS). Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Plani i Veprimit 2023-2025 është miratuar me VKM Nr. 81, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023-2025” dhe Planeve të Veprimit 2023-2025, e cila parashikon përfshirjen e aktorëve kryesorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke promovuar vlerat demokratike dhe adresimin e shqetësimeve në nivel lokal që mund të nxisin radikalizimin.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në bashkëpunim me Prefekturën e Tiranës ngritën Komitetin Rajonal për Parandalimin e Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, me një grup të gjerë aktorësh siç përshkruhet në Urdhrin nr. 185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit, duke demonstruar një qasje të unifikuar drejt adresimit të sfidave të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Formimi i Komitetit nënvizon angazhimin e qeverisë për të nxitur një mjedis bashkëpunimi, duke bashkuar përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë aktorë të



zbatimit të ligjit si policia vendore, shërbimi i provës, policia kufitare, shërbimet sociale, punësimi, shëndetësia dhe arsimi.

QKEDH më datë 07 nëntor 2023, nëshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës me qëllim Parandalimin e Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm. Profesorati i Fakultetit të Drejtësisë gëzon kapacitetin e nevojshëm për të kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit mbi format e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe promovimin tek studentët të vlerave të tolerancës, paqes dhe bashkëjetesës së komuniteteve me diversitet kulturor, etnik, fetar etj; njohjen dhe formimin profesional të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit, psikologut, punonjësit social, juristit, administratës publike, gazetarisë, përmes gjetjeve të veprimtarive kërkimore-shkencore, mbi identifikimin e individëve dhe faktorët që nxisin radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në komunitet; praktikave studentore si dhe intershipe pranë QKEDH-së etj.

Marrëveshja e bashkëpunimit e firmosur në nëntor të vitit 2023, është e disata në vazhden e marrëveshjeve me anë të së cilave Qendra CVE, synon të rrisë ndërgjegjësimin në kuadër të realizimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Plani i Veprimit 2023-2025.

Gjithashtu, më datë 26.04.2023, në mjediset e Rektoratit të Korcës u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Universitetit “Fan S. Noli” dhe Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, “Universitetet, fronti i ri i CVE- konsolidimi dhe zgjerimi i përfshirjes së arsimit universitar në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm”. Qëllimi i marrëveshjes së bashkëpunimit është realizimi i veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, për menaxhimin e procesit të rikthimit shtetasve shqiptarë nga ish vendet e konfliktit, angazhimin institucional të të gjithë aktorëve shtetërorë të përfshirë në këtë proces, si dhe sfidat e hasura në këtë drejtim.

Në datën 30 Janar 2023, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Fondacioni Vodafone Albania zhvilluan një trajnimin me specialistë të fushës si dhe aktorët e vijës së parë të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, konkretisht me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve të Njërive Administrative të Tiranës si dhe punonjës të Qendrës CVE mbi aplikacionin “Bright Sky”. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit që Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka me aktorët në sektorin privat në përmbushje të misionit të saj. Qëllimi i këtij trajnimi ishte për të diskutuar mbi përdorimin e aplikacionit të “Bright Sky” të zhvilluar nga fondacioni “Vodafone Albania”. Bright Sky është një aplikacion pa pagesë i cili jep mbështetje dhe informacion çdokujt që mund të ndodhet në një marrëdhënie abuzive, apo atyre që janë të shqetësuar për dikë që mund të ndodhet në një marrëdhënie të tillë. Aplikacioni u mundëson përdoruesve jo vetëm këshillim dhe informacion por gjithashtu edhe qendrën me të afërt për mbështetje.

Shqipëria ka treguar sukses në proceset e rehabilitimit dhe ririntegritimit të shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria dhe Iraku. Përmes përpjekjeve të koordinuara dhe të përbashkëta nga institucionet relevante dhe me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, Shqipëria ka arritur të kthejë individët e radikalizuar në shoqërinë dhe jetën normale. Suksesi i Shqipërisë në këtë aspekt tregon se me angazhim, bashkëpunim dhe strategji të mirë koordinuar, është e mundur të rehabilitohen dhe ririntegrohen individët që janë angazhuar në organizata ekstremiste në vende të konfliktit.

Me mbështjetjen e GCERF, Qendra Kundër Ektremizmit të Dhunshëm, po punon për ngritjen e një qendre kombëtare multidisiplinore që do të shërbejë për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve nga të gjithë aktorët dhe institucionet e përfshira për shtetasit shqiptar të kthyer nga zonat e konfliktit si Siri dhe Irak si dhe për grupet e tjera vulnerable kundrejt formave të tjera të dhunës.

**Masa 3.1.5** Përmirësohen me qasje specifike rinore, miqësore dhe të pranueshme, programet që trajtojnë migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore me në fokus parandalimin e këtyre fenomeneve dhe kthimin e të rinjve në shkollë, trajnim ose punë.

Ministria e Brendshme ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2024-2026, i cili është përgatitur në vijim të strategjisë kombëtare për migracionin 2019-2022, që përfundoi afatin e zbatimit në dhjetor 2022.

Vizioni për migracionin është që deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integritit të Shqipërisë në BE, të jepet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit”.

Në linjë me këtë vizion, objektivi kryesor strategjik është “Qeverisja efektive e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problemeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet e migrantëve, me synim rritjen e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit, në dobi të emigrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.

Qeveria shqiptare synon të realizojë objektivin kryesor strategjik duke u fokusuar në tre qëllime kryesore politike: Garantimin e qeverisjes strategjike të migracionit, zhvillimin e politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal, si dhe promovimin e migracionit të rregullt, mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare.

### **Realizimi financiar**

Nuk ka informacion për veprime specifike.

Mund të thuhet se është masë e porealizuar.

**Masa 3.1.6** Fuqizohen programet rinore që fokusohen në të drejtat e njeriut dhe të pakicave, antikorrupsionin, barazinë gjinore, pranimit të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm.

Në thirrjen e dytë për projekte rinore, AKR-ja ka mbështetur 24 organizata dhe 5 Bashki dhe projektet e tyre përkatëse ndër të cilat, dy projekte kanë patur në fokus ndërgjegjësimin kundër dhunës me bazë gjinore.

1. Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” është duke implementuar projektin: *“Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit”*.

Përfituesit direkt të projektit janë 37 gra dhe vajza, viktimat e abuzimit, trafikimit dhe dhunës, kanë përfunduar me sukses ciklin e trajnimeve rehabilituese nëpërmjet programit të dedikuar. Cikli i trajnimeve ka ndihmuar vajzat dhe gratë pjesëmarrëse në zvogëlimin e

ndikimit të traumës, rindërtimin e ndjenjave të sigurisë dhe kontrollit, rritjen e përshtatjes psikologjike, menaxhimin e stresit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

2. Organizata “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza” është duke implementuar projektin: “*Angazhimi qytetar dhe edukimi i djemve dhe vajzave: Klubi “Bëhu Burrë”*”.

Janë organizuar 13 workshop-e duke tejkaluar numrin e propozuar për këtë kategori me 1 të tillë. Pjesëmarrja totale përgjatë implementimit të këtij projekti në të gjitha etapat e tij rezulton të jetë 303 të rinj, më e lartë se ajo e parashikuar (300). Kuotat e parashikuara gjinore 50:50 nuk janë arritur pasi vihet re një pjesëmarrje e 197 djemve (65%) dhe 106 vajzave (35%).

Gjithashtu, më datë 12 Dhjetor 2023 u zhvillua takimi tryezë të përbashkët me aktorë nga UNDP dhe UNFPA Albania, UN Women Albania dhe UNESCO në kuadër të projektit rajonal “*Rinia në përfshirje, barazi dhe besim*” u zhvillua takimi i radhës me bordin këshillimor për Shqipërinë ku në fokus të takimit ishin gjithë përfshirja, besimi, barazia, dialogu ndërkulturor, mbështetja e ofruar për gazetarët e rinj, menaxhimi i informacioneve që shpërndahen në media sociale dhe rëndësia e saktësisë së tyre, me qëllim minimizimin e gjuhës së urrejtjes. ”

Nga Thirrja e III-të për grante e AKR-së janë mbështetur gjithashtu:

- Organizata për Qendrën Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta e cila po implementon projektin “*Çelësi i Harmonisë*” ku do të përfshijë 120 të rinj të moshës 15-26 vjeç, nga Bashkia Elbasan, Bashkia Peqin, Bashkia Cërrik dhe 20 nga të cilët do të jenë të rinj me aftësi të kufizuara.
- Organizata Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve CRCA, e cila po implementon projektin “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*” që do të përfshijë rreth 2000 të rinj e të reja në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll, të paktën 200 të rinj e të reja nga grupet në nevojë, nga komuniteti Rom/Egjiptian, PAK, LGBTIQ+.
- Organizata Shoqata Studentore Sport Rekreacion po implementon projektin “*Adventure Sport & Mental and Physical Health in Youth*” ku do të aktivizoj 300 të rinj nga Tirana, 20 nxënës me status jetim, dhe 20 nxënës që i përkasin kategorisë Rome dhe Egjiptiane.

Aktivitete të tjera të organizuara nga MSHRF:

- Në 27 Korrik 2023 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi takimin me Znj. Elida Nuri nga UNFPA ku u diskutua mbi Thirrjen e Tretë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Për të mbështetur të rinjtë me programe për mirëqenien e tyre.
- Në 2 Gusht 2023 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një takim me Znj. Enkelejda Kallciu dhe Znj. Albana Izeti nga Terre des Homes në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, me fokus krijimin e programeve të parandalimit për fëmijët dhe të rinjve në konflikt me ligjin.

## **Realizimi financiar**

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 100%. Fondet për këtë janë pjesë e fondeve që AKR dhe MSHRF japin nëpërmjet thirrjeve dhe në vitet në vazhdim do shtohet edhe Garancia Rinore. Nuk janë realizuar takime me organizatat posaçërisht për këto tema. Por në aktivitetet e kryera është diskutuar edhe për këto tema. Në kuadër të thirrjeve të hapura nga AKR për projekt propozime, janë financuar disa organizata që kanë zbatuar apo zbatojnë projekte për elementë të ndryshëm që mbulohen nga masa. Përsa i përket zërave specifike nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100%. Në kostot e parashikuar nuk është përfshirë në kostim aktiviteti i donatorëve si UNDP, UNFPA, UNWOMEN që nëpërmjet thirrjeve të ndryshme fuqizojnë programet PBF

Sipas planifikimit 87% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe 13% janë financuar nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se është masë e realizuar.

### **Masa 3.1.7 Fuqizohen programet dhe aktivitetet rinore, që trajtojnë çështje në lidhje me format e ndryshme të diskriminimit kundrejt identiteteve socio-kulturore, fetare, seksuale dhe të tjera**

Mbështetja e aktiviteteve të organizatave rinore që punojnë kundër diskriminimit të çdo forme është një ndër arritjet në kuadër të zbatimit të kësaj mase.

Kështu, në përfundim të përzgjedhjes së projekteve fituese të Thirrjes së 2-të, të AKR-së, janë tre projekte, që përfshijnë komunitetin rom dhe egjiptian si më poshtë vijojnë:

- Qendra për Ekselencë Destiny – QED, me projektin “Rinia udhëheq mirëqenien-RUM” - Financuar në vlerën 3.042.200 lekë, i cili ka përfunduar zbatimin gjatë periudhës raportuese.

Projekti ka synuar të edukojë dhe ndërgjegjësojë, nëpërmjet metodave të edukimit jo-formal dhe orientimit në karrierë, të rinjtë për mbrojtjen e mjedisit dhe efektet që ka ndotja e tij në shëndet, të edukojë dhe ndërgjegjësojë të rinjtë për jetesën e shëndetshme, të ndërgjegjësojë të rinjtë rreth green jobs, punës në bujqësi dhe përfitimet që sjell, në rrethet Tepelenë, Berat dhe Korçë, duke pasur një fokus të veçantë dhe duke përfshirë grupet e marginalizuara, rom dhe egjiptian.

Janë trajnuar në total 170 të rinj nga 150 të rinj të parashikuar, nga të cilët 53% janë (90 vajza) dhe 47% (80 djem) dhe 20% e totalit të pjesëmarrësve kanë qenë nga komuniteti rom dhe egjiptian.

- Power of Education me projektin “*Super Youth*”, financuar në vlerën 2,346,500, i cili ka përfunduar zbatimin gjatë periudhës raportuese.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është këshillimi në karrierë dhe rritjen e kapaciteteve dhe mundësive për punësim tek të rinjtë në Bashkitë Durrës, Shkodër e Kamëz, përmes informimit mbi mundësitë e punësimit si freelance/nomad, krijimi i një komuniteti online si kanal informimi mbi mundësitë për bursa, konferenca etj. si dhe hartimi i një manuali mbi shkrimin e një plani biznesi. Ky projekt synon të informojë dhe trajtojë të rinjtë mbi vlerësimin e idesë së biznesit, analizë tregu

dhe industrie, format ligjore te shoqërive, aksesimi në grante dhe në financime, menaxhimi i burimeve financiare dhe njerëzore, hartimi i një biznes plani, si dhe i një plani marketing.

Janë impaktuar në total 147 të rinj nga të cilët 49 djem (33%) dhe 98 vajza(67%), duhet theksuar se mbizotëron prania e vajzave nëpër trajnime. Organizata në fjalë ka arritur numrin e propozuar të të rinjve të impaktuar, në mbi masën 100%. Është publikuar manuali për planin e Biznesit “Një Udhëzues Praktik për Planifikimin e Biznesit” dhe janë realizuar 3 plane biznesi nëpërmjet mentorimit.

- ANEI- Albanian Network for European Integration, me projektin “*Rinia-garanci për të ardhmen evropiane të vendit*”, financuar në vlerën 2,590,000 lekë, i cili ka përfunduar zbatimin gjatë periudhës raportuese.

Synimi kryesor i projektit është rritja e kapaciteteve të të rinjve, në bashkinë Vlorë dhe Fier, mbi përfitimet efektive nga mundësitë/instrumentet e financimit të BE-së, si dhe përgatitjen e tyre për tu përballur me tregun e punës. Janë hartuar dhe realizuar 3 module trajnimi: “*Si të përgatisim një jetëshkrim, një letër motivimi, një letër motivimi aplikim për lidhshmëri*”; “*Si të shkruajmë një projekt-propozim*”; “*Si të hartojmë një plan biznesi*” si edhe janë realizuar 10 ditë trajnimi në total sipas projekt-propozimit. Janë trajnuar për të gjitha modulet, 191 të rinj nga të cilët 76 djem dhe 115 vajza. Janë trajnuar 14 të rinj të komunitetit rom dhe egjiptian, më shumë se numri i propozuar në projekt-propozim që ka qenë 10. Numri fillestar i propozuar është arritur dhe tejkaluar.

Aktualisht janë në zbatim projektet e thirrjes së 3-të të AKR, 2 prej të cilave përfshijnë ndërgjegjësimin kundër diskriminimit dhe përfshijnë komunitetin rom dhe egjiptian, të cilat janë si më poshtë vijon:

- Organizata: “Qendra Youth Rise” - Titulli i projektit: “*Unlock Your technological Skills*” Qëllimi i këtij projekti: është krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë duke promovuar aftësitë inovative, digjitale dhe sipërmarrëse. Grupi i synuar i përfituesve direkt do të jetë 150 të rinjve nga të cilët 30% e pjesëmarrësve do të jenë nga grupet e marxhinalizuara.
- Organizata: “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA/ECPAT Shqipëri)” - Titulli i projektit: “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”. Qëllimi i këtij projekti: Qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll. Grupi i synuar i përfituesve direkt do të jetë të paktën 2000 të rinj e të reja në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll (të paktën 200 të rinj e të reja nga grupet në nevojë, nga komuniteti Rom/Egjiptian/PAK, LGBTI etj.) (50% je grupit të synuar janë vajza) përfitojnë shërbime të drejtpërdrejta të këshillimit, mbështetjes dhe fuqizimit, informacion në punësim, shkollim, biznes rinor, shërbime shoqërore dhe ato të shëndetit mendor në Qendrën Rinore me një Ndalesë;

Për të mbështetur aktivitetet e organizatave rinore që punojnë kundër diskriminimit të çdo forme, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

1. Seminare, workshop-e dhe trajnime për të rinjtë dhe për komunitetin për ndërgjegjësimin e tyre rreth formave të diskriminimit, shkaqeve dhe pasojave të tij, si dhe për të promovuar tolerancën dhe respektin ndaj diversitetit.

2. Fushata informuese dhe të ndërgjegjësuese në shkolla, qendra rinore dhe komunitete për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me diskriminimin dhe për të promovuar mesazhe pozitive të përfshirjes dhe barazisë. (takime me nxënës të arsimit të mesëm të lartë të IAP-ve, me të rinjtë e organizatave rinore pranë Bashkive, përfaqësues të Qendrës Multifunktionale, mësues, prindër, drejtues të IAP-ve, përfaqësues të Qendrës “Aleanca Gjimore për Zhvillim”);
3. Marshime, dhe aktivitete të tjera të aktivizmit për denoncimin e rasteve të diskriminimit, duke ngritur zërin për drejtësi dhe për të mbështetur viktimat e diskriminimit;
4. Organizimi mini-projekteve dhe workshop-eve për të rinjtë për të zhvilluar aftësitë e tyre në fushën e promovimit të barazisë, të drejtave të njeriut dhe luftës kundër diskriminimit. (Këto mini-projekte kanë përfshirë aktivitete si punët vullnetare në komunitet, organizimin e aktiviteteve për njohjen e kulturave të ndryshme, dhe promovimin e dialogut dhe mirëkuptimit (ZVAP-Lezhë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Kurbin, etj.).
5. Organizime kulturore dhe artistike për të promovuar dialogun ndërkulturor, për të ndërgjegjësuar për diversitetin kulturor dhe për të shfaqur ndryshimet pozitive në një mënyrë krijuese.
6. Ndërtimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit me organizata të tjera që punojnë për të njëjtin qëllim për të forcuar veprimtarinë dhe ndikimin në luftën kundër diskriminimit.

### **Realizimi financiar**

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 95%. Fondet për këtë janë pjesë e fondeve që AKR dhe MSHRF japin nëpërmjet thirrjeve dhe në vitet në vazhdim do shtohet edhe Garancia Rinore. Nuk janë realizuar takime me organizatat posaçërisht për këto tema. Por në aktivitetet e kryera është diskutuar edhe për këto tema. Në kuadër të thirrjeve të hapura nga AKR për projekt propozime, janë financuar disa organizata që kanë zbatuar apo zbatojnë projekte për elementë të ndryshëm që mbulohen nga masa. Përsa i përket zërave specifike nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100%. Në kostot e parashikuar nuk është përfshirë në kostim aktiviteti i donatorëve

Sipas planifikimit 100% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit

Si konkluzion mund të thuhet se është masë e realizuar


### **Përmbledhje për objektivin specifik 3.1**

#### **Realizimi financiar**

Realizimi i 6 masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë

Tabela 49

## Statusi i realizimit të masave të Objektivit 3.1




**Objektivi Specifik 3.2: Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale.**

Në vitin 2023 ka vazhduar apo filluar realizimi i të gjitha masave të planifikuara. Realizimi i fondeve totale është 87%. Kurse përsa i përket zërave specifikë mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%.

Tabela 50

## Realizimi Objektivit 3.2 i SKR për vitin 2023



Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 86%, ndërkohë për masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 3.2.1** Bashkërendohet Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030, Agjenda e Fëmijëve 2021 – 2026, planet e veprimtimit dhe strategjitë e tjera lidhur me to, me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, në veçanti promovimin e jetesës së shëndetshme.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë realizuar një sërë aktivitete në kuadër të zbatimit të objektivave të përbashkët të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, duke përfshirë këtu promovimin e sportit për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, panairë sportive, aktivitete të shumëllojshme që lidhen me promovimin e artit, kulturës lokale dhe kombëtare, mbështetjen e mirëqenies fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve, etj., në kuadër të thirrjeve për rininë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, etj.

Gjatë periudhës raportuese Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zhvilluar aktivitete sistematike në terren në 90 shkolla, në 9 qarqe të vendit. Gjithashtu, është realizuar edhe mbulimi me aktivitete online, ku janë përfshirë të gjithë shkollat, konkretisht rreth 1210 shkolla dhe mbi 200 000 fëmijë.

Më 23 Korrik 2023 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ishte pjesë e aktivitetit të Special Olympics Albania në edicionin e tretë të lojërave të “Eja luajmë në pazar”, ku sheshi i pazarit ishte i hapur për fëmijët, të cilëve nën kujdesin e trajnerëve u ofroheshin lojra nga më të ndryshmet si joga, futboll, basketboll, badminton, pa harruar dhe mesazhin kryesor “sport për të gjithë”.

Më 29 Nëntor 2023 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Znj. Bora Muzhaqi dhe Kryeministri Z. Edi Rama ishin pjesë e Thumana në lëvizje: Sport për një të nesërme më të mirë. Rilindja e Thumanës dhe kthimi i saj në një epiqendër sportive me panelet e diskutimit, panairin sportiv, dhe koncertin ishin pjesë e programit “Sporti për Zhvillim”.

Organizata “Multifunctional Culture Center A.M – SWANS” ka implementuar me sukses projektin: “*We are all made of stars 2*” me fushë përparësie. Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve. Numri i të rinjve të angazhuar në audicione është 1662 të rinj (827 vajza dhe 835 djem). Trupat artistike janë krijuar në secilin qytet të parashikuar duke rezultuar në një shfaqje gala me 208 të rinj.

Organizata Shoqata “Mega Art” ka implementuar me sukses projektin: “*E Para është Vallja*” me fushë përparësie: Mbështetja e Mirëqenies aktive, të shëndetshëm, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve. Janë përfshirë rreth 200 të rinj nga 12 rrethe të Shqipërisë (Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Korçë, Vlorë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë).

Organizata “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve” ka implementuar projektin: “*Dy të premtë në muaj janë RINI*” me fushë përparësie: Mbështetja e Mirëqenies aktive, të shëndetshëm, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve. Në fazën e parë të zbatimit janë zhvilluar takime me 100 të rinj në qytetin e Tiranës, të cilët janë përfshirë në aktivitete arti dhe lojërash sportive si dhe trajnime mbi lidhshmërinë dhe komunikimin publik. (Fazë raporti përfundimtar)

Organizata “Qendra për Ekselencë Destiny/ QED” ka implementuar projektin: “*Rinia udhëheq mirëqenien-RUM*” me fushë përparësie: Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshëm, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve. Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlihdhjes së të rinjve me tregun e punës. Janë impaktuar 170 të rinj (90 vajza dhe 80 djem) të cilët janë trajnuar për mbrojtjen e mjedisit, ndryshimet klimatike, riciklimi, dëmet nga plastika, menaxhimi i mbetjeve,



ndërgjegjësimi mbi elementët e jetesës së shëndetshme, dietat e balancuara, aktiviteti fizik, për të drejtën e konsumatorit dhe fondet e IPARD.

## **Realizimi financiar**

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 65% pasi këtu është planifikuar një komponent nga fondi i Arte Zeje. Gjithashtu, edhe nga raportimi i mësipërm mund të thuhet se janë realizuar shumë aktivitete.

Përsa i përket zërave specifike për këtë masë nuk janë parashikuar shpenzime në zërat pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 94%. Në kostot e parashikuar nuk është përfshirë në kostim aktiviteti i organizatave fituese të thirrjes së tretë të AKR pasi ato fonde janë përfshirë në kostot e masave të mëparshme.

Sipas planifikimit 100% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se është masë e realizuar.

### **Masa 3.2.2 Zhvillohen qasje të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore, të cilat marrin në konsideratë tranzicionin nga strukturat dhe shërbimet mjekësore për fëmijë te ato për të rriturit (nevoja për të zhvilluar standarde miqësore për të rinjtë).**

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është pjesë e Grupit Tematik “Për Mbrojtjen Sociale| si dhe Grupit Tematik “Për Grupet e Margjinalizuara”, të ngritura në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2023-2030, e cila është konsultuar me mbi 360 të rinj përmes platformës U-report, të cilët kanë ndarë mendimet dhe opinionet e tyre për Strategjinë.

Në këtë kuadër Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë organizuar një sërë aktivitete promovionale në zbatim të pikave të ndërlidhjes së Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026.

Në kuadër të thirrjes së II të AKR:

- Organizata “Qendra ABC Tirana Club” ka implementuar projektin: “*Qyteti im Evropian, Edicioni IV*” me fushë përparësie: Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshëm, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve. Janë trajnuar rreth 70 të rinj nga Bashkia Mat, Bashkia Tepelenë dhe Bashkia Tiranë.
- Organizata “Albanian Committee of Medical Students (ACMS)” ka implementuar projektin: “*Youth for Mental Health*” me fushë përparësie: Mbështetja e Mirëqenies aktive, të shëndetshëm, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve. Janë impaktuar 662 të rinj

(326 vajza dhe 336 djem), nëpërmjet shkollës dimërore në Kamëz dhe në Fier me titull “Unë dhe shëndeti mendor”.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zhvilluar aktivitete sistematike mbi sjelljet e shëndetshme, të cilat kanë trajtuar tema të tilla si këshillimi për duhanin, alkoolin, drogat, seksin e sigurtë etj., me përfshirjen e të rinjve dhe profesionistëve të kujdesit parësor. Mbi 100 aktivitete ne vit të raportuara.

### **Realizimi financiar**

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 66%. Fondet për këtë janë pjesë e fondeve që AKR dhe MSHRF japin nëpërmjet thirrjeve dhe gjithashtu fonde të AMSHC. Në kuadër të thirrjeve të hapura nga AKR për projekt propozime, janë financuar disa organizata që kanë zbatuar apo zbatojnë projekte për elementë të ndryshëm që mbulohen nga masa. Përsa i përket zërave specifikë nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 66% pasi në kostot e parashikuar nuk është përfshirë në kostim aktiviteti i donatorëve, fondet e dhëna nga AKR (janë në masë tjetër).

Sipas planifikimit 100% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar.**

**Masa 3.2.3 Zhvillohen shërbime të reja dhe forcohen ato ekzistuese nëpër shkolla me cilësi të garantuar për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik, si edhe mbështeten shërbimet online të shëndetit mendor në platformën për rininë (të rinjtë për të rinjtë) 2023-2029.**

Në kuadër të thirrjes së II të AKR:

- Organizata “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza” ka implementuar projektin: “*Angazhimi qytetar dhe edukimi i djemve dhe vajzave: Klubi Bëhu Burrë*” me fushë përparësie: Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve. Numri total rezulton të jetë 303 të rinj (197 djem dhe 106 vajza) të përfshirë në projekt. Në lidhje me ndërhyrjet e propozuara për ngritje kapacitetesh në kauza qytetare dhe sociale respektivisht në Tiranë, Devoll dhe Bulqizë janë realizuar në total 4 të tilla me pjesëmarrjen e 49 profesionistëve (staf shëndetësie, psikologe, mësuese, etj.).

Nën koordinimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me stafin e QKSHM janë zhvilluar takime ndërjegjësuëse mbi nevojat e shëndetit mendor të të rinjve, me përfaqësues të qendrave komunitare si dhe me psikologë të shkollave publike.

### **Realizimi financiar**

Janë përgatitur materiale informative dhe është organizuar trajnim për profesionistët shëndetësor të shkollave, ku janë përfshirë mbi 12 module, mes të cilave është edhe shëndeti mendor i të rinjve. 60 mjekë shkollash janë trajnuar gjatë periudhës raportuese sipas MSHMS.

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 100%. Përsa i përket zërave specifike nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore por janë përgatitur materiale informative dhe janë organizuar trajnime, pra praktikisht janë kryer aktivitetet e planifikuara për 2024. Kështu që ky zë njihet me realizim 100%. Shpenzimet kapitale nuk janë parashikuar. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100% pasi në këtë masë janë aplikuar financime të WHO dhe UNFPA. Edhe ky zë mund të thuhet se ka mbi realizim pasi janë realizuar aktivitete që ishin planifikuar në 2024.

Sipas planifikimit pjesa më e madhe e fondeve të realizuara janë fonde të financuara nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

**Masa 3.2.4 Sigurohet pranimi i të rinjve në shërbimet e duhura të parandalimit dhe promovimit sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese 2022 - 2030, për të siguruar që të rinjtë që jetojnë në Shqipëri marrin edukim / informacione të përgjithshme në formë të pranueshme dhe miqësore ndaj tyre 2023-2029.**

Janë shpërndarë materiale informative dhe është organizuar trajnim për profesionistët shëndetësor të shkollave, ku janë përfshirë mbi 12 module, mes të cilave është edhe shëndeti riprodhues i të rinjve. Gjithashtu, janë promovuar materiale informuese për HPV dhe janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese me të rinjtë në shkolla, me qëllim informimin për HPV.

Gjatë periudhës raportuese, ekspertët të ASCAP dhe ISHP kanë shpërndarë manualin mbështetës për stafin psikosocial në shkolla, mbi diskutimin për çështje të shëndetit mendor me nxënësit, ku është përfshirë dhe një kapitull mbi imazhin trupor dhe udhëzime mbi zhvillimin e ushtrimeve në klasë për rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi imazhin pozitiv trupor.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese:

- janë realizuar trajnime me staf nga QKSHM mbi shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve.
- ISHP ka marrë pjesë në sesione ndërgjegjësuese për shëndetin mendor me të rinj që ndjekin shkollën, ku janë trajtuar dhe çështje të lidhura me imazhin trupor.
- ISHP lancon nëpërmjet rrjeteve sociale mesazhe për promovimin e shëndetit mendor pozitiv, duke përfshirë edhe qëndrimin ndaj imazhit fizik.

### **Realizimi financiar**

Janë përgatitur materiale informative dhe është organizuar trajnim për profesionistët shëndetësor të shkollave, ku janë përfshirë mbi 12 module, mes të cilave është edhe shëndeti mendor i të rinjve. 60 mjekë shkollash janë trajnuar gjatë periudhës raportuese sipas MSHMS

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 100%. Përsa i përket zërave specifike nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100% pasi janë përgatitur materiale dhe janë organizuar trajnime

Sipas planifikimit pjesa më e madhe e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

**Masa 3.2.5** Propozohen dhe zhvillohen veprimtari në lidhje me sjelljen e rrezikshme dhe konsumin e drogës duke siguruar që të rinjtë marrin informacione dhe edukim tërësor. Sigurohet që të rinjtë kanë akses në ndërhyrjet e duhura parandaluese dhe shërbimet e trajtimit të varësisë 2023-2029.

Janë zhvilluar sesione informuese dhe aktivitete interaktive me nxënësit mbi ndikimin e duhanit, alkoolit dhe substancave të tjera të paligjshme dhe rritja e aftësive të të rinjve për të refuzuar duhanin, alkoolin dhe drogat. Gjithashtu:

- ISHP organizon takime të shpeshta me specialistët e promovimit shëndetësor, ku trajtohen çështje të sjelljeve të rrezikshme.
- Janë organizuar workshope rajonale ku janë ndarë gjetjet e studimit të HBSC në nivel rajonal.

### Realizimi financiar


Nga raportimi i ISHP janë përgatitur 12 module trajnimi që ofrohen.

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 100%. Përsa i përket zërave specifike janë parashikuar vetëm pagat dhe sigurimet shoqërore dhe janë realizuar 100%

Sipas planifikimit 100% e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

**Përmbledhje për objektivin specifik 3.2** Realizimi i 5 masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë:



***Objektivi Specifik 3.3: Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimi në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.***

Në vitin 2023 ka vazhduar apo filluar realizimi i të gjitha masave të planifikuara. Në 3 masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime në zërat paga dhe sigurime shoqërore dhe shpenzime kapitale. Realizimi i fondeve totale është 100%. Kurse përsa i përket zërave specifikë mund të thuhet se Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca, niveli i realizimit është 100%.

Hendeku financiar faktik i këtij objektivi është 0 nga 2 milion lekë që ishte i hendeku financiar i planifikuar.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

**Masa 3.3.1 Mbështetet ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë, me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi, edhe në kohën e lirë.**

Nëpërmjet Thirrjes Publike nr. 2, shpallur më 22 Gusht 2022, nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, janë mbështetur financiarisht Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në ndërtim apo rikonstruksion të objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore, të cilat do të përdoren në vazhdimësi si hapësira të sigurta për të rinjtë ku do të përfshihet zhvillimi dhe mbështetja lokale e aktiviteteve kulturore, artistike, letrare dhe sportive.

Thirrja Publike nr. 2 ka mbështetur 5 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, konkretisht projektet:

1. "Try Gjirokastra"- Bashkia Gjirokastrë
2. "Bashkë për një Rini Aktive"- Bashkia Kamëz
3. "Të Rinjtë për të Rinjtë" - Bashkia Lushnje
4. "Biblioteka dhe të Rinjtë" - Bashkia Dibër
5. "Rindërtimi i Qendrës Rinore Multifunkionale Durrës" – Bashkia Durrës

Nga Thirrja Publike nr. 2, shpallur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë më datë 22.8.2022 dhe ka qëndruar e hapur për një afat kohor prej 30 ditësh, nëpërmjet financimit të organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, janë mbështetur:

- Tre projekte me fokus promovimin e kulturës dhe artit, përfshirjen e të rinjve dhe mentorimin/trajnimin e tyre në disiplina si pikturë, valles, balet, kanto, instrumente muzikore dhe aktrim në Bashkitë Mat, Tepelenë, Sarandë, Lezhë, Fier, Elbasan, Kukës, Shkodër, Gjirokastrë, Durrës, Vlorë, Berat, Korçë.

- Një projekt me qëllim fuqizimin e grave dhe vajzave nëpërmjet aktiviteteve sportive duke përfshirë yoga dhe fitnes të grave dhe vajzave të reja në Bashkinë Tiranë."

Në kuadër të thirrjeve të AKR për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore:

- Më datë 30 Tetor 2023 është realizuar finalizimi i rikonstruktimit të Bibliotekës së Lushnjës, kërkesë të Këshillit Vendor Rinor të Lushnjës me anë të një projekti nga Bashkia Lushnjë, financimi i të cilës u be i mundur nga Thirrja për Infrastruktura Rinore nga AKR. Me një transformim rrënjësor.
- Më datë 5 Dhjetor 2023 ka përfunduar rikonstruktimi i bibliotekës së Kamzës. Me anë të Thirrjes së Dytë për infrastrukturë rinore nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, biblioteka e Kamzës bëhet me ambiente të reja bashkëkohore të pasuruara me 1000 libra, për të shtuar dijet por njëkohësisht dhe një sallë rinore që rrisin përfshirjen, zhvillimin dhe socializimin e të rinjve.
- Më datë 7 Dhjetor 2023 ka përfunduar Rikonstruktimi i Qendrës Rinore Petrelë. Falë financimit nga AKR në kuadër të Thirrjes nr. 1 për Infrastruktura Rinore, Petrela tashmë ka një hapësire moderne të kushtuar të rinjve, të cilët mund të shpenzojnë kohë cilësore me njëri-tjetrin, të lexojnë libra apo të zhvillojnë aktivitete të ndryshme për rritjen e angazhimit të tyre social.

Më datë 8 dhjetor 2023 është shpallur thirrja e III-të e AKR për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, e cila ka qëndruar e hapur për një afat 30 ditor.

### **Realizimi financiar**

Fondet e kësaj mase janë përfshirë tek kostot 1.1.4 dhe ato fonde janë të realizuara.

Si rrjedhim mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

### **Masa 3.3.2 Mbështetja e programeve të gjithëpërfshirjes dhe politikave të përfshirjes, sigurisë dhe mbrojtjes me fokus të veçantë tek të rejtat dhe të rinjtë.**

Si pjesë e programit Jashtë Orarit Mësimor (JOM), përmendur më lart, janë trajnuar mbi 60 mësues për sportin e vetëmbrojtjes. Realizimi i trajnimeve është pjesë e projektit të zbatuar për "Ngritje kapacitetesh dhe mbështetje e avacuar për mësuesit e shkollave publike në Shqipëri mbi Fuqizim Vetëmbrojtje (ESD)". Ky trajnim ka si qëllim rritjen e sigurisë personale për fëmijët dhe të rinjtë në shkolla.

MSHMS po zbaton Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025 miratuar me VKM Nr. 276, datë 12.05.2021, ku trajtohet përfshirja sociale dhe aksesueshmëria për të gjithë grupet e aftësisë së kufizuar, si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, duke patur në fokus sensibilizimin. Në datë 8 prill 2023, në ditën ndërkombëtare të Romëve, u organizua aktiviteti me temë përfshirjen sociale dhe punësimin e grave dhe vajzave rome.

Në qendrën Rinore, 16-18 vjeç, ofrohet shërbim për të rinjtë, të cilët përgatiten për jetesë të pavarura. Aktualisht marrin shërbim 13 të rinj, ku gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023 një i ri është kthyer në familje biologjike dhe gjatë vitit 2022 - Janë integruar në jetesë të pavarura 7 të rinj dhe 8 të rinj janë në proces largimi.

Zbatimi i kësaj mase shtrihet për një afat të gjatë dhe puna do të vazhdojë për zbatimin e saj në këto drejtime:

1. Vijimi i mbështetjes për të rinjtë mbi moshën 18 vjeç, që kanë qenë përfitues të shërbimit në Qendrën Rinore, me qëllim që të kenë përparësi në banesat sociale.
3. Të rinjtë përfitues të institucioneve të kenë përfaqësuesit e tyre në Këshillat Rinor Vendor.
4. Të planifikohen trajnime përgatitore për të rinjtë që dalin nga institucionet, përfshirë këtu dhe trajnimet mbi grantet apo biznesin me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre.
5. Nisur nga eksperiencia e mëparshme me organizatat e shoqërisë civile lind nevoja e krijimit të programeve të mirëfillta mbështetëse në aspektin akademik për përfituesit e qendrave rezidenciale për shkak të boshllëqeve në nxënie gjatë viteve.

Në kuadër të forcimit të programeve për trajnimin e mësuesve nga MAS janë organizuar aktivitetet e mëposhtme:

1. Për ngritjen e kapaciteteve të 66 drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës, ASCAP ka mundësuar në çdo ZVAP trajnimin nga eksperte të fushës së pedagogjisë speciale;
2. Në mbështetje të mësuesve ndihmës ASCAP ka hartuar një manual, i cili është publikuar në faqen zyrtare të ASCAP;
3. DPAP ka mundësuar pjesëmarrjen aktive të mësuesve të arsimit të mesëm të lartë në trajnimet e tematikës për nevojat e të rinjve nga grupet sociale vulnerable dhe tematikave të tjera për arsimin gjithëpërfshirës;
4. Është forcuar bashkëpunimi i DRAP/ZVAP me organizatat joqeveritare, që punojnë me të rinjtë nga grupet sociale vulnerable për të zhvilluar dhe implementuar programe dhe projekte të përbashkëta për përmirësimin e arsimit për këtë grup të veçantë të të rinjve;
5. Me qëllim mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës, për të rinjtë nga grupet sociale vulnerable mësuesit kanë vënë dispozicion si libra, materiale multimediale dhe aplikacionet e teknologjisë informative.

Qëllimi i veprimtarive ka qenë fuqizimi dhe zhvillimi i të rinjve për të ardhmen. Temat kanë pasur për synim të ndërgjegjësojnë nxënësin për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe gjithashtu të kuptojnë sa i rëndësishëm është zëri i tyre.

*Në kuadër të mbështetjes së organizatave rinore në zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve parandaluese për të rinjtë në rrezik të përjashtimit social, projektet fituese të thirrjes së 2-të të AKR për projekt-propozime rinore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me synimin janë:*

- Organizata: Të ndryshëm dhe të barabartë - Titulli i projektit: “Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit”. Qëllimi i projektit: Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit përmes: përdorimi i fitnesit dhe ushtrimeve fizike, praktikat e menaxhimit të stresit dhe ndarjes së praktikave të vetë-rregullimit nëpërmjet sesioneve të krijuara nga eksperti për shëndetin mendor dhe mirëqenien emocionale, mënyrave të frymëmarrjes në çlirimin e ankthit dhe rregullimit të

emocioneve dhe ndjesive etj. Përfituesit direkt të projektit janë 37 gra dhe vajza, viktimat të abuzimit, trafikimit dhe dhunës, kanë përfunduar me sukses ciklin e trajnimeve rehabilituese nëpërmjet programit të dedikuar.

- Organizata: “Albanian NetWork for European Integration/Rrjeti Shqiptar për Integrimin European-ANEI” - Titulli i projektit: “*Zhvillimi i kompetencave midis të rinjve dhe sipërmarrësve të shekullit XXI në Shqipëri*”. Qëllimi i projektit: është adresimi i nevojave të të rinjve me fokus grupet vulnerabël, lidhur me rritjen e informimit dhe aftësive për t’u përballur me sfidat dhe kërkesat e tregut të punës. Grupi i synuar: Numri total i targetuar të synuar: 130 të rinj nga të cilët 10 të rinj të komunitetit rom dhe egjiptian.
- Organizata: “Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm”-ASDO - Titulli i projektit: “*Zhvillimi i kompetencave midis të rinjve dhe sipërmarrësve të shekullit XXI në Shqipëri*”. Qëllimi i projektit: është aftësimi i të rinjve me aftësi të domosdoshme digjitale dhe me njohuri thelbësore mbi zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat do të mbështesin në vazhdimësi rolin e tyre si pjesëtarë të vlefshëm të shoqërisë dhe potencialin për t’ju përgjigjur dinamikave të tregut të punës të shekullit XXI. Grupi i synuar: Numri total i targetuar të synuar: 150 të rinj nga të cilët 20% e të rinjve të komunitetit rom dhe egjiptian.
- Organizata: “Unioni i Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë” - Titulli i projektit: “*Aftësim dhe punësim për të Rinjtë*”. Qëllimi i projektit: është promovimi e punësimi i të rinjve në Bashkinë Tiranë e Kavajë si dhe të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e punësimit duke formuar lidhje të qëndrueshme ndërmjet aktorëve potencialë për mundësinë e punësimit. Grupi i synuar: Numri total i targetuar të synuar: 40 të rinj të rinj nga të cilët 10 të rinj do të përkasin shtresave vulnerable apo në nevojë.
- Organizata: Qendra për Ekselencë Destiny/ QED - Titulli i projektit: “*Rinia udhëheq mirëqenien-RUM*”. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është edukimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve të Bashkive Tepelenë, Korçë e Berat, për mbrojtjen e mjedisit dhe efekteve të tij në shëndet, përmes trajnimeve për elementet e jetesës së shëndetshme, mbrojtjes së konsumatorit e fondeve të bujqësisë dhe vizitave në institucionet e financuara nga programet për zhvillimin e bujqësisë. Grupi i synuar: Të rinjtë e moshës 15-19 vjeç në bashkitë e Tepelenës, Beratit dhe Korçë ( 60 të rinj në total nga bashkitë 50% vajza 50% djem 20 % e totalit të pjesëmarrësve nga komuniteti ROM dhe Egjiptian).
- Organizata: Power of Education - Titulli i projektit: “*Super Youth*”. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është këshillimi në karrierë dhe rritjen e kapaciteteve dhe mundësive për punësim tek të rinjtë në Bashkitë Durrës, Shkodër e Kamëz, përmes informimit mbi mundësitë e punësimit si freelance/nomad, krijimi e një komuniteti online si kanal informimi mbi mundësitë për bursa, konferenca etj. si dhe hartimin e një manuali mbi shkrimin e një plani biznesi. Grupi i synuar: 120 të rinj (50% vajza 50% djem) 20 % e totalit të pjesëmarrësve nga grupet e marxhinalizuara

*Në kuadër të mbështetjes së organizatave rinore në zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve parandaluese për të rinjtë në rrezik të përjashtimit social, projektet fituese të thirrjes së 2-të të AKR për projekt-propozime rinore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me synimin janë:*



*Projektet fituese të thirrjes së 3-të të AKR për projekt-propozime rinore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbështetjen e organizatave rinore në zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve parandaluese për të rinjtë në rrezik të përjashtimit social, janë:*

- Organizata: “Qendra Youth Rise” - Titulli i projektit: “*Unlock Your technological Skills*”. Qëllimi i këtij projekti: është krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë duke promovuar aftësitë inovative, digjitale dhe sipërmarrëse. Grupi i synuar i përfituesve direkt do të jetë 150 të rinjve nga të cilët 30% e pjesëmarrësve do të jenë nga grupet e marxhinalizuara.
- Organizata: “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA/ECPAT Shqipëri)” - Titulli i projektit: “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”. Qëllimi i këtij projekti: Qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll. Grupi i synuar i përfituesve direkt do të jetë të paktën 2000 të rinj e të reja në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll (të paktën 200 të rinj e të reja nga grupet në nevojë, nga komuniteti Rom/Egjiptian/PAK, LGBTI etj.) (50% je grupit të synuar janë vajza) përfitojnë shërbime të drejtpërdrejta të këshillimit, mbështetjes dhe fuqizimit, informacion në punësim, shkollim, biznes rinor, shërbime shoqërore dhe ato të shëndetit mendor në Qendrën Rinore me një Ndalesë;
- Organizata: Action for Albania - Titulli i Projektit: “*Action for Youth*”. Qëllimi i Projektit: Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve të të rinjve për aftësimin profesional si dhe monitorimi dhe mbështetja e ideve inovatore të sipërmarrjes (start upet), si aktivitet kritik për ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të bashkive si dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit. Grupi i synuar: Numri total i targetit të synuar: 300 të rinj të grup moshës 15-24. Programi i Sipërmarrjes dhe trajnimit: 60 pjesëmarrës ku 10 prej tyre i përkasin grupeve vulnerabël. (57% femra, 43% meshkuj).
- Organizata: Qendra You Are Not Alone- (Donator UNFPA) - Titulli i Projektit: “*ROMActivism*”. Qëllimi i Projektit: Qëllimi i këtij projekti është të kontribuohet në përmirësimin e përfshirjes sociale të të rinjve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke i mbështetur të integrohen në tregun e punës, duke i fuqizuar për tu mbrojtur nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si dhe duke rritur aktivizimin e tyre qytetar përmes bashkëpunimit me Këshillat Vendore Rinore (KVR). Grupi i synuar: 40-50 të rinj të moshës 15-19 vjeç, nga komuniteti ROM dhe Egjiptiane.

## **Realizimi financiar**

Për këtë masë janë realizuar aktivitete me fonde të buxhetit të shtetit dhe gjithashtu ka pasur mbështetje të donatorëve apo organizatave si IOM, madje ka pasur edhe shpenzime në kohë punonjësish apo shpenzime të tjera korente që nuk janë parashikuar në kostot e planifikuara.

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 100%. Përsa i përket zërave specifikë nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet

shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100% pasi janë përgatitur materiale dhe janë organizuar trajnime

Hendeku është zeruar dhe nga fondet e realizuara 75% janë fonde të financuara nga donatorët dhe rreth 25% janë fonde të buxhetit të shtetit.

Si konkluzion mund të quhet masë e realizuar.

**Masa 3.3.3 Mbështetet dhe promovohet programi i qeverisë në lidhje me mbështetjen financiare të strehimit për familjet e reja dhe në bashkëpunim me aktorë qeveritarë qendrorë e vendorë, si edhe organizatat donatore, nxitet zhvillimi programeve të tjera, në mbështetje të familjeve dhe çifteve të reja.**

Në Qershor 2023 u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë ndryshimet në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ku për herë të parë u parashikua përfshirja në skemën e programit të subvencionit të interesave të kredive punonjësit e administratës publik, si dhe përfshirja e familjeve të reja, duke qenë se problemi i strehimit të rinjve dhe familjeve të reja, vitet e fundit, është kthyer në prioritet.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese janë hartuar aktet nënligjore, ku parashikohen procedurat, kriteret, dhe dokumentacionet që duhet të plotësohen, për të aplikuar për programin e kredisë së lehtësuar për blerjen e banesës, për punonjësit e administratës publike.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në Dhjetor të vitit 2023 ka hapur procedurat e aplikimeve për programet e strehimit social, të cilat do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2024-2025. Procedurat përcaktojnë llojet e projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit pjesërisht apo plotësisht, kushtet që duhet të plotësojnë bashkitë për t’u kualifikuar, si edhe formatin dhe dokumentacionin e aplikimit. Në buxhetin e vitit 2024 është parashikuar një fond prej 320 milionë lekësh për financimin e projekteve të reja që do të hapen.

Tre janë llojet e programeve sipas të cilave kategorizohen projektet që do të financohen:

- Banesa sociale me qira;
- Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara; si dhe
- Streha të përkohshme.

Më konkretisht, në programin Banesa sociale me qira parashikohen projekte të financueshëm që mund të sigurohen nëpërmjet:

- Adaptimit të objekteve ekzistuese që janë në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Blerjes nga tregu, kur çmimi i blerjes së banesave në treg është më i ulët se kostoja e ndërtimit;
- Ndërtimit të ri në truall në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në programin Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara parashikohet financimi i projekteve për:

- Përmirësimin e infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje (kryesisht në zona të banuara nga minoriteti Rom), që janë në proces legalizimi;
- Përmirësimin e infrastrukturës në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime, ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme; si dhe
- Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese për familje.

Sa i përket projekteve lidhur me përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, për familje, ato do të kenë në fokus individë apo familje pa të ardhura, nga minoriteti Rom dhe Egjiptian, familje që ka në përbërje persona me aftësi të kufizuara, familje e përbërë nga të moshuar me moshë mbi 65 vjeç që jetojnë vetëm, familjet me më shumë se katër fëmijë, vajzat nëna, grua viktimë e dhunës, grua kryefamiljare, ku fëmijët në ngarkim të kenë moshën nën 18 vjeç, etj.

Në programin streha të përkohshme parashikohet financimi i projekteve që kanë të bëjnë me blerje dhe montim të kontenierëve, tendave, etj., si edhe adaptim të një objekti ekzistues për banim.

Hapja e procedurave për programet e strehimit social për kategoritë në nevojë bëhet vetëm pak ditë pasi Qeveria me ndryshimet në buxhetin e vitit 2023 akordoi bonuse sociale për shtresat vulnerabël, pjesë e paketës së solidaritetit për festat e fundvitit.

### Realizimi financiar

Kjo masë ishte planifikuar të fillonte më 2027. Në 2023 janë bërë ndryshimet ligjore kështu që kjo masë konsiderohet që ka filluar zbatimin.

### Përmbledhje për objektivin specifik 3.3

Realizimi i masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë:

Tabela 52

## Statusi i realizimit të masave të Objektivit 3.3



### **3. Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit**

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 ka parashikuar 19 treguesit e rezultateve, të cilët janë të ndarë për secilin qëllim politik. Më poshtë pasqyrohet performanca e zbatimit të SKR-së sipas treguesve, për çdo qëllim politik, të cilët janë të zbatueshëm për periudhën raportuese, duke sqaruar se, një pjesë e treguesve janë të matshëm në fund të vitit 2023 e në vijim.

#### **QËLLIMI I POLITIKËS 1:**

Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar, ka të parashikuar 9 (nëntë) tregues të performancës, të cilët janë të matshëm për periudhën raportuese.

#### ***Treguesi 2: % e të rinjve që raportojnë se ndihen të përfaqësuar në politikat rinore të zbatuara në nivel qendror/vendor***

Ky tregues është parashikuar të matet përmes sondazhit kombëtar të realizuar nga MSHRF. Për herë të parë treguesi do të matet në 2023 duke synuar të paktën 35% të të rinjve që shprehen se ndihen të përfaqësuar në politikat rinore të zbatuara në nivel qendror/vendor. Gjatë periudhës së raportimit ka nisur puna për realizimin e sondazhit vjetor duke e bërë të pamundur matjen e tij për vitin raportues.

#### ***Treguesi 3: % e buxhetit të shtetit dedikuar për programet mbi rininë.***

Ky tregues është parashikuar të matet çdo vit. Vlera e synuar për vitin 2023 ka qënë 0.7. Ndërkohë, referuar Ligjit Nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", shpenzimet e planifikuara në mbështetje të rinisë dhe fëmijëve në raport me buxhetin total të shtetit llogariten në masën 0.054%. Në krahasim me vitin 2022 ka një tendencë në rritje të buxhetit të shtetit dedikuar për programet për rininë. Megjithatë, duke konsideruar vlerën e synuar për vitin 2023 (0.7) treguesi nuk raportohet i realizuar plotësisht. Për vitin 2023, ky tregues është realizuar në masën 7.7%.

#### ***Treguesi 1.1 a. Përqindja e bashkive ku janë ngritur Qendrat Rinore Multifunkionale***

Ky tregues është planifikuar të matet në periudha vjetore. Për vitin 2023, synimi i parashikuar në Strategji ka qënë 35 %. Nga raportet dhe të dhënat e ofruara nga Agjencia Kombëtare e Rinisë rezultojnë se gjatë 2023 janë financuar rikonstruksioni, ndërtimi, rindërtimi dhe vënia në funksion e qendrave rinore në qytetin e Lezhës, qytetin e Elbasanit, NjA Petrelë të bashkisë Tiranë, të qytetit të Durrësit, të qytetit të Gjirokastrës, të qytetit të Fierit, të qytetit të Librazhdit, të bashkisë Mat, të bashkisë Malësi e Madhe, të qytetit të Sarandës dhe bibliotekave publike në Roskovec, Dibër, Lushnje dhe Kamëz.

Në total deri në fund të 2023 rezultojnë të financuara 15 qendra rinore të shtrira në 15 bashki të vendit, duke bërë që treguesi të realizohet në vlerës 24.5 %. Bazuar në të dhënat si më sipër, ky tregues është realizuar në masën 70% gjatë periudhës që mbulon ky raport monitorimi.

### ***Treguesi 1.1.c: Ligji "Për Rininë" i rishikuar dhe miratuar***

Puna për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 ka nisur në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 me ndërmarrjen e procesit të vlerësimit të brendshëm nga MSHRF-ja dhe AKR-ja lidhur me zbatimin dhe ndikimin e tij, duke synuar analizën e situatës, identifikuar problematikën dhe nevojat për ndryshim në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e rinisë.

Proçesi i rishikimit të ligjit për rininë do të ndjekë të njëjtën qasje të bashkëkrijimit të zbatuar në rastin e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe do synojë angazhimin dhe marrjen e kontributeve të aktorëve të jashtëm. Paketa e amendimeve të Ligjit nr. 75/2019 parashikohet të përgatitet, konsultohet publikisht dhe paraqitet në Këshillin e Ministrave, brenda vitit 2024.

Në kushtet kur, SKR 2022-2029 është miratuar në 26 tetor të vitit 2022, puna për rishikimin e ligjit ka mundur të fillojë menjëherë në fillim të vitit 2023, periudhë gjatë të cilit janë marrë masat e sipërcituara, në kuadër të kryerjes së analizës e situatës së zbatimit të ligjit dhe identifikimit të problematikave, konsideruar edhe procesin e hapur të konsultimeve me të gjithë palët e interesit, që ne vetvete si proces merr kohë.

### ***Treguesi 1.1.d: Ligji "Për Vullnetarizmin" i rishikuar dhe miratuar***

Gjatë vitit 2022 ka nisur proces konsultimi në nivel politik dhe teknik mes Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin", gjatë vitit 2020 e në vijim, me qëllim identifikimin dhe adresimin e të gjitha problematikave gjatë procesit të rishikimit ligjor.

Në përfundim të procesit të konsultimeve u vendos nisja e procesit të rishikimit tërësor të Ligjit nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin" dhe nga një grup i përbashkët pune, me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në këtë proces, ka nisur puna, duke synuar angazhimin e të gjitha resurseve të disponueshme dhe të dhënave të mbledhura gjatë dy viteve të fundit për përgatitjen e një ligji efektiv, të qëndrueshëm dhe të gjithë pranuar, që do përmirësonte strukturën e vullnetarizmit dhe krijonte një mjedis më mundësues për sektorin në Shqipëri. Grupi i përbashkët i punës ka vijuar punën gjatë vitit 2023 për përgatitjen e propozimeve ligjore me synimin që paketa e plotë të jetë e përgatitur, e konsultuar publikisht dhe paraqitur në Këshillin e Ministrave, brenda tremujorit të dytë të vitit 2024.

### ***Treguesi 1.2.b: Platforma rinore "Të rinjtë për të rinjtë" e ngritur, funksionale dhe e përditësuar***

Strategjia Kombëtare e Rinisë ka parashikuar se, në fund të vitit 2022 duhet të ketë filluar përgatitja e procesit dhe infrastrukturës për ngritjen e platformës "Të rinjtë për të rinjtë".

Referuar raportimit nga institucioni përgjegjës, nuk rezulton të jenë ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmbushjen e këtij indikator gjatë periudhës së monitorimit.

### ***Treguesi 1.1.b: Numri i Këshillave Vendore të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)***

Vlera bazë për përlogaritjen e këtij treguesi do t'i referohet vitit 2022 ku KVR-të janë ngritur në 21 bashki. Ndërkohë në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 është parashikuar që në fund të vitit 2023 të jenë ngritur këshillat vendorë në 40 bashki të vendit.

Në qershor 2023 evidentohen 59 KVR të ngritura, duke përbushur plotësisht angazhimin e parashikuar, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023. KVR-të e ngritura përbëjnë 96.7% të totalit të Këshillave Vendorë të ngritur, duke bërë që vlera e synuar për realizimin e këtij treguesi të tejkalohet edhe përpara afatit të përcaktuar. Bazuar në të dhënat e raportuara si më sipër, për vitin 2023, ky tregues është realizuar në masën 147.5 %.

### ***Treguesi 1.2 a Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor ( info-points)***

Ky tregues ka si qëllim të masë shkallën e ngritjes së këndëve digjitale të informimit rinor në nivel bashkie gjatë gjithë kohëzgjatjes së Strategjisë Kombëtare për Rininë. Bazuar në SKR 2022-2029, ky tregues do të matet për herë të parë në vitin 2023, ku është parashikuar ngritja e këndëve digjitale të informimit rinor në 25 bashki që përbëjnë edhe 40% të totalit të bashkive. Bazuar në të dhënat e marra nga AKR, gjatë vitin 2023 nuk rezulton se janë ngritur kënde të tilla digjitale në bashki, duke bërë që treguesi të raportohet i mosrealizuar.

### **1.3 a Politikat zhvillimore rinore të hartuara bazuar në analizë**

Bazuar në dokumentin strategjik, treguesi si më sipër është parashikuar të masë numrin e studimeve rinore të hartuara në periudha 2 vjeçare monitorimi. Për herë të parë treguesi synohet të matet në përfundim të vitit 2024 duke e bërë të pamundur matjen e tij për vitin raportues.

## **QËLLIMI I POLITIKËS 2:**

Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity). Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës. Për periudhën e raportimit, për këtë qëllim rezultojnë 5 (pesë) tregues performance si më poshtë:

### ***Treguesi 2.1.a: Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë***

Ky tregues ka si qëllim të masë shkallën e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë në periudha vjetore. Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, vlera bazë e këtij treguesi sështë 52.5% e të rinjve nga të cilët 58.6% meshkuj dhe 46.3 % femra.

Ndërkohë, për vitin 2023, dokumenti strategjik synon një rritje të përqindjes së të rinjve që marrin pjesë në tregun e punës në 53.5%. Bazuar në të dhënat e Anketës së Forcës së Punës, publikuar nga INSTAT rezulton se për vitin 2023, shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve grupmosha 15-29 është 56.87 % nga të cilat 52 % të reja dhe 61.82% të rinj.

Si më sipër, treguesi është realizuar në masën 106.3%.

Tabela 53

Grupmosha	Shkalla e pjesëmarrjes në foract e punës 2023		
	Gjithsej	Të Rinj	Të Reja
15 – 29 Vjec	56.87%	61.82%	52%

**Treguesi 2.3.a: Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë**

Në Strategjinë Kombëtare të Rinisë është parashikuar vlera bazë për përlogaritjen e këtij treguesi dhe konkretisht është: 20.9% e të rinjve nga të cilët 20.5% meshkuj dhe 21.4 % femra.

Në vitin 2023 vlera e treguesit, shkalla e papunësisë, parashikohet të jetë 20.3% e të rinjve të papunë.

INSTAT ka përlogaritur këtë tregues për vitin 2023 sipas pasqyrimit të mëposhtëm:

Tabela 54

Grupmosha	Shkalla e papunësisë 2023		
	Gjithsej	Burra	Gra
15 – 29 Vjec	22.2%	23.65%	20.5%

Siç shihet, për vitin 2023, treguesi që mat shkallën e papunësisë për të rinjtë nuk është arritur plotësisht, duke qënë 1.9% më shumë se sa vlera e synuar.

**Treguesi 2.2.a: Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimor**

Ky tregues do të masë çdo vit numrin e të rinjve (shkolla e mesme dhe arsimit i lartë), që marrin pjesë në programi shkëmbimi/ mobiliteti arsimor. Treguesi do të llogaritet sipas viteve akademike dhe vlera bazë referencë do të merret ajo e vitit akademik 2021-2022. Në vitin 2021 kanë marrë pjesë në programe mobiliteti gjithsej 4347 të rinj. Bazuar në dokumentin strategjik, ky tregues duhet të ketë vlerë rritëse çdo vit.

Gjatë vitit 2023 numri i të rinjve, të cilët kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimor paraqitet si më poshtë:

Numri i mobiliteteve (2023):

Tabela 55

<b>INTERVET WB</b>	131	43 staf mësim dhënës (22 drejtues dhe 21 mësues); 88 nxënës
<b>ZRBR (RYCO)</b>	2	Mësues
<b>V2V-AL</b>	2	(1 Drejtues; 1 Mësues)
<b>VET for Western Balkans</b>	2	Drejtues (Jo Nxënës)

Të dhëna mbi shkëmbimet lidhur me programin CEEPUS.

Tabela 56

Viti Akademik	Studentë	Studentë me kohë të shkurtër	Nr. Total i mobiliteteve
2023 – 2024	3	25	28
2022 – 2023	6	57	63
2021 – 2022	43	13	56
2020 – 2021	9	7	16
2019 – 2020	21	0	21
2018 – 2019	20	1	21
2017 – 2018	22	0	22
2016 – 2017	10	2	12

**Treguesi 2.3.b: % e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit**

Për vitin 2023, 1019 të rinj të moshës 15-29 vjeç kanë qenë pjesë e programeve të nxitjes së punësimit të zbatuara nga AKPA, duke përbërë 38.6% të totalit të përfituesve nga këto programe. Bazuar në SKR 2022-29, vlera bazë e këtij treguesi është 2021, në masën 45%. Për të gjitha vitet e tjera të zbatimit të Strategjisë, ky tregues do të duhet të ketë trend rritës që të konsiderohet i realizuar. Bazuar në të dhënat e marra nga AKPA, për vitin 2023, nuk kemi rritje të vlerës bazë dhe si e tillë treguesi mbetet i porealizuar.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen në mënyrë të detajuar shifrat, sipas programeve të nxitjes së punësimit gjatë vitit 2023:

Tabela 57

Lloji i Programit	Janar – Dhjetor 2023		
	Total	15 – 29 Vjec	%
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	405	118	29%
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	183	75	41%
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	633	609	96%
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	0	0	-
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	51	16	31%
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/Informaliteti)	133	31	23%
V.K.M 635 (Punët në komunitet)	995	72	7%
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	235	98	42%
<b>Total</b>	<b>2,635</b>	<b>1,019</b>	<b>39%</b>



### ***Treguesi 2.3.c: % e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit***

Gjatë vitit 2023 ka vijuar zbatimi i Ligjit për mbështetjen dhe zhvillimin e startupeve<sup>28</sup> dhe thirrjeve për skemën e mbështetjes së startupeve dhe lehtësuesve të tyre përmes grantit shtetëror<sup>29</sup>, si dhe skemës mbështetëse pjesëmarrjen e të rinjve në kurset profesionale në fushat e programimit kompjuterik dhe kodimit.<sup>30</sup> Referuar të dhënave të raportuara nga AKPA dhe Agjencia “Start UP Albania” janë 1285 të rinj të mbështetur për ndjekjen e kurseve të formimit profesional në kodim dhe programim kompjuterik dhe janë financuar **29 startup-e dhe 29** lehtësues me grant shtetëror.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, vlera e synuar për vitin 2023, për këtë tregues është 5% rritje në raport me vitin e kaluar. Bazuar në vlerën e raportuar për vitin e kaluar, ky tregues rezulton i realizuar.

### **Qëllimi i politikës 3 – Mirëqenia dhe Përfshirja**

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti). Në dokumentin strategjik për këtë qëllim janë parashikuar matja e 4 (katër) treguesve të performancës, nga të cilët vetëm 3(tre) janë planifikuar për t’u matur gjatë periudhës raportuese 2023:

#### ***Treguesi 3.2.a % e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme***

Ky tregues ka si qëllim të masë numrin e përgjithshëm të të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme në raport me numrin përgjithshëm të të rinjve pjesëmarrës në sondazh gjatë periudhës raportuese. Në dokumentin strategjik është parashikuar që studimi i parë lidhur me matjen e këtij treguesi do të realizohet në 2023. Nga të dhënat e raportuara nga MSHRF dhe AKR rezulton se gjatë vitit 2023 ka filluar puna për realizimin e sondazhit, duke e bërë të pamundur raportimin e tij për vitin 2023.

#### ***Tregues 3.2.b % e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë***

Treguesi ka si qëllim të masë shkallën e qendrave shëndetësore që janë të pajisura me mjedise miqësore për rininë. Edhe për këtë tregues, në dokumentin strategjik është parashikuar që studimi i parë lidhur me matjen e tij do të realizohet në 2023. Nga të dhënat e raportuara nga MSHMS

---

<sup>28</sup> <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Ligji-p%C3%ABr-mb%C3%ABshtetjen-dhe-zhvillimin-e-startup-eve.pdf>

<sup>29</sup> <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-315-Dt.11.05.2022.pdf>

<sup>30</sup> <https://riniafemijet.gov.al/rinia/kodimi-per-te-rinjte/>

rezulton se gjatë vitit 2023 ka filluar puna për realizimin e studimit, duke e bërë të pamundur raportimin e tij për vitin 2023.

### ***Tregues 3.2.c % e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë***

Ky treguesi ka si qëllim të masë shkallën e nëpunësve të trajnuar çdo vit mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë. Referuar dokumentit strategjik, rezulton se vlera e synuar për vitin 2023 është rritja 5% në krahasim me vitin e kaluar (2022). Nga të dhënat e raportuara nga MSHMS dhe ASPA rezulton se për vitin 2023 nuk janë realizuar trajnime për nëpunës publikë në fushën e ofrimit të shërbimeve miqësore për të rinjtë. Si i tillë treguesi nuk rezulton i realizuar.

#### **Përmbledhje për realizimin e treguesve**

Referuar analizës më sipër rezulton se nga 19 tregues që përmban Pasaporta e treguesve të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, për vitin raportues ( Janar-Dhjetor 2023) rezultojnë të matshëm 17 tregues performance të ndarë si më poshtë:

Qëllimi i Parë: 9 tregues të matshëm për 2023

Qëllimi i Dytë: 5 tregues të matshëm për 2023

Qëllimi i tretë: 3 tregues të matshëm për vitin 2023

Nga të dhënat e mbledhura nga të gjitha institucionet raportuese, gjithsej për periudhën që mbulon ky raport monitorimi rezultojnë:

3 tregues të realizuar plotësisht që përbëjnë 18% të treguesve të matshëm për vitin 2023

6 tregues që nuk janë realizuar që përbëjnë 35 % të treguesve të matshëm për vitin 2023


4 tregues të realizuar pjesërisht që përbëjnë 23 % të treguesve të matshëm për vitin 2023

4 tregues nuk mund të raportohen për periudhën 2023 ose 24% e treguesve në total për vitin 2023.

Në mënyrë grafike realizimi i treguesve të performancës paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 58

## Statusi i realizimit të treguesve për 2023




Të ndarë sipas qëllimeve të politikës, statusi i realizimit të treguesve rezulton si mëposhtë:

Për Qëllimin e Parë, nga 9 tregues gjithsej: 1 tregues është realizuar plotësisht, 2 tregues janë realizuar pjesërisht, 2 tregues nuk mund të raportohen dhe 4 tregues nuk janë realizuar. Në mënyrë grafike realizimi i treguesve të performancës për qëllimin e parë paraqitet si më poshtë:

Tabela 59


## Statusi i realizimit të treguesve për Qëllimin I



Për Qëllimin e Dytë, nga 5 tregues gjithsej: 2 tregues janë realizuar plotësisht, 2 tregues janë realizuar pjesërisht dhe 1 tregues nuk është realizuar. Në mënyrë grafike realizimi i treguesve të performancës për qëllimin e dytë paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 60


## Statusi i realizimit të treguesve për Qëllimin II



Për Qëllimin e Tretë, nga 3 tregues gjithsej: 1 tregues nuk është realizuar dhe 2 tregues nuk mund të raportohen. Në mënyrë grafike realizimi i treguesve të performancës për qëllimin e tretë paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 61

## Statusi i realizimit të treguesve për Qëllimin III



#### 4. Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve, risqeve dhe hapat për të adresuar

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën 2023, referuar treguesve të performancës, rezulton se, objektivet specifike, që kanë treguar performancë të dobët dhe jo rezultative, janë si më poshtë:

Për sa më sipër, sfidë ngelet marrja e masave të nevojshme për fillimin e menjëhershëm të punës për kryerjen e aktiviteteve në funksion të zbatimit të masave, të cilat nuk rezultojnë me realizueshmëri të lartë, duke ndikuar kështu edhe në performancën e objektivit specifik dhe qëllimit të politikës ku bëjnë pjesë.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 është një dokument strategjik shumëdimensional, i cili synon të adresojë të gjithë çështjet e rinisë, duke parashikuar marrjen e masave për arritjen e objektivëve specifikë dhe qëllimeve politike, në drejtim të fuqizimit, gjithë përfshirjes, arsimit, edukimit, shëndetit fizik e mendor, punësimin, lëvizshmërisë, mobilitetit të rinjve etj.

Në këtë kuadër, institucionet përgjegjëse dhe institucionet kontribuese, të cilat kanë detyrimin e marrjes së masave dhe realizimit të aktiviteteve konkrete, janë të shumta. Drejtimi, organizimi, menaxhimi i mirë i veprimtarisë së secilit institucion, në përmbushjen e detyrave të veta, dhe veçanërisht koordinimi i punës së të gjithë institucioneve të përfshira, me qëllim edhe shkëmbimin e informacionit dhe zgjidhjen e problemeve, janë pjesë e riskut të zbatimit të SKR-së dhe të monitorimit të zbatimit të saj.

E lidhur me sa më sipër shihet edhe fakti që, MSHRF-ja është institucioni që drejton procesin e zbatimit dhe monitorimit të SKR-së, dhe ekzistenca e stafit të reduktuar në numër të këtij institucioni është një risk që duhet të adresohet gjithashtu.

Për sa i përket, mungesës së numrit të mjaftueshëm të punonjësve të MSHRF-së, vlerësohet se, fuqizimi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë, duke shtuar numrin e burimeve njerëzore, si institucioni në varësi të MSHRF-së, përgjegjës për zbatimin e politikave të rinisë, dhe konkretisht përgjegjës apo kontribues, në zbatimin e masave të parashikuara në SKR, është një nga hapat që duhet të ndërmerren. Në këtë kuadër, po përgatitet paketa ligjore, për propozimin e ndryshimeve strukturore të këtij institucioni, ku parashikohet edhe shtesa e punonjësve në organikën e AKR-së.

Rritja e kapaciteteve zbatuese dhe financuese, në sajë të numrit të shumtë të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në kuadër të SKR-së, si dhe faktit që zbatimi i tyre shpesh kërkon ekspertizë të veçantë, është një nga risqet e zbatimit të saj.

Bashkëpunimi me partnerët/aktorët e jashtëm, si donatorë, të cilët vënë në dispozicion të zbatimit të SKR-së dhe përmbushjes të aktiviteteve, burimet e tyre njerëzore dhe financiare, konsiderohet një vlerë dhe një nga pikat e forta të arritjeve të realizuara në kuadër të Strategjisë, dhe intensifikimi i këtij bashkëpunimi është një nga masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mungesës së kapaciteteve zbatuese dhe financuese të SKR-së.

Me qëllim, që në të ardhmen, të përmirësohet dhe të rritet performanca e zbatueshmërisë të SKR-së, duhet të merren masat për kapërcimin e risqeve të cituara më lart, bazuar edhe në rekomandimet vijuese.

## **5. Konkluzione dhe rekomandime**

Raporti i monitorimit 6-mujor, nëntor 2022 – qershor 2023, në zbatim të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, është dokumenti i parë monitorues që hartohet në përputhje me këtë plan veprimi. Ky Raport është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës, të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve, sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura,

të zbatueshmërisë së masave (output/produkte), të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara.

Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve, si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit korrik-dhjetor 2023, dhe referuar buxheteve për të gjithë vitin 2023, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë. Nga monitorimi financiar i kryer rezultoi se:

Qëllimi i politikës (1) bazuar në treguesit rezultoi se një shkallë realizueshmërie 72%

Qëllimi i politikës (2) bazuar në treguesit rezultoi se një shkallë realizueshmërie 47%

Qëllimi i politikës (3) bazuar në treguesit rezultoi se një shkallë realizueshmërie 78%

Institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese, gjatë 8 muajve të parë, pas hyrjes në fuqi të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, kanë dëshmuar vullnet për marrjen e hapave të menjëhershëm për zbatimin e masave të parashikuara, për çdo objektiv specifik dhe çdo qëllim politik, të këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik, në fushën e rinisë.

Mbështetja nga partnerët ndërkombëtarë dhe vendas, gjatë periudhës raportuese, në aspektin e burimeve njerëzore apo financiare, ka qenë një faktor kyç në realizueshmërinë e masave dhe kryerjen e aktiviteteve për zbatimin e tyre.

Ndërkohë, mungesa e burimeve njerëzore; mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar; mangësitë në raportimin e veprimtarive të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese, duke ndikuar në kryerjen e një analizë reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së planit të veprimit, janë faktorë që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të planit të veprimit lidhen me rezultatin e zbatueshmërisë së SKR-së në tërësi, si dhe me mangësitë e konstatuara në raportim. Në mënyrë të përmbledhur rekomandimet në përfundim të raportit të parë të monitorimit janë:

- Të ndërmerren hapat e nevojshëm për zbatimin e masave dhe objektivëve specifikë, të cilët rezultojnë në nivelin e zbatimit dobët (nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara).
- Realizueshmëria më e ulët e qëllimit të dytë është ndërlidhur me thirrjen për fonde grant për start-upet nga Ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe klimën e biznesit, thirrje kjo e realizuar por e shtyrë në kohë përtëj 2023.
- Të intensifikohet bashkëpunimi mes institucioneve përgjegjëse dhe atyre kontribuuese, të cilat kanë detyrimin e ndërmarrjes së hapave të caktuar për përmbushjen e masave të

parashikuara dhe kryerjen e aktiviteteve përkatëse të lidhura me to, me qëllim rritjen e nivelit të realizimit të masave dhe të saktësisë së raportimit.

- Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike në përputhshmëri me raportet që prodhojnë institucionet përgjegjëse;
- Të sigurohet mbështetje financiare për masat që nuk ka buxhet për periudhën vijuese, nëpërmjet parashikimit në PBA ose nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me donatorët;
- Të rritet niveli i bashkëpunimit me AMVV dhe bashkitë e vendit, si institucione të rëndësishme në zbatimin e disa prej masave të parashikuara në SKR në nivel vendor,
- Të merren masat e nevojshme, që përveç zbatimit të masave të parashikuara, të rritet, në të ardhmen, zbatueshmëria e treguesve për çdo objektiv specifik;
- Të konsolidohet metodologjia e raportimit dhe mekanizmat e parashikuar për kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të zbatueshmërisë së SKR-së;
- Të sigurohen trajnime për personat përgjegjës, që merren me monitorimin e strategjive, për të patur një raportim eficient, në kohë dhe në përmbajtje;
- Të evidentohen nga institucionet përgjegjëse problematikat e hasura në mos përmbushjen e masave dhe aktiviteteve, duke plotësuar në instrumentin e raportimit edhe vlerësimin e riskut.

## **6. Hapat e radhës**

- Përmirësimi i koordinimit me palët e interesit:

Veprimtaria duhet të intensifikojë koordinimin me të gjithë palët e përfshirë, duke përfshirë institucionet, ministritë e linjës, organizatat rinore, të rinjtë, punonjësit rinorë, Këshillat vendore rinore dhe të tjerë. Një përpjekje e përbashkët për të siguruar një bashkërendim të ngushtë do të forcojë efektivitetin dhe implementimin e masave.

- Rishikimi i Ligjit të Rinisë dhe Ligjit të Vullnetarizmit:

Masat duhet të zbatohen në përputhje me parashikimet dhe qëllimet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë për periudhën 2022-2029. Rishikimi i Ligjit të Rinisë dhe Ligjit të Vullnetarizmit mund të konsolidojë bazën ligjore për zbatimin e masave dhe përmirësimin e mjedisit ligjor për rininë.

- Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe ndjekjes së masave të përealizuara:

Një sistem i përmirësuar i monitorimit duhet të implementohet për të vlerësuar progresin dhe për të ndjekur masat që nuk janë ende realizuar. Përveç kësaj, duhet të ndërmerren masa adekuate për të adresuar çështjet e identifikuara dhe për të përmirësuar ndjekjen e tyre.

- Integrimi i çështjeve të rinisë në procesin e raportimit për Bashkimin Evropian:

Raportimi periodik në BE përfshin masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë në kontekstin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian. Ky proces do të thellojë bashkëpunimin dhe koordinimin me partnerët evropianë dhe do të thellojë përfshirjen në proceset evropiane.

- Vazhdimi i impaktit tek të rinjtë dhe rishikimi i masave:

Vazhdimi i vlerësimit të impaktit të masave të zbatuara në të rinjtë duhet të jetë një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve. Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, është e rëndësishme rishikimi i masave sipas nevojave dhe aspiratave të të rinjve.